



KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, 10.11.2015
SWD(2015) 215 final

DOKUMENT PUNE I PERSONELIT TË

KOMISIONIT

**RAPORTI PËR KOSOVËN*
2015**

Në përçjellje të dokumentit

**KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,
KËSHILLIN EVROPIAN, KOMITETIN EVROPIAN EKONOMIK DHE
SOCIAL DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

Strategjia e BE-së për Zgjerim

{ COM(2015) 611 final}
{ SWD(2015) 210 final}
{ SWD(2015) 211 final}
{ SWD(2015) 212 final}
{ SWD(2015) 213 final}
{ SWD(2015) 214 final}
{ SWD(2015) 216 final}

Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e OKB-së 1244/1999 dhe opinionin e GjND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Përmbajtja

1.	HYRJE	4
1.1.	Konteksti.....	4
1.2.	Përmbledhja e raportit	4
2	KRITERET POLITIKE	6
2.1.	Demokracia	6
2.2.	Reforma e administratës publike	10
2.3.	Sundimi i ligjit	12
2.4.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	20
2.5.	Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare	27
3	NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË.....	29
4.	KRITERET EKONOMIKE	30
4.1.	Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale.....	30
4.2.	Kapaciteti për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian	35
5.	STANDARDET EVROPIANE.....	37
5.1.	Tregu i brendshëm	37
5.1.1.	Lëvizja e lirë e mallrave.....	37
5.1.2.	Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta për krijim.....	38
5.1.3.	Lëvizja e lirë e kapitalit.....	39
5.1.4.	Doganat dhe tatimi.....	40
5.1.5.	Konkurrenca	41
5.1.6.	Prokurimi publik.....	41
5.1.7.	Ligji për pronën intelektuale	43
5.1.8.	Punësimi dhe politikat sociale, politika e shëndetit publik	44
5.1.9.	Arsimi dhe hulumtimi	45
5.1.10.	Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).....	46
5.2.	Politikat e sektoriale	47
5.2.1.	Industria dhe NVM-të.....	47
5.2.2.	Bujqësia dhe peshkataria.....	47
5.2.3.	Mjedisi dhe ndryshimi klimatik	48
5.2.4.	Politika e transportit.....	49
5.2.5.	Energjia	50
5.2.6.	Shoqëria informative dhe mediat.....	51
5.2.7.	Kontrolli financiar	52
5.2.8.	Statistikat	54
5.3.	Drejtësia, liria dhe siguria.....	56
5.3.1.	Politika e vizave, kontrollet kufitare, azili dhe migrimi	56
5.3.2.	Shpëlarja e parave.....	58

5.3.3.	Narkotikët.....	58
5.3.4.	Policia	58
5.3.5.	Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit	59
5.3.6.	Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale	60
Shtojca I – Marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës		61
Shtojca II – Shtojca e statistikave.....		63

1. HYRJE¹

1.1. Konteksti

Më 27 tetor 2015, BE-ja nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Kosovën. Kjo është një arritje në rrugën e Kosovës drejt një të ardhmeje evropiane. MSA-ja përbën marrëdhënien e parë kontraktuale në mes BE-së dhe Kosovës. Ajo kompletonte hartën e MSA-ve me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. MSA-ja paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse për dialog politik më të afërt dhe për marrëdhënie ekonomike në mes Kosovës dhe BE-së, përfshirë hapjen e tregjeve të BE-së për produktet e Kosovës.

Kosova ka dëshmuar përkushtimin e saj për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, përmes arritjes së një numri marrëveshjesh të rëndësishme, në muajin gusht. Po ashtu, janë marrë vendime të rëndësishme që i hapin rrugë themelimit të Dhomave të Specializuara. Qeveria e re ka theksuar gjithashtu zotimin e saj për përmbytjen e të gjitha kërkesave për liberalizimin e vizave.

1.2. Përmbledhja e raportit

Sa i përket **kritereve politike**, bllokada politike gjashtëmujore që pasoi zgjedhjet e qershorit 2014 i ka shtyrë reformat kryesore. Kjo bllokadë përfundoi në dhjetor, atëherë kur Partia Demokratike e Kosovës (PDK) formoi koalicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe me partitë minoritare. Në muaji gusht, Kuvendi i Kosovës votoi në favor të amendamenteve kushtetuese për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe një Zyreje të Prokurorit të Specializuar, të cilat do të ndjekin rastet e krimeve të mëdha ndër-kufitare dhe ndërkombëtare, të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe si pasojë e tij. Qeveria ka arritur gjithashtu marrëveshje të rëndësishme me Beogradin, në muajin gusht. Të dy vendimet kërkonin angazhim politik të fuqishëm nga ana e Qeverisë.

Ka pasur gjithnjë e më shumë polarizim në mes Qeverisë dhe opozitës. Pjesëtarët e opozitës kanë qenë të përfshirë në incidente të dhunshme kundër Qeverisë, duke e kritikuar këtë të fundit për vendimin e saj të marrë së fundi për Dhomat e Specializuara, për dialogun me Beogradin dhe për marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.

Shumë institucione të pavarura dhe autoritete regullatore nuk janë ende funksionale apo janë duke ndikuar negativisht për shkak të emërimeve të vonuara të anëtarëve të bordeve. Si Qeveria, ashtu edhe Kuvendi duhet t'i zgjedhin urgjentisht anëtarët e bordeve të këtyre institucioneve dhe duhet të përcaktojnë mekanizmat për llogaridhënien e tyre. Emërimet duhet të bëhen në bazë të kualifikimeve të tyre profesionale dhe në bazë të meritës, dhe jo përkrahjes politike. Në këtë kuptim, zgjedhja e Avokatit të Popullit së fundi ishte një zhvillim pozitiv.

Qeveria ka shtuar përqendrimin e saj në reformimin e administratës publike, e cila ka arritur një nivel përgatitjeje. Është shënuar progres i mirë në avancimin e kornizës ligjore dhe strategjike. Megjithatë, politizimi i vazhdueshëm i administratës publike është një shqetësim i madh. Në administratë duhet të përmirësohet llogaridhënia, përmes mbikëqyrjes së duhur. Duhet të shmanget çdo minimizim i përgjegjësisë të agjencive qeveritare. Mbikëqyrja e ndarjes së buxhetit nga ana e Parlamentit duhet të bëhet më e besueshme dhe më transparente. Duhet të sigurohet menaxhim i mirë financiar nëpër institucionet publike.

¹ Ky raport mbulon periudhën tetor 2014 deri shtator 2015. Ai është bazuar në burime të ndryshme, përfshirë këtu kontributin e Qeverisë së Kosovës, shteteve anëtare të BE-së, raporteve të Parlamentit Evropian dhe informatat e organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare. Si rregull, legjislacioni ose masat që janë në përgatitje e sipër ose që janë në pritje të aprovimit parlamentar nuk janë marrë në konsiderim.

Sistemi gjyqësor i Kosovës është në një fazë të hershme të përgatitjes. Janë miratuar një numër amandamentimesh të katër ligjeve kryesore, që paraqesin një hap drejt modernizimit të sistemit të drejtësisë.

Megjithatë, gjyqësori mbetet i ndjeshëm ndaj ndërhyrjes politike. Kërkohen përpjekje më të mëdha që të sigurohet pavarësia në ligj dhe në praktikë, për të parandaluar dhe për ta luftuar korrupsionin brenda gjyqësorit, për të rekrutuar dhe për të trajnuar staf më të kualifikuar dhe për të alokuar mjetet e nevojshme.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjeve në luftimin e korrupsionit. Është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike për të siguruar rezultate reale në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë. Mbetet të krijohet një sistem regjistrimi për rastet e suksesshme të ndjekjes dhe dënimit. Hetimet e rralla të korrupsionit në nivelin e lartë, deri më tash nuk kanë rezultuar me dënime.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjeve në luftimin e krimit të organizuar. Është shënuar pak progres në bashkëpunimin ndër-institucional dhe në shkëmbimin e informatave ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit lidhur me hetimet. Megjithatë, numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare ende mbetet i ulët. Masa e konfiskimit të pasurive aplikohet rrallë. Përqendrimi në strategjitë dhe planet e veprimit nuk duhet të vë në hije nevojën për rezultate të vërteta në luftimin e krimit të organizuar endemik në Kosovë. Kosova ka rritur përpjekjet e saj për luftimin e terrorizmit, mirëpo ajo ende vazhdon të ballafaqohet me sfida që ndërlidhen me radikalizmin.

Miratimi i pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut ka fuqizuar strukturën institucionale dhe kjo qartëson rolet e institucioneve të ndryshme. Megjithatë, nevojitet vëmendje politike më e madhe për të siguruar zbatimin e duhur dhe për të adresuar mungesën e burimeve. Në fushën e lirisë së shprehjes, Kosova ka nivel të përgatitjes. Komiza legjislative dhe institucionale mbetet e fragmentuar dhe pjesërisht joefektive. Transmetuesi publik është i ndjeshëm ndaj presionit politik dhe i mungon financim i qëndrueshëm. Dhuna ndaj grave dhe qasja e kufizuar e grave në zotërimin e pronës e pengojnë ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre. Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara dhe atyre që u përkasin minoriteteve duhet të fuqizohet dukshëm, në veçanti për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase.

Lidhur me **normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova mbetet e angazhuar në zbatimin e “Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve” të prillit 2013 dhe marrëveshjeve të tjera të arritura në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Marrëveshjet kryesore që janë finalizuar në muajin gusht janë: energjia, telekom, themelimi i Asociacionit/Bashkësisë të komunave me shumicë serbe si dhe Ura në Mitrovicë. Dialogu ka arritur rezultate konkrete të mëtejshme në fushën e drejtësisë, integritetit të pjesëtarëve të Mbrojtjes Civile, sigurimit të automjeteve, mbledhjes së doganave dhe MIK. Ka pasur gjithashtu diskutime konstruktive për të përmirësuar bashkëpunimin në trajtimin e të zhvendosurve nga Kosova. Hapat e ndërmarrë i kanë dhënë një vrull të ri normalizimit të marrëdhënieve dhe ata duhet të kenë ndikim pozitiv dhe konkret në jetën e përditshme të qytetarëve, si në Serbi ashtu edhe në Kosovë.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Deficiti i vazhdueshëm tregtar pasqyron bazën e dobët të prodhimit dhe mungesën e konkurrencës ndërkombëtare. Mbështetja në remitenca dhe ekonomia joformale e përhapur gjithandej zvogëlojnë mundësitë për punësim, duke ndikuar kështu në pjesëmarrjen e vogël në tregun e punës dhe në papunësinë e madhe, e cila arrin shifrën 35.3%, kurse tek të rinjtë arrin në 61%. Administrata publike jofikase dhe një qasje “ad hoc” ndaj politikave fiskale paraqesin rreziqe të konsiderueshme fiskale. Kosova duhet të fuqizojë kornizën fiskale afatmesme, duhet të përmirësojë transparencën e financave publike dhe duhet të orientojë shpenzimet e buxhetit në rritjen ekonomike. Kosova po ashtu duhet të shpejtojë

privatizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve publike dhe duhet të përmirësojë procedurat e falimentimit dhe të paaftësisë së pagesave, si dhe duhet të zvogëlojë mbështetjen në taksat doganore, përmes zgjerimit të bazës tatimore vendore dhe modernizimit të mbledhjes së të hyrave.

Kosova është në një fazë të hershme në arritjen e kapacitetit për t'u përballur me presionet e konkurrencës dhe nevojat e tregut brenda Bashkimit Evropian. Ende nevojiten reforma të mëdha për të siguruar furnizim stabil me energji elektrike dhe për zvogëlim të humbjeve në shpërndarje, për të plotësuar nevojat për kuadro të tregut të punës dhe për orientimin e investimeve të huaja direkte dhe të remitencave në sektorë të prodhimit.

Kosova është në një fazë të hershme të harmonizimit të legjislacionit me **standardet evropiane**, përfshirë këtu prokurimin publik, statistikën dhe kontrollin financiar. Harmonizimi i legjislacionit në disa fusha është i lartë, mirëpo zbatimi është i dobët. Është shënuar pak progres në fushën e prokurimit publik, veçanërisht lidhur me aplikimin e një sistemi të centralizuar të prokurimit publik, mirëpo shqetësimet për korrupsion vazhdojnë të mbeten. Lidhur me kontrollin financiar, është shënuar pak progres, veçanërisht në auditimin e jashtëm. Megjithatë, nevojiten përpjekje të konsiderueshme për ushtrimin e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik, në administratë dhe në ndërmarrjet shoqërore.

2 KRITERET POLITIKE

2.1. Demokracia

Kosova ka vazhduar të konsolidojë funksionimin e institucioneve të saj demokratike. Pas zgjedhjeve të qershorit 2014, është formuar një Kuvend i ri dhe Qeveria e re ka marrë detyrën në muajin dhjetor. Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) vazhdojnë të zbatojnë mandatet e tyre. Mandati aktual i EULEX-it skadon në qershor 2016. Në krahasim me vitet tjera, situata në veri të Kosovës, e cila është e banuar kryesisht me serbë të Kosovës, është përmirësuar gjatë vitit 2015. Kosova ka shënuar pak progres në integrimin e strukturave të policisë dhe drejtësisë në veri dhe në muajin gusht 2015, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë- me Serbinë, të arritur në dialogun e lehtësuar nga BE, është pajtuar ta themelojë Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe. Kuvendi ka miratuar me sukses amendamentet kushtetuese dhe ligjet e nevojshme për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit Special për të hetuar krimet ndërkombëtare që janë kryer gjatë konfliktit 1999 dhe pas tij.

Zgjedhjet

Kuvendi i Kosovës mbetet të miratojë reformën zgjedhore e cila është vonuar. Anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venedikut mund të ndihmojë në këtë drejtim. Po ashtu, Kuvendi duhet të nisë një auditim të pavarur të financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore të partive, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Financimin e Partive Politike. Në janar 2015 janë mbajtur zgjedhjet komunale të menaxhuara mirë, pa incidente, në Graçanicë, një komunë kjo me shumicë serbe në Kosovën qendrore.

Parlamenti

Vonesa e konstituimit të Kuvendit pas zgjedhjeve të vitit 2014 e ka ngadalësuar procesin e reformimit në Kosovë. Pengimi i dhunshëm i sesioneve të fundit plenare nga deputetët e opozitës ka ndikuar negativisht në funksionimin e Kuvendit. Veprimet e tilla janë në kundërshtim me vlerat evropiane. Kuvendi duhet të jetë më efikas dhe të veprojë në përputhje me rregulloren e tij. Ai duhet të emërojë urgjentisht anëtarë kompetentë të organeve rregullatore dhe të atyre mbikëqyrëse, në mënyrë që të sigurojë funksionimin e duhur të administratës së shtetit, nëpërmjet proceseve të përzgjedhjes jopolitike, transparente dhe të bazuara në merita.

Gjashtë muaj pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2014, më 8 dhjetor, është bërë konstituimi i Kuvendit të ri. Partia Demokratike e Kosovës - PDK (me 35 ulëse) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK (me 33 ulëse) kanë krijuar një koalicion qeverisës me Iniciativën Qytetare "Srpska" (me 11 ulëse) dhe me grupin minoritar jo-serb '6+' (me 6 ulëse). Me 85 prej gjithsej 120 ulëseve, koalicioni qeverisës ka një shumicë të rehatshme. Lëvizja "Vetëvendosje" (me 16 ulëse) përbën bërthamën e një opozite të vogël, pro të zëshme.

Puna efektive e Kuvendit ishte ndërprerë që nga qershori e deri në dhjetor 2014. Megjithatë, pas marrëveshjes për qeverinë e re, është emëruar kryetari i Kuvendit dhe kuvendi e ka filluar punën e tij. Kuvendi e ka votuar qeverinë e re dhe në muajin dhjetor e ka miratuar buxhetit e vitit 2015. Ai e ka miratuar planin e tij të punës në muajin shkurt. Janë miratuar edhe disa ligje të rëndësishme, përfshirë ligjet për gjyqësorin dhe për të drejtat e njeriut. Të gjitha janë miratuar me procedurë të shpejtë. Kjo ka kufizuar mundësinë për debat parlamentar, që është një çështje shqetësuese.

Shumica e debateve në Kuvend janë zhvilluar në atmosferë të polarizuar në mes të koalicionit qeverisës dhe opozitës, në veçanti ato lidhur me çështjet e ndjeshme politikisht, si ajo e Dhomave të Specializuara dhe e dialogut me Serbinë. Bllokimi i sesioneve të fundit plenare nga ana e opozitës, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve të dhunshme, kanë ndikuar negativisht në funksionimin e Kuvendit dhe kanë zbehur besimin në gatishmërinë e opozitës për të marrë pjesë në debat demokratik. Kuvendi është institucioni kryesor demokratik dhe të gjithë deputetët e parlamentit duhet të lejohen të përmbushin detyrat e tyre.

Debatit parlamentar është cenuar edhe më shumë nga mungesa e sesioneve të rregullta plenare dhe tejkalimi i shpeshtë i kufizimeve kohore të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit. Kjo e ka dëmtuar cilësinë e pasqyrës parlamentare. Ka pasur edhe shkelje të rregullores nga ana e qeverisë, kur janë tërhequr në mënyrë arbitrare projektligjet e dorëzuara në Kuvend. Korniza e rregullore të Kuvendit duhet të përmirësohet. Kuvendi i ri duhet të fuqizojë mbikëqyrjen e tij për procesin ekzekutiv dhe legjislativ dhe duhet të aplikojë standardet për konsultime me shoqërinë civile. Kontrolli parlamentar dhe bilanci i kontrollit të shpenzimeve buxhetore duhet të përmirësohen. Kuvendi duhet të sigurojë raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Avokatit të Popullit. Duhet të ekzistojë një mekanizëm që siguron zbatimin e rekomandimeve të komisionit për mbikëqyrjen e financave publike.

Kuvendi duhet t'i mbikëqyrë institucionet e pavarura, autoritetet rregullative dhe agjencitë më drejtpërdrejt, bazuar në një mandat të qartë dhe me mekanizma të përshtatshëm raportues dhe llogaridhënës. Ai duhet të adresojë urgjentisht vonesat në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve dhe autoriteteve, dhe të përcaktojë mekanizmat për llogaridhënien e tyre. Emërimet duhet të bëhen në bazë të kualifikimeve profesionale dhe të meritës e jo në bazë të përkrrahjes politike.

Komisioni i BE-së për integrim duhet të fuqizohet më tej për të pasqyruar rolin e tij kryesor në përpjekjet e Kosovës për të lëvizur përpara drejt agjendës së saj për reformim evropian. Nevojitet paraqitje më e mirë e projekt-ligjeve, në mënyrë që të sigurojë harmonizimin me *acquis*. Administrata e Kuvendit duhet të fuqizojë kapacitetet e saj teknike për të mbështetur një politikëbërje efektive dhe për të përmirësuar shqyrtimin e projekt-ligjeve.

Qeverisja

Qeveria e re ka vazhduar të realizojë prioritetet e reformimit të ndërlidhura me BE-në dhe ka dhënë rezultate në dy obligime të mëdha ndërkombëtare në muajin gusht. Ekzekutivi duhet të sigurojë që legjislacioni dhe politikat të zbatohen në praktikë. Komunikimi i mirë në Kuvend, përfshirë përgjigjet e rregullta në pyetjet parlamentare dhe koordinimin e fuqishëm ndër-ministral, janë qenësore në këtë kuptim. Ndonëse legjislacioni për Avokatin e Popullit është përmirësuar, Qeveria e ka dobësuar funksionimin e tij efektiv, pasi vazhdimisht ka dështuar të sigurojë kushte të përshtatshme.

Qeveria e re e Kryeministrit Isa Mustafa (LDK) e mori detyrën në muajin dhjetor. Formimi i koalicionit është bërë pas një ngërçi të gjatë në mes të PDK-së dhe koalicionit paszgjedhor të udhëhequr nga LDK-ja. Prishja e këtij koalicioni ua mundësoi PDK-së dhe LDK-së të arrijnë një marrëveshje për ndarjen e pushtetit dhe për të formuar një koalicion të madh, të mbështetur edhe nga partitë minoritare. Qeveria ka 23 anëtarë, përfshirë Kryeministrin dhe tre zëvendës kryeministra. Në qeveri janë vetëm dy femra. Pesë pozita ministrore mbahen nga përfaqësuesit e minoriteteve, tre prej të cilëve e përfaqësojnë komunitetin serb, njëri komunitetin turk dhe njëri komunitetin boshnjak.

Qeveria e re ka vazhduar të zbatojë prioritetet e reformave, të ndërlidhura me BE-në, dhe është zotuar për dialogun me Serbinë, të lehtësuar nga BE-ja. Programi i qeverisë përqendrohet në zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit, reformën e ndërlidhur me integrimin në BE, arsimin, shkencën e kulturën dhe kujdesin shëndetësor. Me marrëveshjet e saj për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Asociacionit/Bashkësisë të komunave me shumicë serbe, qeveria ka regjistruar rezultate në dy obligimet ndërkombëtare kryesore, në gusht 2015.

Qeveria është ballafaquar me sfida të mëdha, përfshirë një kulmim të migrimit të parregullt nga një numër i konsiderueshëm qytetarësh të Kosovës, në fillim të vitit 2015, një numër të protestave të dhunshme dhe grevave, si dhe sulmet e dhunshme të opozitës, në shtator dhe tetor 2015. Shkarkimi i ministrit për Kthim dhe Komunitete, për shkak të deklaratave të tij për një incident në Gjakovë ka çuar në bojkotin tremujor të institucioneve nga partneri serb i koalicionit, “Srpska”. Emërimi i një ministri të ri serb në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim e ka kthyer Listën “Srpska” në Qeveri dhe në Kuvend.

Bashkëpunimi i kufizuar në mes të ministrive të udhëhequra nga PDK-ja dhe LDK-ja, në disa raste, e ka penguar efikasitetin në arritjen e progresit në fushat kryesore të qeverisjes. Qeveria duhet t’u ë përmbahet afateve të caktuara në strategjinë dhe planet e ndryshme të veprimit, me një koordinim dhe komunikim më të mirë në mes të partnerëve të koalicionit.

Qeveria ka vazhduar të zbatojë prioritetet e integritetit evropian. Për të mbështetur këtë proces dhe në pritje të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, institucionet e Kosovës kanë qenë të përfshira në përgatitjen e Programit të parë Kombëtar për Përshtatjen e *Acquis* të BE-së. Po ashtu, Kosova ka punuar në një sistem monitorimi dhe raportimi. Këshilli Kombëtar për Integritet Evropian ka vazhduar të takohet dhe të diskutojë objektivat kryesore dhe obligimet për politikën e integritetit të mëtejshëm me BE-në. Komisionet ekzekutive që janë përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e konkluzioneve të Dialogut për MSA-në kanë vazhduar të takohen.

Përpjekjet për të përmirësuar më tej kapacitetin e **qeverisë lokale** kanë vazhduar. Ministria e Administratës Publike aktualisht është duke punuar në efektshmërinë e numrit të pozitave të punës, nga rreth 8000 në 800. Ndonëse këto iniciativa do të mund të sillnin përfitime në efikasitet, qëllimi dhe zbatimi i tyre duhet të komunikohet më mirë. Ka pasur përmirësime në harmonizimin e statuteve të komunave me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Komunitet duhet të vazhdojnë përpjekjet për të rritur transparencën në vendimmarrje dhe për të fuqizuar mbikëqyrjen e kuvendeve komunale.

Komunitet me shumicë serbe në jug i kanë dorëzuar buxhetet e tyre, të cilat ishin aprovuar në përputhje me ato të komunave të tjera. Ato kanë marrë pjesë edhe në regjistrimin e pronave bujqësore, të cilin e kanë bojkotuar komunitetet veriore. Disa komuna jugore me shumicë serbe ballafaqohen me vështirësi buxhetore, pjesërisht për shkak të shifrave të pasakta të popullsisë dhe bllokimit politik. Në prill të vitit 2015, komunitet në veri kanë aprovuar buxhetet e tyre në përputhshmëri me legjislacionin e Kosovës, të cilat përfshinin edhe numrin e punëtorëve në sektorin e shëndetësisë dhe në atë të arsimit.

Më 3 gusht, Kuvendi i Kosovës ka miratuar **amendamentet kushtetuese** që mundësojnë themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit Special. Duhet të bëhen ndryshime të Kushtetutës në mënyrë që të mundësohet që shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të zgjidhen nga kolegët e tyre, në përputhje me rekomandimet e Komisionit

të Venedikut. Pas anëtarësimit të Kosovës në Komisionin e Venedikut (qershor 2014), dy gjykatës të Gjykatës Kushtetuese janë emëruar si përfaqësues të Kosovës. Gjykata Kushtetuese funksionon me një kuorum prej shtatë gjykatësish, ndërsa dy emëtime janë aktualisht në pritje.

Kuvendi e ka zgjedhur një **Avokat të ri të Popullit**, në korrik 2015. Po ashtu, Kuvendi e ka miratuar Ligjin e ri për Avokatin e Popullit, në maj të vitit 2015, duke bërë kështu një hap të rëndësishëm drejt qartësimit të kornizës ligjore dhe fuqizimit të pavarësisë dhe paanësisë së këtij institucioni. Megjithatë, në praktikë qeveria e ka dobësuar kapacitetin e këtij institucioni për të kryer detyrat e tij, për shkak të pamundësisë që të sigurojë kushte të përshtatshme për punë. Më 2014, Avokati i Popullit i ka pranuar 2.224 raste, 8.6 % më shumë se në vitin 2013. Autoritetet kosovare në nivel qendror dhe lokal nuk janë angazhuar për zbatimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Komisioni i Kuvendit për të drejtat e njeriut dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit duhet të rikonfirmojnë dhe të zbatojnë zotimet e tyre për ta bërë këtë.

Shoqëria civile

Është shënuar pak progres në përmirësimin e bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile. Megjithatë, kontributi i shoqërisë civile duhet të kërkohej dhe të ndiqet në mënyrë sistematike. Strategjia e qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile duhet të zbatohet plotësisht dhe të monitorohet në mënyrë efektive. Duhet të merren masa shtesë për të siguruar se organizatat e shoqërisë civile janë të përfshira në konsultimet publike. Financimi publik për organizatat e shoqërisë civile duhet të sigurohet në mënyrë transparente, duke aplikuar kritere të përcaktuara qartë.

Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponentë qenësore e çdo sistemi demokratik dhe, si e tillë duhet të njihet dhe të trajtohet edhe nga institucionet e Kosovës. Zbatimi i strategjisë së qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile monitorohet nga Këshilli për zbatimin e strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile. Deri më sot, Këshilli ka menaxhuar vetëm hartimin e planit të tij të punës dhe krijimin e katër grupeve punuese. Mungesa e pjesëmarrjes së duhur nga ministritë përkatëse, burimet dhe kapacitetet e pamjaftueshme, si edhe varësia tepër e madhe financiare nga donatorët dëshmojnë mungesën e vullnetit politik për bashkëpunim të vërtet me shoqërinë civile. Kërkohej më shumë punë për të siguruar zbatimin konsekuent të kornizës ligjore ekzistuese për bashkëpunim me shoqërinë civile. Konsultimi duhet të bëhet me kohë dhe përzgjedhja e përfaqësuesve të shoqërisë civile duhet të jetë transparente.

Mënyra në të cilën sigurohet financimi publik për shoqërinë civile është jotransparente dhe e parregulluar. Qeveria duhet të krijojë standarde dhe kritere për rregullimin e financimit publik të organizatave të shoqërisë civile, ashtu që të sigurojë shtetë të transparencës, llogaridhënie dhe besueshmëri në këtë proces. Ulja e tatimit të donacioneve private është rritur nga 5 deri 10%, mirëpo korniza ligjore për uljen e tatimeve mbetet e paqartë dhe nuk është e harmonizuar me dispozitat e ligjit për lirinë e asociimit.

Së fundi, amendamenti i Ligjit për Shpëlarjen e Parave dhe Ligji për Luftimin e Terrorizmit kanë çuar në pezullimin e aktiviteteve të 14 OJQ-ve, duke u lënë kështu vend vendimeve arbitrare për pezullim.

Ndonëse qasja në takimet e kryesisë së Kuvendit ka qenë e mundshme për shoqërinë civile, deklaratat e Kuvendit për partneritet në mes këtij të fundit dhe shoqërisë civile nuk kanë dhënë ende rezultate konkrete.

Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Progres i kufizuar është shënuar në punën e komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Personeli administrativ i komisionit

ka siguruar vazhdimësi të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë gjatë mandateve të njëpasnjëshme të kuvendit, mirëpo komisioni duhet të ushtrojë ende kontrollin e duhur parlamentar dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve. Lidhjet e ngushta mes disa parlamentarëve dhe ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës i kanë penguar vlerësimet e pavarura.

Amendamenti i Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë e ka përmirësuar procesin e verifikimit. Megjithatë, verifikimi ende bëhet nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, në vend të një organi të veçantë të dedikuar. Këshilli i Sigurisë së Kosovës, i cili duhet të ketë rol këshillimor në të gjitha çështjet e sigurisë nuk mban takime të rregullta, ashtu siç përcaktohet në mandatin e tij.

2.2. Reforma e administratës publike

Kosova **ka arritur një nivel të përgatitjes** në reformimin e administratës publike. **Përparim i mirë** është bërë në zhvillimin e një kornize strategjike gjithëpërfshirëse për reformën e administratës publike (RAP) dhe për përmirësimin e legjislacionit. Për herë të parë, reforma e administratës publike ka marrë mbështetjen dhe zotimin e nivelit të lartë politik. Duke ditur agjendën ambicioze të Kosovës për reformim, zotimi politik i fuqishëm dhe i vazhdueshëm është qenësor për të siguruar zbatimin e reformave. Në vitin e ardhshëm, Kosova në mënyrë të veçantë, duhet:

- të monitorojë në mënyrë efektive zbatimin e kornizës strategjike për RAP nën ombrellën e strategjisë më të gjerë zhvillimore, duke siguruar kështu një lidhje të qartë në mes të RAP dhe zhvillimit ekonomik;
- të përmirësojë llogaridhënien përmes një rishikimi të plotë të të gjitha agjencive dhe përmirësimit të qasjes në drejtësi administrative, përmes adresimit të rasteve të pazgjidhura administrative;
- të aprovojë një program gjithëpërfshirës për reformimin e menaxhimit financiar publik.

Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Ligji për shërbimin civil qeveris kushtet e punësimit të shërbyesve civilë në nivelin qendror dhe atë lokal. Ligji mbështet **rekrutimin dhe avancimin duke u bazuar në meritë** e në përputhje me parimet e administratës publike, mirëpo ai nuk zbatohet plotësisht. Kjo vlen veçanërisht për pozitat e shërbyesve të lartë civilë dhe për emërimet e bordeve të entiteteve publike, ku ndikimi politik në emërimet është një çështje shqetësuese. Komunitetet jo shumicë nuk janë ende të përfaqësuara si duhet në institucionet publike. Një pengesë e madhe në këtë drejtim është mosnjohja e vazhdueshme e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës, që është një universitet në të cilin studiojnë shumë studentë të komuniteteve jo-shumicë.

Ligji për Shërbyesit Civilë gjithashtu rregullon kriteret e njëjta për **shkarkime**. Ai përcakton masat disiplinore, duke përfshirë k edhe mundësitë për ankesa. Disa rekomandime të bordit të pavarur mbikëqyrës janë zbatuar, kurse vendimet nuk janë zbatuar. Gjykatësit administrativë janë të mbingarkuar, gjë që shpesh shkakton vonesa të vendimeve. Shumë rekomandime të Avokatit të Popullit nuk janë zbatuar, shpesh edhe pa kurrfarë shpjegimi.

Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për koordinimin qendror të **menaxhimit të burimeve njerëzore**. Burimet në kuadër të kësaj ministrie janë shumë të kufizuara, gjë që ia pamundëson asaj të promovojë në mënyrë efektive aplikimin e legjislacionit dhe parimeve të njëjta në tërë administratën publike. Mungon menaxhimi profesional i burimeve njerëzore, për shkak të politizimit dhe kapaciteteve të kufizuara. Sistemi informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk është i përditësuar. Qeveria duhet të sigurojë që ky sistem të funksionojë si duhet.

Sistemi i pagesës së shërbyesve civilë nuk garanton pagesë të barabartë për punën e njëjtë, ndonëse klasifikimi i standardizuar i vendeve të punës ekziston që nga viti 2010. Në praktikë aplikohen koeficiente të ndryshme të pagave për pozita të ngjashme. Pagesa më e drejtë po pamundësohet nga vonesa e reformimit të klasifikimit të vendeve të punës. Megjithatë, këtu do të ndihmojë Katalogu i vendeve të punës, i aprovuar së fundi. Një hap pozitiv ishte pezullimi i përkohshëm i pagave shtesë, në shtator të vitit 2015, për të siguruar një qasje më të rregulluar, të bazuar në meritë.

Zhvillimi profesional i shërbyesve civilë nuk është i mjaftueshëm. Trajnimi sistematik pengohet nga mungesa e burimeve dhe objekteve të përshtatshme të Institutit të Kosovës për Administratë Publike. Vlerësimet e performancës përmenden në ligj, mirëpo në praktikë ato trajtohen si formalitet. Kosova ka aprovuar masat dhe mekanizmat për parandalimin e korrupsionit dhe për promovimin e **integritetit në shërbimin publik**. Aprovimi i Kodit të Etikës të shërbyesve civilë, në mars 2015, është një zhvillim pozitiv, i cili tani duhet të dëshmojë ndikimin praktik. Besimi publik në institucione shpesh dëmtohet nga korrupsioni.

Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

Baza ligjore dhe struktura institucionale, përfshirë edhe ato për integrimin evropian, janë mjaft të pranishme, për të siguruar një **sistem politikëbërës** të qëndrueshëm, mirëpo në praktikë planifikimi i politikave është i ndarë dhe mungon prioritizimi në nivel qeveritar. Strategjitë e sektorit rrallë kanë qenë të qëndrueshme financiarisht. Që nga qershori 2015, të gjitha strategjitë dhe politikat duhet të përmbajnë një analizë të ndikimit fiskal.

Disa aspekte të **zhvillimit legjislativ dhe të politikave gjithëpërfshirës, bazuar në dëshmi**, janë të pranishme. Janë bërë përmirësime të mëdha në zhvillimin e politikave, edhe pse kapacitetet e politikëbërjes dhe hartimit të ligjeve, përfshirë kapacitetet për përputhshmëri me *acquis*, ende janë të pamjaftueshme. Konsultimet ndër-ministore dhe publike janë rregulluar, mirëpo afatet shpesh janë tepër të shkurtra për të mundësuar kontributin efektiv të shoqërisë civile. Qeveria duhet të zbatojë standardet minimale për konsultim publik efektiv. Vlerësimet e ndikimit të rregullatorëve nuk bëhen në mënyrë të vazhdueshme, me përjashtim të një numri të fushave pilot.

Vëzhgimi publik i punës së qeverisë në teori është i mundshëm, meqë qeveria raporton për çdo vit për zbatimin e dokumenteve kryesore strategjike. Megjithatë, përqendrimi është më shumë në arritjen e rezultateve se sa në ndikimin e politikave qeveritare. Nuk është raportuar për zbatimin e strategjive sektoriale. Vëzhgimi parlamentar i punës së qeverisë po pengohet nga ndryshimet e shpeshta të planit legjislativ të qeverisë.

Llogaridhënia e administratës

Organizimi i përgjithshëm i administratës së shtetit nuk është në favor të funksionimit të **sistemit të llogaridhënies**. Korniza e dobët ligjore ka rezultuar me përgjegjësi të dyfishta në mbi 70 agjenci qeveritare dhe një numër të madh të institucioneve jo-kushtetuese që i raportojnë drejtpërdrejt Kuvendit. Kuvendi shpesh nuk ka fuqi dhe kapacitete të mbikëqyrë në mënyrë efektive aktivitetet e tyre. Linjat e llogaridhënies në kuadër të institucioneve janë të dobëta dhe mungon delegimi i autorizimeve tek menaxhmenti i mesëm. Llogaridhënia menaxheriale nuk është rrënjësore ende nga kultura administrative. (*Shih Kontrollin financiar*)

Mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm janë krijuar për të mbrojtur **të drejtën e qytetarëve për administratë të mirë**. Megjithatë, vëzhgimi i institucioneve, si ai i Auditorit të Përgjithshëm dhe ai i Avokatit të Popullit, është kufizuar shumë nga administrata e shtetit, e cila u kushton pak vëmendje rekomandimeve të tyre. **E drejta për të pasur qasje në informacione publike** është e rregulluar me ligjin për qasje në dokumentet publike. Gjatë dy viteve të kaluara, numri i kërkesave të refuzuara ose të patrajuara ka qenë i ulët (vetëm 5% prej afro 2 000 kërkesave të bëra çdo vit)

Nuk është bërë përparim në **të drejtën për drejtësi administrative**, meqë Ligji për procedurën

e përgjithshme administrative nuk është miratuar ende. Numri në rritje i rasteve të patrajuara të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve administrative po e dëmton besimin e publikut në sistemin e gjykatave. E **drejta për të kërkuar kompensim** nuk është siguruar ende në mënyrë efektive, për shkak të legjislacionit të ndarë dhe mungesës së një ligji të veçantë për obligimet publike.

Menaxhimi financiar publik

Deri më tash Kosova është përqendruar në përmirësimin e financave të saj publike, veçmas përmes adresimit të fushave të caktara të financave publike, pa i lidhur ato saktë dhe ndjekjes së reformave në kuadër të një **programi reformues** më gjithëpërfshirës **për menaxhimin financiar publik**. Megjithatë, pas një vlerësimi të shpenzimeve publike dhe llogaridhënies financiare dhe vlerësimeve të tjera përkatëse, Kosova tani është duke përgatitur një strategji gjithëpërfshirëse dhe një plan veprimi, i cili do të miratohet në fillim të vitit 2016. Kjo duhet të marrë parasysh strategjinë e kontrollit financiar, të brendshëm, publik që nga prilli 2015 dhe strategjinë e re të prokurimit publik, e cila pritet të miratohet.

Procesi i planifikimit buxhetor vjetor bazohet në qasjen e grupimit sipas përmbajtjes së pasqyrave financiare. Borxhi publik është ende i ulët dhe i qëndrueshëm, edhe pse huamarrja vendore dhe ndërkombëtare është rritur. **Transparenca e buxhetit** është e pamjaftueshme. Në veçanti, informacionet për buxhetin duhet të jenë më të besueshme dhe më gjithëpërfshirëse, për të fuqizuar llogaridhënien. Prezantimi i informacioneve buxhetore kryesore në një mënyrë me qasje do të krijonte besim te publiku në përgjithësi dhe do të kontribuonte në një marrëdhënie më të mirë qytetar-shtet.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset

Qeveria është e zotuar për një **administratë të orientuar kah përdoruesit**. Megjithatë, zhvillimi i një politike koherente shpesh pengohet nga mungesa e koordinimit dhe vizionit të përbashkët në mes ministrive përkatëse. Zhvillimi i shërbimeve elektronike është i ngadalshëm, për shkak të mungesës së një kornize të duhur të ndër-veprimit. Ekziston legjislacioni për qasje të barabartë në shërbime, mirëpo implementimi i saj është sfidë, veçanërisht për qytetarët me aftësi të kufizuara. **Thjeshtimi i procedurave administrative** mbetet të bëhet pas miratimit të ligjit për procedurat e përgjithshme administrative.

Korniza strategjike për reformën e administratës publike

Një kornizë **strategjike e reformës së administratës publike** është krijuar nën ombrellën e strategjisë zhvillimore 2015-2020. Ajo përfshin strategjinë për modernizimin e reformës së administratës publike 2015-2020 dhe planin shoqërues të veprimit 2015-2017, të miratuar në muajin shtator. Kjo strategji përcakton objektivat dhe treguesit e matshëm, përfshirë analizën e ndikimit fiskal, që është një hap i rëndësishëm përpara. Ministria e Administratës Publike do të ketë nevojë për burime të mjaftueshme njerëzore, për të siguruar koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të saj. Korniza e re përfshin gjithashtu një strategji të aprovuar në qershor 2015 për një sistem të integruar planifikimi, të koordinuar nga Zyra e Kryeministrit, dhe një strategji të re për menaxhimin e financave publike, e cila është në përgatitje e sipër.

Mbështetja politike dhe zotimi politik janë rritur dukshëm në muajt e fundit dhe Këshilli Ministror, i kryesuar nga Kryeministri, po siguron drejtimin dhe koordinimin e nevojshëm. Korniza monitoruese dhe raportuese është e përgatitur, por mbetet të zbatohet. Duhet të sigurohen burime të qëndrueshme, veçanërisht në Ministrinë e Administratës Publike. **Qëndrueshmëria financiare** duhet të sigurohet me buxhetin e vitit 2016 dhe me kornizën afatmesme të shpenzimeve.

2.3. Sundimi i ligjit

Funksionimi i gjyqësorit

Sistemi gjyqësor i Kosovës është **në një fazë të hershme** të zhvillimit të një sistemi të drejtësisë që funksionon mirë. Vitin e kaluar **është parë pak progres, me** miratimin e ëë pakos së katëër ligjeve (Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Prokurorinë e Shtetit).

Megjithatë, administrata e drejtësisë është e ngadalshme dhe ka llogaridhënie të pamjaftueshme nga ana e zyrtarëve gjyqësorë. Strukturat gjyqësore janë ende të ndjeshme ndaj ndërhyrjeve politike. Ka shqetësime se emërimet e dyshuara dhe mandatet e paqarta kanë penguar aktivitetet e institucioneve kryesore, si të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Zyrave të Prokurorisë së Kosovës dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Institucionet e sundimit të ligjit vujanë nga një mungesë e vazhdueshme e financimit.

Në adresimin e mangësive të paraqitura në vijim, vitin e ardhshëm, Kosova duhet:

- të zbatojë pakon e drejtësisë, përfshirë miratimin me kohë të legjislacionit sekondar;
- të rrisë burimet financiare dhe njerëzore në sektorin gjyqësor, në mënyrë që të sigurojë funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor;
- të sigurojë emërimet të ligjshme dhe me kohë në institucionet kryesore, si Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- të reduktojë më tej numrin e rasteve ende të pazgjidhura.

Dokumentet strategjike

Plani strategjik 2014-2019 për gjyqësorin e Kosovës, strategjia për komunikim 2014-2019 dhe strategjia kombëtare për zvogëlimin e numrit të rasteve në pritje janë duke u zbatuar, duke adresuar kështu mungesat e rëndësishme në gjyqësor.

Organet menaxhuese

Sipas Kushtetutës, **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)** janë përgjegjës për sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit. Që të dyja këto këshilla kanë një përbërje të përzier. Në KGjK, pesë nga 13 anëtarët janë zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit të Kosovës kurse tetë anëtarë janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo paraqet ndërhyrje të fortë politike dhe rrezikon pavarësinë e gjyqësorit. Kjo nuk ka ndryshuar as me ligjin e ri, meqë kërkon ndryshimin e Kushtetutës. Në KPK, pesë nga nëntë anëtarët janë zgjedhur nga prokurorët, tre të tjerë janë jo-prokurorë të zgjedhur nga vetë Këshilli, kurse një anëtar është *ex officio* – Ministri i Drejtësisë. Ligji i ri parashikon një përbërje të re, duke rritur numrin e anëtarëve nga nëntë në 13, dhjetë prej të cilëve do të zgjidhen nga kolegët e tyre, kurse tre nga Kuvendi. Po ashtu, sipas ligjit të ri, që nga 1 janari 2016, KPK do të mund të kontrollojë burimet e veta buxhetore. Të gjitha takimet e KGjK-së dhe KPK-së janë të hapura për mediet dhe për publikun. Që të dyja këto këshilla hartojnë dhe aprovojë raporte mujore për punën e tyre, ashtu siç parashihet me ligj, mirëpo mekanizmat e tyre të brendshëm të raportimit kanë nevojë ende të përmirësohen.

Pas konkurseve të shpallura nga KGjK dhe KPK, në mars 2015, janë pranuar aplikacione për gjykatës dhe prokurorë serbë të Kosovës, për gjykatat në jug dhe në veri të Kosovës, në përpunje me marrëveshjen politike në mes Beogradit dhe Prishtinës. Disa pozita janë plotësuar në korrik 2015, gjë që paraqet një hap të rëndësishëm drejt integritetit të gjyqësorit në veri.

KGjK dhe KPK kanë pasur vonesa të konsiderueshme në aprovimin e dokumenteve strategjike, rregulloreve dhe vendimeve e akteve të tjera. Ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për hartimin e rregulloreve dhe për marrjen e vendimeve në përputhje të plotë me aktet normative në fuqi. Në KGjK dhe KPK ka mungesë të kapaciteteve për të monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre.

Pavarësia dhe paanësia

Kryetarët e gjykatave janë përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e gjykatave të tyre. Si Kushtetuta ashtu edhe ligjet ende lejojnë ndikim politik në gjyqësor, në veçanti mbi KGjK dhe çështjet e ndërlidhura me burimet njerëzore. Aktivitetet e KGjK-së dhe KPK-së janë penguar nga kriza politike pas zgjedhjeve, posaçërisht presioni politik në procesin e zgjatur të emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit. Amendamentet në ligjet e reja, të miratuara në maj 2015, janë në harmoni me shumicën e rekomandimeve të BE-së. Duhet amendamente shtesë që përfshijnë nene tranzicionale.

Nuk ka sistem funksional dhe elektronik për menaxhimin e rasteve. **Caktimi i rasteve** te gjykatësit bëhet me tërheqjen e shortit. Rastet urgjente i caktohen kryetarit të trupit gjykues. Rastet e ndjeshme caktohen, mirëpo jo gjithmonë edhe trajtohen. Numri i gjykatësve që merren me krime të rënda mbetet i vogël. KGjK, si organ kompetent për të vepruar në rast të kërcënimeve ndaj gjykatësve, duhet të rrisë vetëdijesimin në mesin e gjykatësve për mekanizmat mbrojtës ekzistues për mbrojtjen e tyre.

Llogaridhënia

Kodi i etikës për gjykatës, prokurorë dhe avokatë është i përgatitur. KGjK dhe KPK janë përgjegjës për **masat disiplinore**. Duhet të miratohen dispozitat e tjera për masat disiplinore, si ligji për Zyrën e Gjykatës Disiplinore/Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZGJD/ZPD) dhe dispozitat për rishikimin gjyqësor të vendimeve disiplinore të marra nga Këshillat. ZGJD/ZPD ka nisur rreth 40 raste kundër prokurorëve, mbi bazë disiplinore dhe etike. Presidentja e Kosovës, bazuar në rekomandimet e bëra nga KGjK dhe KPK, ka shkarkuar një gjykatës dhe një prokuror. Pesë zyrtarë të administratës gjyqësore të dyshuar për keqpërdorim të detyrës janë suspenduar dhe më vonë janë shkarkuar nga detyra. Përveç këtyre, një gjykatës është suspenduar nga ODC, për shkak të supozimeve për marrje ryshfeti. Sipas ligjeve të zbatueshme, gjykatësit dhe prokurorët janë të detyruar të **deklarojnë pasuritë e tyre** dhe dhuratat e marra, si dhe të raportojnë për çdo konflikt eventual të interesit.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Sipas Kushtetutës së Kosovës, Presidentja e Kosovës **emëron** gjykatësit dhe prokurorët për një afat fillestar trevjeçar, me propozim të KGjK-së, respektivisht KPK-së. Provimi pranues për gjykatës dhe prokurorë bazohet në merita. Ligjet e reja parashohin një trajnim fillestar të detyrueshëm pas emërimit, si për gjykatës ashtu edhe për prokurorë. **Vlerësimi** i performancës së prokurorëve me mandat të përhershëm duhet të bëhet nga KPK-ja çdo tre vjet, mirëpo në këtë drejtim ka pasur vonesa të mëdha. Vlerësimi i gjykatësve bëhet nga Komisioni për Vlerësimin e Gjykatësve dhe kjo është bërë sipas planit. Deri më sot, shumica e gjykatësve dhe prokurorëve që janë vlerësuar kanë kaluar; vetëm një gjykatës nuk është propozuar për emërim të përhershëm. Kriteret për performancën të bazuara në meritë dhe një sistem vlerësimi brenda periudhës fillestare të emërimit, në fund të trajnimit fillestar, duhet të aprovohen në mënyrë që të sigurojnë profesionalizëm.

Cilësia e drejtësisë

Instituti Gjyqësor i Kosovës (KJI) është përgjegjës për **trajnim** fillestar dhe të vazhdueshëm. Megjithatë, ligjet e reja i japin më shumë përgjegjësi KGJK-së dhe KPK-së sa i përket planifikimit të politikave dhe organizimit të kurseve trajnuese. Prej 29 kandidatëve të cilët janë diplomuar në programin fillestar të arsimit ligjor në maj, 17 janë emëruar gjykatës. KGjK dhe KPK përgatisin bashkërisht kurrikulën vjetore për trajnim në bazë të një vlerësimi bashkëkohor

për nevojat. Kurrikulat, të cilat ndahen në module trajnuese sipas përgjegjësi të departamenteve të gjykatave dhe zyrave të prokurorëve, specifikojnë fushat që do të mbulohen nga trajnimi, përfshirë këtu trajnimin për të drejtën e BE-së. Kurrikula e re për administratorët e gjykatave është aprovuar dhe stafi përkatës është trajnuar. Kosova aktualisht ka 19.5 gjykatës për 100 000 banorë. Gjithsej ajo ka 350 gjykatës vendorë dhe 33 gjykatës të EULEX-it.

Buxheti për shërbimin e prokurorisë së Kosovës dhe sistemin e gjykatave për vitin 2015 është rreth 28 milionë euro, duke mos përfshirë disa shërbime të tjera, si ndërmjetësimin dhe ndihmën ligjore. Buxheti i përgjithshëm i caktuar për sistemin e drejtësisë është rritur në 1.7 % të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Megjithatë, një përmbledhje e plotë e financave publike të caktuara për tërë sistemin gjyqësor ende nuk është në dispozicion të publikut.

Pallati i Drejtësisë është inauguruar në mars 2015, pas sigurimit të infrastrukturës për të mundësuar administrimin e drejtësisë në kushte të duhura. Deri më sot, në Pallatin e Drejtësisë janë vendosur Gjykata Supreme, Gjykata Themelore e Prishtinës, Gjykata e Apelit, Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Themelore e Prishtinës.

Nuk ekziston ndonjë sistem zyrtar për monitorimin e gjykatave. **Mjetet e drejtësisë elektronike** mbeten të pazhvilluara.

Që nga viti 2008, është funksional një sistem **ndërmjetësimi**, me shtatë qendra rajonale të ndërmjetësimit dhe 701 ndërmjetësues të licencuar nga Ministria e Drejtësisë, prej të cilëve 163 janë aktivë. Numri i rasteve është rritur vazhdimisht – në mes të vitit 2012 dhe korrik 2015 sistemi i ndërmjetësimit ka trajtuar 2.598 raste. Derisa noterët merren me më shumë raste, aftësitë e tyre profesionale duhet të përmirësohen. Si sistemi i ndërmjetësimit ashtu edhe ai i noterëve kërkojnë fuqizim të mëtutjeshëm.

Efikasiteti

Sipas Raportit Vjetor të Prokurorit të Shtetit, në fillim të vitit 2015, Prokurori i Shtetit ka pasur 120 706 raste në pritje për t'u zgjidhur. Në lidhje me këtë, sipas Departamentit të Statistikave të KGJK-së në fillim të vitit 2015, numri i rasteve të pazgjidhura ishte 91 545. Lidhur me **rastet ende të pazgjidhura** (rastet e parashtruara para 31 dhjetorit 2011), 16 090 raste janë shqyrtuar në fund të vitit 2014 prej gjithsej 41 038 rasteve të përgjithshme. Numri i rasteve të pazgjidhura në fillim të vitit 2015 ishte 24 948, prej të cilave rreth 3 000 raste kanë përfunduar gjatë gjysmës së parë të vitit 2015.

Gjykatat e Kosovës tani kanë një **normë shqyrtimi** 84% (nga 71%) të rasteve të zgjidhura brenda një viti. Nuk ka shifra për **kohën në dispozicion** (d.m.th. kohën mesatare prej paraqitjes së rastit e deri te vendimi) në gjykatat e Kosovës. Suksesi i gjyqësorit të Kosovës vazhdon të pengohet nga një nivel i lartë i korrupsionit të fshehtë dhe kërcënimit të pranishëm në sundimin ligjit dhe në institucionet publike të ndërlidhura me të. Koha e paraparë me ligj për hetimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit është shumë e shkurtër, gjë që rezulton në informata të pamjaftueshme nga ana e gjykatave për të marrë një vendim të informuar.

Luftimi i korrupsionit

Kosova është **në një fazë të hershme** të luftimit të korrupsionit. **Pak përparim** është bërë gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në përmirësimin e bashkëpunimit në mes të Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Prokurorisë, dhe për të kërkuar nga zyrtarët që të deklarojnë pronën dhe dhuratat. Megjithatë, progresi i përgjithshëm ka qenë i kufizuar dhe në këtë drejtim nevojitet vullnet dhe angazhim politik i fuqishëm për trajtimin e këtij fenomeni në mënyrë të duhur. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike është e nevojshme për të siguruar rezultate të vërteta në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë. Regjistrimi i përndjekjeve dhe dënimeve të suksesshme do të paraqiste një progres të vërtetë. Vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë adresimit të mungesave të paraqitura më poshtë:

- prioritetizimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, në mënyrë të veçantë në prokurimin publik, me qëllim që të shqiptohen dënime finale;
- fuqizimit të bashkëpunimit në mes të policisë dhe prokurorisë përmes ekipeve hetimore të përbashkëta në trajtimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë;
- zhvillimit të një sistemi efikas të monitorimit dhe regjistrimit të rasteve që trajtohen nga hetimi për të arritur te vendimet përfundimtare nga ana e gjykatave;
- rishikimit të ligjit për konfliktin e interesit dhe të të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të ndërlidhura me të, për ta sjellë atë në harmoni me standardet evropiane. Në veçanti, duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publikë dhe masat për parandalimin dhe sanksionimin e konflikteve të interesit dhe duhet të aprovohen rregullore për mospërsëritjen e vazhdueshme të tyre.

Regjistrimi

Kosova ende nuk ka një regjistër për **hetimet, përndjekjet dhe dënimet** në rastet e korrupsionit. Në vitin 2014, Agjencia Kundër Korrupsionit ka zhvilluar procedura administrative në 304 raste, prej të cilave 56 raste ishin bartur nga vitet e kaluara dhe 248 ishin raste të reja. Hetimet e rralla të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë nuk kanë rezultuar deri më sot në dënime përfundimtare.

Mosrealizimi i **hetimeve financiare** efektive është i lidhur ngushtë me ndikimet e paligjshme politike dhe me kapacitetin e kufizuar. Ekspertiza e Kosovës për të bërë hetime financiare të ndërlikuara dhe për të konfiskuar **pasuritë e fituara përmes veprave kriminale** është ende e kufizuar. Autoritete politike duhet të sigurojnë që organet e zbatimit të ligjit janë të autorizuar plotësisht që të veprojnë në mënyrë efektive dhe të paanshme gjatë hetimit të dyshimeve për korrupsion.

Dhjetë partitë politike nuk i kanë dorëzuar raportet e tyre për **financimin e partive dhe financimin e fushatave zgjedhore** gjatë zgjedhjeve lokale, mirëpo të gjitha partitë e kanë bërë këtë gjatë zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2014. Deri më tash nuk është vërejtur asnjë parregullsi. Auditorët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk janë të pavarur me që zgjidhen nga Kuvendi. Për të parandaluar **konfliktin e interesit**, auditimi i tillë duhet të bëhet nga jashtë. **Sinjalizimi** (në ang: whistle-blowing) dhe **mbrojtja e dëshmitarëve** duhet të zbatohen në mënyrë të drejtë, përfshirë edhe bashkëpunimin më të mirë rajonal dhe ndërkombëtar.

Deklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë është bërë publik në uebfaqen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe 98.3% e zyrtarëve të lartë publike kanë raportuar pasurinë e tyre në vitin 2015. Akuza kriminale janë ngritur kundër 71 zyrtarëve të lartë publikë, të cilët nuk i kishin deklaruar pasuritë e tyre. Në vitin 2015, Agjencia kundër Korrupsionit ka përzgjedhur 20% të

zyrtarëve për rishikim të pronësisë së tyre. Ky është një zhvillim pozitiv, mirëpo mund të përmirësohej më tej përmes prioritetizimit të pozitave që janë të prirura për korrupsion.

Kosova duhet të konsiderojë masat që mundësojnë hetimin efektiv të pasurisë së pashpjegueshme.

Korniza institucionale

Katër institucionet kryesore në luftimin e korrupsionit në Kosovë janë: Agjencia Kundër Korrupsionit, një agjenci e pavarur dhe e specializuar; Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, një këshill konsultativ që kryesohet nga Presidentja e Kosovës; Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, i cili emërohet nga Kryeprokurori i Shtetit; dhe Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, në kuadër të Policisë së Kosovës. Agjencia kundër Korrupsionit nuk ka autoritet të plotë hetimor: roli i saj është më shumë i drejtuar në parandalim dhe hetime administrative preliminare, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ekziston një shqitje e përgjithshme dhe mungesë e integritetit në mesin e organeve kryesore kundër korrupsionit në Kosovë, të cilat vuajnë nga mandate të dyfishuara dhe nga ndarja e paqartë e detyrave.

Në **parandalim**, Agjencia Kundër Korrupsionit ka nisur një fushatë vetëdijesimi kundër korrupsionit në dhjetor 2014. Qytetarët janë inkurajuar që të raportojnë sjelljen korruptive të agjencisë për sundimin e ligjit, mirëpo mbetet ende shumë për t'u bërë. Derisa shoqëria civile është e përfshirë në zhvillimin dhe monitorimin e politikës kundër korrupsionit, konsultimet duhet të përmirësohen përmes komunikimit të rregullt, transparent dhe konstruktiv.

Organet e prokurimit publik kanë dështuar shumë në sigurimin e monitorimit sistematik dhe rishikimin e vendimeve të prokurimit. Është qenësore që të emërohen anëtarë të rinj të bordeve kompetente për të profesionalizuar dhe depolitizuar sistemin e prokurimit.

Në **sundimin e ligjit**, nga një prokuror është caktuar në secilën zyrë të Prokurorit të Prokurorisë Themelore, për të rritur bashkërendimin dhe komunikimin ndërmjet Prokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit. Mbi 70% e rasteve për të cilat Agjencia ka kryer hetime preliminare janë hedhur poshtë, kryesisht për shkak se prokurorët nuk kanë gjetur bazë/dëshmi të mjaftueshme për të vazhduar hetimet. Hetuesit e Agjencisë duhet të rrisin cilësinë e raportimit të tyre, ndërsa prokurorët duhet të demonstrojnë kapacitetet të nevojshëm dhe gatishmëri për ndjekjen e rasteve.

Me emërimin e një Koordinatori Kombëtar Kundër Krimit Ekonomik është arritur një bashkëpunim më i strukturuar në mes agjencive për sundimin e ligjit. Task Forca Kundër Korrupsionit, me 30 hetues, tetë prokurorë dhe pesë ekspertë, të cilët fokusohen në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit financiar, duhet të fuqizohet më tej për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive. Një hap pozitiv është aprovimi i procedurës operative standarde në prioritetizimin e rasteve të krimeve të rënda në vitin 2014, të cilat rezultuan me nëntë raste të krimeve të rënda që aktualisht janë duke u trajtuar si prioritet, përfshirë këtu akuzat për korrupsion dhe për shpëlarje të parave. Dy prej këtyre rasteve janë dërguar në gjykatë.

Korniza ligjore

Korniza ligjore kundër korrupsionit është konsoliduar me amendamentimin e ligjit për financimin e partive politike dhe ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë zyrtarët publikë. Në këtë të fundit u zgjerua edhe lista e personave të detyruar për ta deklaruar pasurinë e tyre dhe u zvogëlua pragu për vlerën e pasurisë së luajtshme që duhet deklaruar nga 5 000 euro në 3 000 euro dhe kjo ka çuar në rritjen e numrit të deklaratave të pasurisë dhe të dhuratave. Këto ligje janë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Kosovës, që sigurojnë se shkeljet e ndërlydhura me korrupsionin penalizohen. Në këtë mënyrë, Kosova është përafëruar me *acquis*.

Ligji për konfliktin e interesit në Kosovë duhet të rishikohet ende. Fushëveprimi i këtij ligji nuk duhet të përjashtojë kategoritë e caktuara të zyrtarëve publikë, si këshilltarët politikë, mirëpo duhet të përcaktojë zyrtarë publikë në përputhje me standardet evropiane. Ngjashëm, ky ligj duhet të paraqesë rrethanat e sakta në të cilat zyrtarët publikë mund të angazhojnë pozita pune dhe emërime shtesë. Në këtë ligj duhet të përcaktohen procedurat e qartë për identifikimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve të interesit. Legjislacioni përkatës duhet të harmonizohet në përputhje me këtë, në veçanti lidhur me regjimin sanksionues, përfshirë masat disiplinore.

Korniza rregullative për financimin e partive politike ka pësuar disa ndryshime. Mbyllja e shtigjeve të ndryshme ka përmirësuar procesin. Megjithatë, në këtë fushë mbeten sfida të mëdha, respektivisht të metat në mënyrën se si zbatohen rregullat, mungesa e monitorimit dhe mungesa e organeve rregullatore. Në përgjithësi, financimi i partive politike nuk ka mekanizëm të duhur për kontrollim, të cilët do të përmirësonin transparencën dhe do të kufizonin sjelljen e keqe të partive politike.

Korniza strategjike

Kosova është duke zbatuar Strategjinë Kundër Korrupsionit 2013-2017 dhe planin e veprimit, nën mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Megjithatë, financimi jo i duhur dhe mungesa e ndonjë treguesi të matshëm të ndikimit po i dëmtojnë rezultatet. Zbatimi i strategjisë 2014- 2018 dhe planit të veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare po bëhet sipas planifikimit. Përveç kësaj, vitin e kaluar (2015) janë publikuar planet e veprimit sektorial për të luftuar korrupsionin, veçanërisht në fusha të ndjeshme (dogana, policia, administrata tatimore etj.). Një vlerësim i rrezikut nga korrupsioni në sektorin e shëndetësisë, arsimit, gjyqësorit, energjia dhe miniera, është publikuar në vitin 2015.

Luftimi i krimit të organizuar

Kosova është në një **fazë të hershme** të luftimit të krimit të organizuar. Gjatë vitit të kaluar është bërë **pak përparim** në bashkëpunimin ndër-institucional dhe në shkëmbimin e informatave ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit lidhur me hetimet. Kosova ka rritur gjithashtu përpjekjet e saj për të luftuar terrorizmin dhe fenomenin e luftëtarëve të huaj. Përgjithësisht, përqendrimi në strategji dhe plane veprimi nuk duhet të lë anash nevojën për rezultate reale në luftimin e krimit të organizuar endemik.

Numri i dënimeve përfundimtare dhe hetimeve financiare mbetet i ulët. Konfiskimet e pasurisë aplikohen rrallë. Gjatë adresimit të mungesave të paraqitura në vijim, qeveria vitin e ardhshëm duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- realizimit të hetimeve të ndërlidhura me krimin e organizuar, me qëllim të sigurimit të dënimeve përfundimtare, duke filluar kështu zhveshjen e grupeve kriminale aktive në Kosovë;
- aplikimit sistematik të mjeteve për hetime financiare dhe konfiskime të pasurisë në mënyrë që të rritet numri i konfiskimeve të përhershme dhe të ngritje së ekspertizës në të gjitha nivelet;
- zhvillimit të plotë të një qasjeje politike të udhëhequr nga intelijenca dhe mbledhjes, harmonizimit, analizimit dhe shfrytëzimit të statistikave kriminale përkatëse, përfshirë bashkëpunimin më të mirë ndërmjet agjencive.

Regjistrimi

Shkalla e dënimeve në rastet e **trafikimit me qenie njerëzore** mbetet e ulët, përkundër faktit se Kosova është një burim dhe vend tranzit për trafikimin e grave dhe fëmijëve. Kosova ka punuar ngushtë me Europol-in në zbulimin e rrjeteve të kontrabandimit të migrantëve.

Lidhur me **trafikimin e narkotikëve**, shkalla e konfiskimit të narkotikëve dhe shkalla e dënimeve mbeten të ulëta. Një numër hetimesh dhe arrestimesh janë bërë në përpjekje për të luftuar dhe parandaluar përhapjen e **terrorizmit** në Kosovë. Zbatimi i ligjeve, ligjeve sekondare dhe rregulloreve në fuqi për **shpëlarjen e parave dhe krimin e organizuar** është ende i pamjaftueshëm, përkundër përparimit të bërë në vendosjen e sistemeve të duhura. Ekziston një politikë e **hetimeve financiare** sistematike serioze, mirëpo mungojnë rezultatet. Shkalla e **konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurive kriminale** mbetet e ulët. Statistikat për sekuestrim dhe konfiskim nuk janë harmonizuar ende mjaftueshëm në mes Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor, Agjencisë për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe agjencive tjera. Derisa vlera e përgjithshme e pasurisë së ngrirë dhe të konfiskuar përkohësisht është rritur, vendimet përfundimtare të gjykatave janë të nevojshme për të siguruar që pasuritë e paligjshme konfiskohen përherë.

Ngjarjet në Kumanovë (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe përfshirja e qytetarëve të Kosovës në dhunën e armatosur dëshmon praninë e vazhdueshme të **grupeve të armatosura** në rajon, të cilat kërcënojnë stabilitetin ndër-etnik rajonal. Me armatim të nivelit ushtarak, trajnim ushtarak dhe struktura komanduese, grupet e tilla kanë kapacitet të dëmtojnë stabilitetin. Përfshirja e tyre në aktivitete kriminale të organizuara, si kontrabandimi me armë, dhe pandëshkueshmëria e qartë, çka u mundëson atyre të funksionojnë ndërmjet kufijve, janë një shqetësim i madh. Qeveria, agjencitë për zbatimin e ligjit dhe sistemi gjyqësor duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për shkatërrimin e këtyre rrjeteve.

Kapaciteti institucional dhe operacional

Policia e Kosovës ka një personel prej rreth 9 000 personash, që nënkupton se në përgjithësi janë rreth 500 policë për 100 000 banorë. Rreth 83 % e personelit të policisë janë shqiptarë etnikë, 13 % janë serbë etnikë, kurse pjesa tjetër vjen nga komunitetet tjera. Policia e Kosovës është e strukturuar në atë mënyrë që ajo ofron shteg karriere dhe ka mekanizëm vlerësimi, si dhe ka aprovuar kodin e etikës. Akademia e Kosovës për Siguri Publike është përgjegjëse për trajnime bazike e të specializuara dhe ofron një program bachelor në fushën e sigurisë publike. Policia e Kosovës ka **njësi të specializuara** që merren me aspekte të ndryshme të krimit të organizuar. Inspektorati i policisë është përgjegjës për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e shkeljeve penale të zyrtarëve policorë, pa marrë parasysh pozitën ose gradën.

12 prej 15 pozitave për prokurorë lokalë në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës janë plotësuar. Megjithatë, Zyra e Prokurorisë Speciale nuk ka burimet njerëzore që kërkohen për të përballuar punën e pritur duke pasur parasysh dorëzimin e planifikuar të rasteve nga EULEX-i. Prokurorët vendorë janë të dedikuar, mirëpo ata shpesh nuk e kanë ekspertizën e nevojshme teknike, veçanërisht në lidhje me hetimet e krimeve të luftës. Bashkëpunimi në mes të prokurorëve vendorë dhe të EULEX-it është përmirësuar.

Policia e udhëhequr nga intelijenca duhet të fuqizohet më tej, përfshirë burimet njerëzore dhe udhëheqjen menaxheriale. Sistemi i ri informativ i policisë së Kosovës mbetet të shfrytëzohet nga të gjitha nivelet e policisë së Kosovës, i cili do të mundësonte përmirësimin e analizës së rrezikut dhe operacioneve proaktive. Kosova nuk është anëtare e **Interpolit**, edhe pse ka aplikuar në prill të vitit 2015. Ajo aktualisht merr pjesë në strukturat e Interpolitit përmes ndërmjetësuesve të OKB-së. Kosova nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me **Europolin**. Policia e Kosovës, me kërkesë të shteteve anëtare udhëheqëse, ka qenë e përfshirë në tri operacione ndër-kufitare të mbështetura nga Europoli.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe laborator i saj për ADN dhe serologji i ka të gjitha

pajisjet dhe instrumentet e nevojshme për realizimin e një analize të ADN-së, që mirëmbahet dhe kalibrohet sipas standardeve ndërkombëtare. Agjencia e Kosovës Forenzike ka një bazë të dhënash për ADN me qasje ndërkombëtare, e cila mundëson hulumtimin dhe krahasimin elektronik të profileve të ADN-së.

Në dhjetor 2014, policia e Kosovës, autoritetet doganore, njësia e inteligjencës financiare dhe Këshilli prokurorial kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, në të cilin dakordohen për mënyrën e përmirësimit të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të të dhënave. Kosova ka nënshkruar marrëveshje me Shqipërinë për bashkëpunim ndër-kufitar dhe përndjekje të menjëhershme, derisa marrëveshje të ngjashme janë nënshkruar edhe me ish republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Korniza ligjore

Ende nuk ka pasur ndonjë vlerësim për përafrimin e Kodit Penal të Kosovës me standardet evropiane. Një kornizë ligjore e duhur për mbrojtjen e dëshmitarëve është e përgatitur në formën e ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe udhëzimeve administrative shoqëruese. Legjislacioni për konfiskimin e të ardhurave nga krimi është më së shumti i përafërt me *acquis*, mirëpo zbatimi i tij mbetet i dobët. Ligji për përgjimin e telekomunikimeve është miratuar në maj 2015, duke krijuar kështu masat e duhura hetimore për të ndihmuar identifikimin dhe përndjekjen e të dyshuarve të përfshirë në shkelje të rënda penale, lidhur me të drejtat përkatëse të njeriut. Në janar të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar ligjin që kriminalizon bashkimin në konflikte të armatosura jashtë Kosovës, në përputhje me Rezolutën përkatëse të OKB-së.

Korniza strategjike

Strategjitë dhe planet e veprimit të Kosovës për të luftuar krimin e organizuar janë përafruar shumë me praktikën më të mira të BE-së. Në vitin 2013 Kosova ka përgatitur një vlerësim strategjik për kërcënimin nga krimi i organizuar. Ky vlerësim nuk ndjek plotësisht metodologjinë SOCTA të Europol-it, mirëpo ofron bazën për vendimmarrje strategjike dhe për zbatimin e ligjit. Në vitin 2015 është dhënë trajnimi për metodologjinë SOCTA të Europol.

Deri më sot, Kosova ka implementuar rreth 80 % të planit të veprimit për të bashkërenditur strategjinë e saj kombëtare 2012-2017 kundër krimit të organizuar. Po ashtu ekzistojnë strategjitë e tjera kombëtare dhe planet e veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpëlarjes së parave, terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit, financimit të terroristëve, trafikimit me qenie njerëzore, krimeve kibernetike dhe trafikimit të narkotikëve.

Luftimi i terrorizmit

Kosova është prekur nga fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë dhe radikalizmit. Kosova ka shtuar përpjekjet e saj në luftimin e terrorizmit. Bashkë me ligjin për luftëtarët e huaj terroristë, ajo ka miratuar edhe një strategji dhe plan veprimi për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit që mund të shpijnë në terrorizëm. Fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë ka nevojë për një qasje të dedikuar nga inteligjenca dhe komuniteti për zbatimin e ligjit dhe për një politikë gjyqësore koherente kundër shkelësve.

2.4. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Korniza ligjore garanton gjerësisht mbrojtjen e të drejtave themelore dhe të njeriut, në përputhje me standardet evropiane. **Pak progres** është shënuar në këtë fushë, ku vlen të përmendet inkorporimi i standardeve ndërkombëtare në kornizën ligjore, edhe pse Kosova aktualisht nuk mund të lidhet zyrtarisht me instrumentet ose institucionet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Implementimi i të drejtave të njeriut pengohet nga mungesa e burimeve dhe angazhimit politik, përfshirë atë në nivel lokal. Miratimi i pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut ka fuqizuar strukturën institucionale dhe ka qartësuar rolet e institucioneve të ndryshme.

Mangësitë prekin fushat vijuese:

- Dhuna e bazuar në gjini dhe qasja e kufizuar e grave në pronë e pengon dukshëm gëzimin e plotë të të drejtave të tyre. Po ashtu, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara vazhdojnë të mos realizohen, për shkak të mungesë së mbështetjes institucionale, shërbimeve shëndetësore dhe mundësive të kufizuara në qasje.
- Rastet e sulmeve verbale dhe fizike kundër lezbikeve, homoseksualëve, biskualëve, transgjinerëve (LGBTI) hetohen rrallë. Kjo duhet të ndryshojë.
- Strategjia dhe legjislacioni për të drejtat e pjesëtarëve të minoriteteve dhe mbrojtja e tyre në mbarë Kosovën duhet të zbatohet me përpikëri.
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore, përfshirë bashkëpunimin në mes Kishës Ortodokse Serbe dhe autoriteteve të Kosovës mbetet një problematikë dhe legjislacioni që adreson ndërtimet ilegale duhet të zbatohen dhe të fuqizohen.

Kushtetuta e Kosovës siguron aplikimin në Kosovë të shumë **instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**, të cilat përbëjnë një pjesë përbërëse të kornizës së saj ligjore. Vazhdon të shënohet progres në përafrimin e legjislacionit me instrumentet e tilla dhe Kosova vazhdon praktikën e saj të raportimit ad hoc.

Lidhur me **promovimin dhe fuqizimin e të drejtave të njeriut**, pak përparim është bërë me miratimin e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut (ligji për Avokatin Popullit, për barazi gjinore dhe për mbrojtje nga diskriminimi). Kjo ka fuqizuar strukturën institucionale dhe ka qartësuar rolet institucioneve të ndryshme civile dhe publike (p.sh. Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Agjencisë për Barazi Gjinore). Zbatimi i duhur i këtyre ligjeve, përfshirë trajnimin dhe krijimin e një regjistri gjurmues të gjyqësorit për rastet e diskriminimit, është qenësor për promovimin efektiv dhe fuqizimin e të drejtave të njeriut në mbarë Kosovën. Strategjia për të drejtat e njeriut duhet të përditësohet. Çështjet e të drejtave të njeriut kanë nevojë për rritje të zotimit politik dhe financiar në të gjitha nivelet. Varësia e vazhdueshme e qeverisë tek donatorët në këtë sektor dëmton pronën dhe dhënien e rezultateve.

Sa i përket **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit**, gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është identifikuar asnjë shkelje e të drejtave të njeriut e njohur ndërkombëtarisht. Përmes amendamentimit të ligjit për Avokatin e Popullit, Kosova është përafruar me kërkesat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës, duke e forcuar rolin e Avokatit të Popullit si mekanizëm parandalues kombëtar, duke fuqizuar kështu kornizën e saj institucionale për të drejtat e njeriut të të arrestuarve.

Në **sistemin e burgjeve**, në përgjithësi ekziston një përputhshmëri me Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve, derisa përpjekje të mëtutjeshme nevojiten për të siguruar trajtimin e duhur të të burgosurve në izolim/vetmi dhe sa i përket përafrimit me këto standarde. Strehimi i të burgosurve që presin

gjykimin dhe i atyre që janë dënuar për kundërvajtje, bashkë me të burgosurit afatgjatë, mbeten shqetësuese. Qendra e Ndalimit në Mitrovicë, e cila duhet të strehojë vetëm të arrestuarit para gjykimit, ende strehon të burgosur të dënuar. Rekomandimet që rrjedhin prej inspektimeve në Shërbimin Korrektues të Kosovës nga ana e Inspektoratit të Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë nuk adresohen në mënyrë sistematike. Shqetësim i madh mbetet korrupsioni dhe mallrat e kontrabanduara në qendrat e arrestimit dhe në disa qendra korrekstuese, si dhe privilegjet që u jepen të arrestuarve të profilit të lartë. Qeveria duhet të adresojë këtë çështje urgjentisht. Nivelet e pamjaftueshme të personelit, në veçanti në burgun e sigurisë së lartë, mbeten shqetësuese. Po ashtu shqetësuese është edhe politizimi i emërimeve në shërbimin e burgut.

Zhvillimi i **mbrojtjes së të dhënave personale** është në fazë të hershme. Kosova ka një autoritet të pavarur për mbrojtjen e të dhënave – Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AShMDhP) – e cila kontribuon në zbatimin e standardeve të BE-së në këtë fushë. Megjithatë, është i nevojshëm fuqizimi i mëtejshëm i mundësive të saj, përfshirë këtu stafin e kualifikuar dhe burimet financiare. Korniza ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të dhënave dhe për qasje në informata publike duhet të krijohet dhe të rregullohet. Prej 38 komunave, 35 tani kanë zyra për mbrojtjen e të dhënave. ASHMDHP ka kryer një numër në rritje të inspektimeve dhe ka përsëritur inspektimet. Një rritje e konsiderueshme e numrit të ankesave nga anëtarë të publikut tregon rritjen e vetëdijesimit.

Ekzistojnë dispozitat ligjore në fushën e **lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë**. Shkolla për prift ortodoks në Prizren ka rritur numrin e vijuesve dhe vazhdon të funksionojë mirë. Duhet të gjenden modalitete për sigurimin e mbështetjes për rindërtimin e Kishës Ortodokse Serbe, e cila ka mbetur e papërfunduar nga Komisioni për Rindërtim dhe Implementim. Ndërveprimi mes liderëve fetarë të të gjitha besimeve është bërë më i rregullt. Pas vendimit të fundit të Panelit të Apelit të Dhomës Speciale të Gjykatës Supreme nevojitet intensifikimi dhe rivendosja e përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje për konfliktin e vjetër për tokë në mes të Komunës së Deçanit dhe Manastirit të Deçanit, për të zvogëluar tensionet e vazhdueshme në mes të manastirit, komunës dhe komunitetit lokal. Nuk ka pasur raporte për ndonjë incident të rëndë që lidhet me mbrojtjen e vendeve historike dhe fetare që janë nën përgjegjësi të policisë së Kosovës. Incidentet e vazhdueshme si vjedhja e parave dhe vandalizmit në objektet e trashëgimisë fetare duhet të përcillen në mënyrë efektive. Autoritetet e kanë si rregull që të reagojnë si duhet ndaj incidenteve të tilla, edhe pse një deklaratë pas një incidenti mbishkrimi në Manastirin e Deçanit u shndërrua në tensione ndërmjet komuniteteve.

Liria e shprehjes

Kosova ka **nivel të ulët të realizimit të** të drejtës për liri të shprehjes; gjatë vitit të kaluar, **nuk është parë progres** në këtë fushë. Nuk ka pasur zhvillime legjislative për rregullimin e pronësisë mediale dhe transparencës. Nuk është gjetur asnjë zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë atë të ndjeshëm ndaj presionit dhe ndikimit politik. Implementimi mbetet një sfidë e madhe. Mjedisi i përgjithshëm nuk është në favor të ushtrimit të plotë të lirisë së shprehjes. Vitin e ardhshëm, gjatë adresimit të mangësive të përmendura në vijim, Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje veçanërisht:

- të sigurojë që rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe format e tjera të presionit hetohet plotësisht;
- të sigurojë një zgjidhje financiare të qëndrueshme për transmetuesin publik dhe të ofrojë informacione transparente për pronësinë mediale.

Kërcënimi i gazetarëve

Tri sulme të rënda fizike janë bërë ndaj gazetarëve gjatë kësaj periudhe raportuese. Gjithsej 26 raste sulmesh, kërcënimesh dhe pengimesh të gazetarëve janë nën hetim. Në njërin rast, redaktori i një gazete dhe kryetari i Shoqatës së Gazetarëve u sulmua fizikisht nga pronari i gazetës pasi ai zbuloi mospagesën e pagave të personelit të gazetës. Në një rast tjetër, një bombë u hodh në ambientet e një portali serb, në Mitrovicë Veriore. Një reagim më sistematik, duke përfshirë edhe denoncimin publik, hetimin e menjëhershëm dhe gjykimin me kohë, do të fuqizonte mbrojtjen e gazetarëve. Hetimet janë të ngadalshme dhe marrja e dënimeve të formës së prerë është e ulët, pa asnjë dënim në vitin 2014.

Mjedisi legjislativ

Derisa liria e mediave dhe e shprehjes janë të garantuara me kushtetutë dhe me legjislacionin për shpifje, fjalë urrejtjeje janë në përputhje me ligjin e rasteve për Gjykatën Evropianë të Drejtave të Njeriut, implementimi efektiv mbetet një sfidë. Korniza legjislative dhe institucionale në këtë fushë mbetet e ndarë dhe joefektive. E drejta e gazetarëve për kundërshtim të ndërgjegjshëm dhe e drejta e publikut për të reaguar dhe korrigjimi mbeten të parregulluara.

Implementimi i legjislacionit/institucioneve

Janë emëruar dy anëtarë të komuniteteve jo shumicë, duke kompletuar kështu Bordin e Komisionit të Pavarur për Media (KPM). KPM ende nuk i mori vendimet me kohë, gjë që dëmtoi caqet e tij për vitin 2014, përfshirë këtu përgatitjen me kohë të procesit në kalim digjital. KPM duhet të përfundojë legjislacionin sekondar, në përputhshmëri me Direktivat e BE-së dhe në mënyrë më sistematike të monitorojë përmbajtjen e mediave audio-vizuale. Si pasojë e shkurtimeve qeveritare në këtë bord, KPM po ballafaqohet me vështirësi në përmbushjen e obligimeve të tyre financiare, përfshirë edhe investimin kapital.

Liria e shprehjes në internet nuk monitorohet as nga KPM e as nga Këshilli i Shtypit. Edhe pse kjo krijon një mjedis ideal për mediat online, ajo edhe pengon privatësinë e individëve, që shpie në shumë raste të fjalorit të urrejtjeje dhe shpifjeve.

Transmetuesi i shërbimit publik

Transmetuesi i shërbimit publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), financohet publikisht drejtpërdrejt. Afati i fundit për miratimin e legjislacionit, prilli 2015, për zgjidhjen e çështjes së financimit nuk është përmbushur. Në vjeshtën e vitit 2014, janë organizuar disa protesta nga sindikata e transmetuesit publik, e cila ka akuzuar RTK-në për keqmenaxhim, nepotizëm dhe korrupsion. Në prill, Kuvendi thirri Auditorin e Përgjithshëm për të kryer një auditim financiar dhe të performancës në detaje për transmetuesin publik. Në korrik, Kuvendi emëroi katër prej pesë anëtarëve të Bordit të RTK-së, midis shqetësimeve që ata nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara profesionale.

Faktorët ekonomikë

Nuk është siguruar qëndrueshmëria ekonomike e mediave. Mbeten të paqarta strukturat e pronësisë së mediave, në veçanti për mediat e shtypit dhe ato online. Mungesa e një industrie të fuqishme të reklamimit privat bën që transmetuesit privatë të varen nga donatorët ndërkombëtarë dhe shumë pak prej tyre janë në gjendje të funksionojnë pa mbështetjen e partive politike. Shumë media në gjuhën serbe rrezikohen të mbyllën për shkak se tregu i tyre i reklamimit është shumë i vogël për të qenë të qëndrueshme ekonomikisht.

Organizatat profesionale / kushtet profesionale

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, që përfaqëson shumicën e gazetarëve, ka qenë shumë aktiv në luftimin e presioneve dhe në avokim për të drejtat e tyre. Gazetarët priren të kenë paga të ulëta dhe shpesh punojnë pa kontrata, të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe të prirur për vetë-censurim. Pavarësia e gazetarëve dhe redaktorëve dhe mbrojtja e standardeve profesionale në gazetari mbeten të parregulluara. Kodet e sjelljes redaktuese në media individuale do të ishin të dobishme.

Liria e mbledhjes dhe asociimit garantohet me Kushtetutë dhe qytetarët e kanë ushtruar këtë të drejtë lirshëm, përfshirë edhe protestat kundër niveleve të ndryshme të qeverisë.

Nuk ka pasur përparim në **të drejtat e pronës**. Pozita e Koordinatorit për të Drejta të Pronës në Qeveri ka qenë e lirë që nga janari 2015. Është duke u zhvilluar një strategji për të drejtat e pronës, me miratimin e së cilës mund ta evitojë nevojën për një koordinator. Zbatimi i Ligjit për Trajtimin e ndërtimeve pa leje ballafaqohet me një numër problemesh, me anë të të cilit dokumentet që kërkohen ligj nuk kërkojnë dëshminë e pronësisë për ngastrën e tokës gjatë dorëzimit të një aplikacioni për legjislacion e as Ministria përkatëse nuk është e detyruar të kontrollojë shënimet e regjistrit të tokave në procesin e legalizimit. Banorët (në veçanti komunitetet minoritare dhe personat e zhvendosur) nuk kanë qenë të informuar me kohë për procesin e legalizimit. Shqetësim mbetet trajtimi i ndërtimeve pa leje që u përkasin personave të zhvendosur, të cilët nuk kanë mundur të aplikojnë, meqë pronat e tilla do të përfshihen në listën e shkatërrimit.

Vendimet nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) për aplikimet për të shkatërruar ndërtimet pa leje në pronën private nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së burimeve financiare, gjë që ndikon rëndë në të drejtat e personave të zhvendosur brenda vendit. Ka pasur përmirësime në përputhshmërinë me obligimet ligjore gjatë shpronësimeve. Megjithatë, përputhshmëria gjuhësore dhe njoftimi i grupeve të cënueshme në procesin e shpronësimit mbeten një shqetësim.

Kosova duhet të zgjidhë të gjitha kërkesat për pronë që kanë mosmarrëveshje. Ligji për Agjencinë për Krahësimin dhe Verifikimin e Pronës është ende në pritje. Komisioni për Ankese Pronësore i AKP ka marrë vendim në të gjitha rastet, megjithatë në disa prej tyre ka mospërputhshmëri teknike. AKP vazhdon të qartësojë pronat ilegale në jug të Lumit Ibër.

Strategjia për të rregulluar vendbanimet joformale është ende pezull. Përparim relativisht i vogël është parë në adresimin e çështjeve të strehimit social. Sigurimi i strehimit social pengohet nga mosaprovimi i strategjisë trevjeçare për mbarë Kosovën nga ana e institucioneve në nivel qendror.

Sa i përket **mosdiskriminimit**, miratimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në maj 2015, është një hap i madh përpara. Avokati i Popullit tani ka një mandat për të vepruar si një organ për barazi. Krimet e urrejtjes janë hequr nga Neni 147 i Kodit Penal. Performansa e institucioneve të Kosovës në përpunimin dhe hetimin e rasteve të fjalorit urrejtës, që kryesisht i drejtohen anëtarëve të komunitetit LGBTI dhe minoriteteve etnike mbetet e dobët. Mekanizmi i gjurmimit i Këshillit Prokurorial të Kosovës duhet të zgjerohet për të mbuluar rastet e të gjitha llojeve të diskriminimit, jo vetëm të atyre të bazuara në përkatësi etnike.

Korniza ligjore e Kosovës për **barazi në mes të femrave dhe meshkujve** është përmirësuar përmes miratimit të Ligjit për Barazi Gjinore në muajin maj, i cili është në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, mbeten sfida të konsiderueshme strukturore dhe zbatimi kërkon përpjekje serioze. Ndikimi i implementimit mbikëqyrës të sekretariatit ndër-institucional për planin e veprimit për Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 deri tani ka qenë i kufizuar. Roli i Agjencisë për Barazi Gjinore në politikëbërje duhet të zgjerohet. Femrat mbesin të nën-përfaqësuar në pozita vendimmarrëse, përfshirë këtu edhe nivelin komunal. Në nivel kombëtar, situata është përkeqësuar, meqë prej 22 ministrive vetëm dy ministri udhëhiqen nga femrat dhe prej 14 drejtuesve të komisioneve parlamentare, vetëm dy janë po ashtu femra.

Çdo stacion policor ka një njësi përgjegjëse për dhunën me bazë gjinore, përkundër emërimit së fundi të një koordinatori kombëtar për dhunë në familje, nuk është shënuar progres në luftimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Mungesa e një sistemi të grumbullimit të rregullt të të dhënave nëpër institucione dëmton mundësinë për të monitoruar dhe gjurmuar rastet në procedurë hetimore dhe gjyqësore. Kosova duhet të vlerësojë implementimin e strategjisë 2011–2014 dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje para se të hartojë një të re. Linja telefonike për ndihmë kundër trafikimit dhe dhunës në familje duhet t'u ofrojë ndihmë viktimave jo-shqipfolës, përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve të ngjashme për banorët e komunave veriore. Mandati i Këshillit Kombëtar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës është zgjatur, në mënyrë që të adresojë nevojën për mbështetje gjithëpërfshirëse për viktimat që kanë mbijetuar. Zbatimi efektiv i të drejtave të grave për trashëgimi mbetet i kufizuar, përkundër pranisë së dispozitave ligjore që adresojnë këtë çështje. Zyrtarët kadastralë dhe ata për regjistrim nevojitet të bëjnë përpjekje të mëtejshme për regjistrimin e të gjithë bashkë-pronarëve të pronave, përfshirë gratë, në mënyrë që të fuqizohet mbrojtja e të drejtave të tyre.

Lidhur me **të drejtat e fëmijës**, korniza ligjore është e përgatitur, mirëpo zbatimi i saj është i dobët si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Duhet të bëhet një vlerësim i zbatimit të strategjisë 2009-2013 dhe planit të veprimit për të drejtat e fëmijëve dhe rezultatet pastaj të merren në konsiderim gjatë zhvillimit të një strategjie të re. Zhvillimi i suksesshëm i politikave varet nga dispozicioni i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës. Një ligj për mbrojtjen e fëmijëve do të shmangte dyfishimin e legjislacionit ekzistues për të drejtat e fëmijëve. Koordinatorët Komunalë për të Drejtat e Fëmijës kanë nevojë për ngritje kapacitetesh dhe për buxhet të mjaftueshëm. Rritja e vetëdijesimit dhe trajnimi për të drejtat e fëmijës duhet të vazhdojnë dhe Zyra e Avokatit të Popullit duhet t'i shtojë aktivitetet në këtë fushë. Ndëshkimi fizik apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit poshtërues në institucionet arsimore dhe trajnuese janë të ndaluara me ligj, mirëpo jo edhe në ambientet e tjera si në hapësirat publike ose në familje. Rritja e vetëdijesimit në mesin e gjykatësve dhe prokurorëve ka çuar në një zvogëlim sistematik të periudhave të arrestmbajtjes së të rinjve para gjykimit. Megjithatë, korniza ligjore ka nevojë të rishikohet në mënyrë që të përmbajë rekomandimet e Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës për zvogëlimin e arrestmbajtjes para gjykimit në gjashtë muaj.

Lidhur me **integrimin e personave me aftësi të kufizuara**, Kosova duhet të përmirësojë zbatimin e strategjisë 2013-2023 për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe planin e saj të veprimit 2013-2015. Shërbimet shëndetësore dhe mbështetja për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara mbeten të pamjaftueshme dhe qasja fizike në institucione publike mbetet një sfidë. Largimi i padëshmuar i më shumë se 1 000 anëtarëve të komunitetit të shurdhër nga skema pensionale për personat me aftësi të kufizuara është një shqetësim. Duhet të sigurohet që fëmijët me nevoja të veçanta të kenë në dispozicion asistentë personalë. Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara deri më tash nuk ka mundur të promovojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe ka nevojë për mbështetje më të fuqishme nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Qeverisë, për t'ia mundësuar atij ushtrimin e rolit të tij bashkërendues në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Për të drejtat e **lezbikeve, homoseksualëve, transgjinorëve dhe transseksualëve (LGBTI)**, pakoja me ligjet për të drejtave të njeriut ka adresuar boshllëqet në legjislacionin për mbrojtjen e orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor. Rastet e sulmeve verbale dhe fizike ndaj komunitetit LGBTI janë adresuar rrallë ashtu si duhet nga ana e autoriteteve. Përkundër takimeve të rregullta, grupi këshillimor dhe bashkërendues për të drejtat e komunitetit LGBTI ende mbetet të tregojë rezultatet konkrete. Qeveria ka nisur trajnimin për ngritjen e vetëdijesimit për shërbyesit civilë, zyrtarët e zbatimit të ligjit, gjyqësorin, mediat dhe mësimdhënësit. Më 17 maj në Prishtinë u organizua një marsh, me rastin e ditës ndërkombëtare kundër homofobisë, e cila nuk pati incidente. Megjithatë, liderët politikë të Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të rritur vetëdijesimin dhe për të promovuar tolerancën.

Sa i përket **të drejtave për punë dhe sindikatë**, Marrëveshja Kolektive e Përgjithshme që është

nënshkruar në mars 2014, ende nuk është zbatuar për shkak të mungesës së buxhetit. Kjo ka nxitur një valë protestash në sektorë të ndryshëm. Zbatimi i ligjit për greva mbetet i pakënaqshëm, në sajë të mungesës së komunikimit në mes të organizuesve të grevave dhe autoriteteve. Përfaqësimi i punëtorëve në kuadër të Këshillit Ekonomik dhe Social ende po sfidohet nga shumica e sindikatave dhe amendamentet në ligjin për Këshillin Ekonomik dhe Social duhet të qartësojnë kriteret dhe procedurat. (*Shih gjithashtu 4.1.8 — Punësimi dhe politikat sociale, politika e shëndetit publik*)

Lidhur me **të drejtat procedurale**, personat e dyshuar, të akuzuar dhe viktimat e krimit në Kosovë gëzojnë mbrojtje të mirë me legjislacion (Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Policinë, Ligji për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit si dhe Ligji për Ndihmë Ligjore Falas). Ata kanë të drejtë për interpretim dhe përkthim, të drejtë për t'u informuar mbi të drejtat, të drejtë për këshilla ligjore para dhe gjatë gjykimit dhe të drejtë për ndihmë ligjore, personat e arrestuar kanë të drejtë të komunikojnë me anëtarët e familjes, me punëdhënësit dhe autoritetet konsullore. Ka vullnet të fortë politik për zbatimin e drejtë të këtyre rregullave, mirëpo nevojiten më shumë trajnime për të siguruar të drejtat procedurale ë qytetarëve të Kosovës në praktikë.

Korniza ligjore e Kosovës për ruajtjen dhe mbrojtjen e **minoriteteve** është gjithëpërfshirëse, edhe pse zbatimi i saj mbetet një sfidë. Bllokada politike e shkaktuar pas shkarkimit të ministrit për Komunitete dhe Kthim, në fillim të muajit shkurt 2015, ka ndikuar në funksionimin e kësaj ministrie. Ministri i ri, i emëruar në prill, ka premtuar identifikimin dhe gjetjen e një zgjidhjeje afatgjate për çështjen e personave të zhvendosur nga Kosova, sidomos përmes një Komisioni Ndër-ministrior për Kthim. Është themeluar Grupi Punues Teknik për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, mirëpo ai është takuar vetëm një herë, në qershor 2015. Zyra për Çështje të Komuniteteve duhet të marrë një rol më të fuqishëm në politikën e minoriteteve, përfshirë edhe çështjet me të cilat është marrë grupi punues teknik dhe me politikën pas vitit 2015 për romë, ashkali dhe egjiptas. Këshilli Këshillues për Komunitete është takuar rregullisht dhe ka themeluar pesë grupe punuese në bazë të sektorëve, mirëpo ai ka nevojë që urgjentisht të rrisë financimin dhe mbështetjen në mënyrë që të funksionojë në mënyrë efektive dhe rekomandimet e tij të merren parasysh.

Kosova duhet të vazhdojë të përmirësojë punësimin e komuniteteve jo shumicë brenda shërbimit civil të Kosovës dhe ndërmarrjeve publike. Duhet të gjendet një zgjidhje e përhershme në çështjen e pranimit të diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës, në mënyrë që t'u mundësojë anëtarëve të komuniteteve jo shumicë që të integrohen më mirë, përfshirë edhe punësimin në institucionet qeveritare. Sfidat të konsiderueshme mbesin në qasjen në shërbime në gjuhët zyrtare, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel komunal, përfshirë edhe gjuhët që përdoren nga komunitetet minoritare. Zyra e Komisionerit për Gjuhët ka vazhduar të kryejë detyrat e saj me rezultat të kënaqshëm përkundër burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore, ku përfshihet edhe bashkëpunimi me institucionet e tjera. Kjo zyrë mbetet ende e përkushtuar të krijojë marrëdhënie me katër komunitetet veriore. Incidentet në një lojë futbollit në me Serbisë dhe Shqipërisë, në tetor 2014, çuan në një rritje të fortë, po që nuk zgjati shpejt, të incidenteve ndër-etnike. Derisa situata e përgjithshme e sigurisë për komunitetet jo shumicë mbetet relativisht stabile, është parë një trend në rritje të incidenteve, ku cak ishte komuniteti serb i Kosovës që banon në Kosovën perëndimore, me vjedhje të shpeshta të shtëpive të tyre, të cilat shkaktuan një ndjenjë të lartë të pasigurisë brenda komunitetit të prekur. Autoritetet policore dhe gjyqësore të Kosovës duhet të kuptojnë më mirë se çfarë nënkupton një incident ndër-etnik i motivuar. Nevojitet ende përpjekje për të stabilizuar dhe normalizuar më tej marrëdhëniet ndër-etnike. Incidentet dhe krimet që kanë si cak anëtarët e komuniteteve dhe pronat e tyre duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht me përpikëri dhe shpejtësi.

Sa i përket komuniteteve **romë, ashkali dhe egjiptas**, strategjia 2009-2015 dhe plani i veprimit për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas ka vazhduar të implementohet. Qeveria duhet të tregojë në praktikë angazhim për të vazhduar me zhvillimin dhe përpilimin e politikave

të besueshme, reale dhe të matshme të pas vitit 2015. Të gjitha palët përkatëse të interesit, përfshirë shoqërinë civile dhe deputetët e parlamentit që përfaqësojnë këto tri komunitete, duhet të përfshihen dhe rekomandimet duhet të inkorporohen. 12 komunat kanë aprovuar planet lokale të veprimit për integrimin e të tri komuniteteve. Qendrat mësimore kanë luajtur një rol pozitiv në zvogëlimin e shkallës së braktisjes së shkollës. Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas kanë të njëjtën qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor sikurse qytetarët e tjerë dhe Ministria për Komunitete dhe kthim ka ndarë buxhetin për strehim. Anëtarët e këtyre komuniteteve vazhdojnë të ballafaqohen me kushte të vështira të jetesës, me përjashtim social dhe diskriminim të shpeshtë, derisa vazhdojnë të mbizotërojnë puna e të miturave dhe martesat e hershme. Qasja në tregun e punës është e vështirë dhe punësimi joformal mbizotëron. Duhet të ndiqen masat aktive për përfshirjen e këtyre komuniteteve në tregun e punës. Është shënuar progres lidhur me procesin e regjistrimit të mbi 600 romëve, ashkalive dhe egjiptasve të zhvendosur, që aktualisht janë në Mal të Zi. Në mungesë të dokumenteve të identifikimit, Kosova duhet të sigurojë ende të dhëna të besueshme për komunitetet e saj romë, ashkali dhe egjiptas.

Autoritetet në nivel lokal dhe qendror nuk kanë bërë punë të mjaftueshme për lehtësimin e kthimit dhe riintegrimin e **refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit** (PZHBV). Zotërimi ilegal i pronës banesore, bujqësore dhe komerciale vazhdon të ndikojë në të drejtat e pronës së PZHBV dhe kësioj pengon kthimin. Komunat ende nuk po e matin iniciativën për të mbledhur dhe për të mbajtur të dhënat për numrin dhe vendndodhjen e PZHBV dhe refugjatëve. Urgjentisht nevojitet një angazhim më i madh në nivel lokal. Shifrat nga periudha raportuese tregojnë numrin më të ulët të të kthyerve vullnetarë (rreth 800) që nga viti 2000. Mungesa e angazhimit dhe financimit nga ana e qeverisë, bashkë me perspektivën e dobët ekonomike, ka krijuar një mjedis më pak të favorshëm për të kthyerit.

Për **të drejtat kulturore**, bashkëpunimi në mes të autoriteteve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe në kuadër të Këshillit për Zbatim dhe Mbikëqyrje (KZM) vazhdon, edhe pse takimet kanë qenë më pak të rregullta dhe Ministria e Kulturës është më pak e përfshirë. Në interes të qëndrueshmërisë, qeveria duhet të planifikojë dhe të caktojë fonde të nevojshme për funksionimin e sekretariatit të KZM-së. Njësia për Trashëgimi Kulturor dhe fetare e policisë së Kosovës e përmbush mandatin e saj në katër rajone për të mbrojtur vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe me 205 zyrtarë. Sfidat e vazhdueshme përfshijnë përmirësimin e komunikimit me klerikët ortodoksë vendës dhe sigurimin e pajimeve të mjaftueshme.

Është krijuar Këshilli i Fshatit të Hoçës së Madhe, për të cilin është caktuar edhe buxheti, duke shënuar kështu një hap të parë në zbatimin e ligjit. Me kapacitet të kufizuar komunal, vazhdon të nevojitet mbikëqyrja e nivelit qendror, në mënyrë që të sigurojë zbatimin e plotë të këtyre ligjeve. Është bërë përparim në zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, ku për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore janë siguruar pajisjet dhe objektet, edhe pse fondet kanë mbetur të caktohen. Incidentet e shkatërrimit ilegal të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar. Task forca e themeluar për ndërtimin ilegal në Prizren është riaktivizuar, mirëpo deri më sot nuk ka dhënë asnjë rezultat konkret. Nevojiten më shumë përpjekje për hetimin e shkeljeve dhe sanksionimin e kryerësve të veprave. Duhet rezultate konkrete në kundërshtimin e ndërtimit ilegal, shkatërrimit dhe zhvillimit jo të favorshëm për të demonstruar zotimin e qeverisë për mbrojtjen e trashëgimisë.

Një shqetësim i veçantë ka qenë përpjekja, përmes paraqitjes së projektligjit për trashëgiminë kulturore, për të dëmtuar legjislacionin që rrjedh nga Propozimi për Rregullim Gjithëpërfshirës (PRrGj), i cili përcakton të drejtat dhe privilegjet e veçanta për Kishën Ortodokse Serbe (KOS). Ky projektligj është tërhequr shpejt, mirëpo pritet që të paraqitet sërish shumë shpejt. Kosova duhet të tregojë zotimin e saj për të respektuar dispozitat që rrjedhin nga PRRGJ dhe të ofrojë siguri se nuk do të sfidohen të drejtat, privilegjet dhe identiteti i KOS-it.

2.5. Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

Në gusht të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës ka miratuar amendamentet kushtetuese dhe ka kaluar legjislacionin e nevojshëm për krijimin e kushteve për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit Specializuar për të hetuar dyshimet për **krime të rënda ndër-kufitare dhe ndërkombëtare** të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, që ndërlidhen me ato që janë raportuar në raportin e Kuvendit Parlamentar të Këshillit të Evropës. Këto Dhoma do t'i nënshtrohen ligjit të Kosovës, mirëpo do të vendosen jashtë territorit të Kosovës. Autoritetet e Kosovës tani duhet të punojnë në kompletimin e kornizës rregullative.

Kosova ka themeluar një departament të krimeve në kuadër të Zyrës së saj të Prokurorit të Special. Megjithatë, ky departament nuk ka prokurorë të mjaftueshëm për të kryer detyrat e saj aktuale, të cilat do të rriteshin atëherë kur di të dorëzohen edhe hetimet dhe rastet e EULEX-it. Njësia për hetimin e krimeve të luftës në kuadër të policisë së Kosovës ka tani personel shtesë. Megjithatë, mungesa e hetuesve me përkatësi etnike serbe, personeli i kufizuar për analiza të inteligjencës penale, mungesa e kapacitetit të gjuhës dhe përkthimit dhe mungesa e pajisjeve bazike, si e automjeteve dhe kompjuterëve, nënkupton se kjo njësi nuk mund të funksionojë si duhet. EULEX-i po mbështet Kosovën në ndërtimin e kapaciteteve për të marrë përsipër në mënyrë efektive hetimet dhe përndjekjet e krimeve të luftës. Në shumicën e rasteve të krimeve të luftës që janë në pritje, të dyshuarit janë serbët etnikë që banojnë kryesisht në Serbi. Duke ditur klimën politike, kjo njësi lokale nuk do të jetë në gjendje të merret me këto raste e pavarur. Në pjesën tjetër të rasteve (166) të dyshuarit janë shqiptarë etnikë dhe zakonisht ish anëtarë të UÇK-së. Ka shqetësime për kapacitetin dhe gatishmërinë për hetimin e këtyre rasteve.

Fati i pazgjidhur i **personave të zhdukur** nga konflikti i viteve 1990 mbetet një shqetësim humanitar. Që nga gushti 2015, gjithsej 10 814 persona kanë mbetur ende të zhdukur sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Prej këtij numri, 1 670 raste janë të ndërlidhura me konfliktin në Kosovë. Përcaktimi i fatit të personave të zhdukur mbetet jetësore për pajtimin dhe stabilitetin rajonal. Grupi punues ndër-ministror për t'u marrë me të kaluarën, që ka pasur për detyrë të përgatisë strategjinë për këtë çështje, duhet të jetë më aktiv dhe të japë rezultatet konkrete, me theks të veçantë mbi grupet e viktimave dhe drejtësinë tranzicionale. Komisioni qeveritar për personat e zhdukur ka emëruar pikat kryesore komunale. Dialogu i Prishtinës me Beogradin, përmes grupin punues për personat e zhdukur, i kryesuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, nuk ka shënuar përparim të madh. Delegacioni i Prishtinës në këtë grupin punues nuk është i plotësuar dhe duhet të emërohet një udhëheqës i ri. Kosova duhet të angazhohet në mënyrë më proaktive dhe të ofrojë informata nga burimet e saj. Nevojitet mbështetje politike e nivelit të lartë për të adresuar këtë çështje të fatit dhe vendondodhjes së personave të zhdukur. Pas përfundimit të procesit zhvarrosjes në varrezat në Rudnicë, (Serbi), janë identifikuar eshtra të njerëzve dhe ato janë transferuar në Kosovë.

Departamenti për Mjekësi Ligjore i Kosovës (DML) përkundër një përparimi të treguar, nuk ka kapacitet për të përmbushur standardet kërkuara për praktikën mjeko-ligjore të qëndrueshme, përfshirë këtu antropologjinë dhe toksikologjinë. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi në mes të komisionit qeveritar për personat e zhdukur dhe DML duhet të përmirësohet. Duhet të fuqizohet kapaciteti dhe të integrohet personeli nga komunitetet shqiptare jo-etnike.

Ky Komision dhe DML duhet të gjejnë një zgjidhje të qëndrueshme dhe të caktojë burimet për të vazhduar futjen e të dhënave në bazën e të dhënave të para vdekjes/pas vdekjes. Mungesa e progresit në këtë çështje pengon qeverinë që të marrë përgjegjësinë e saj për krijimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e listës së personave të zhdukur, në përputhshmëri me ligjin për personat e zhdukur. Nuk është shënuar fare progres lidhur me eshtrat e paidentifikuara të personave që ndodhen në morgun e Prishtinës, për ç'gjë është përdorur veprimi i mjekësisë ligjore.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira të fqinjësisë përbëjnë një pjesë qenësore të procesit të lëvizjes së Kosovës drejt BE-së. Kosova merr pjesë në disa organizata rajonale, pas

organizimeve për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal për të cilat është pajtuar me Beogradin në shkurt 2012. Megjithatë, përkundër përpjekjeve të qeverisë, Kosova ende nuk është e përfaqësuar në të gjitha organizatat rajonale, për shembull në Qendrën Evropian Jug-Lindore për Sundimin e Ligjit.

Një shtysë e re i është dhënë bashkëpunimit rajonal përmes “**procesit të Berlinit**” dhe iniciativës së gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke intensifikuar bashkëpunimin në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, veçanërisht në lidhje me **agjendën e lidhjes**. Në muajin prill, gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë arritur një marrëveshje për rrjetin kryesor të transportit dhe në qershor 2015 një marrëveshje për shtrirje në tri korridoret kryesore të rrjeteve të transportit ndër-evropian për në Ballkanin Perëndimor. Ata gjithashtu kanë identifikuar projektet prioritare nëpër seksionet e këtyre korridoreve që do të implementohen deri në vitin 2020. Për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të arritur rezultatet afatshkurtra, vendet janë pajtuar që të zbatojnë një numër masash “të buta” para samitit të radhës në Paris, si përfarimi dhe thjeshtimi i procedurave të kalimit kufitar, sigurisë së rrugës dhe skemave të mirëmbajtjes.

Kosova ka përmirësuar më tej marrëdhëniet e saj me **Shqipërinë**. Një marrëveshje për bashkëpunim të dyanshëm është nënshkruar gjatë vizitës së Kryeministrit Mustafa në Titanë në mars të vitit 2015. Kjo marrëveshje përfshin një numër të madh protokollesh dhe memorandumesh për bashkëpunim rajonal dhe ndërkufitar në sektorë të ndryshëm.

Nuk ka marrëdhënie zyrtare me **Bosnjën dhe Hercegovinën** meqë kjo e fundit nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Për këtë edhe ekziston regjim i dyanshëm i vizave.

Marrëdhëniet me **ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë** kanë mbetur konstruktive. Një memorandum bashkëpunimi në mes të prokurorëve publikë të të dyja vendeve në luftimin e krimit ndërkufitar dhe terrorizmit u nënshkrua në fund të dhjetorit. Në muajin janar, janë nënshkruar në Shkup një marrëveshje për inkurajimin dhe mbrojtjen reciproke të investimeve dhe një protokoll për bashkëpunim në fushën e edukimit diplomatik. Pas supozimeve për përfshirjen e qytetarëve të Kosovës në sulmin mbi stacionin e policisë kufitare në Goshince (21 prill) dhe në incidentet në Kumanovë (9-10 maj), qeveria e Kosovës ka dënuar dhunën dhe ka vënë thirrje për respektimin e integritetit territorial. Qeveria po ashtu ka bërë thirrje për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Një komision i përbashkët për demarkacionin e kufirit me **Malin e Zi** përfundoi punën e tij në qershor 2015 dhe ministrat nënshkruan marrëveshjen e kufirit gjatë Samitit të balanit Perëndimor në gusht (Vjenë), e cila marrëveshje pret miratimin parlamentar nga të dyja vendet. Nuk ka pasur zhvillime lidhur me njohjen kushtetuese të minoritetin malazez në Kosovë.

Kosova ka mbajtur marrëdhënie shumë të afërta me **Turqinë**. Janë duke u zhvilluar negociatat për një marrëveshje ripranimi me qëllim të realizimit të saj deri në fund të vitit.

NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

Kosova dhe Serbia kanë mbetur të angazhuara në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialog, në veçanti të “Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve” e prillit 2013. Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar në nivel teknik puna në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Dialogu i nivelit të lartë ka rifilluar në shkurt 2015, dhe katër takime në të cilat kanë marrë pjesë Kryeministrat Mustafa dhe Vučić janë mbajtur në prill, qershor dhe gusht.

Marrëveshjet kryesore janë finalizuar më 25 gusht 2015. Është arritur pajtim mbi parimet e përgjithshme/elementet kryesore për **themelimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe në Kosovë** përmes miratimit të Statutit të saj. Ky tekst përcakton kornizën ligjore të Asociacionit/Komunitetit, objektivave të tij, strukturës organizative, marrëdhënieve me autoritetet qendrore, kapacitetit ligjor, buxhetit dhe mbështetjes financiare. Ky status po ashtu

siguron modalitetet/hapat e ardhshëm për themelimin e tij. Në fushën e **energjisë**, në Kosovë janë krijuar dy kompani të reja serbe të energjisë (njëra merret me importim, eksportim dhe bartje; tjetra me furnizim dhe shërbime distribucioni). Këto kompani po vazhdojnë me organizimin e tyre të brendshëm para se të jenë në gjendje të aplikojnë për licenca. Është aprovuar edhe një plan veprimi që detajon hapat zbatues të marrëveshjes së **telekomit**. Kosova dhe Serbia janë pajtuar që të kërkojnë nga Bashkimi Evropian që të revitalizojë **urën e Mitrovicës** dhe rrethinën e saj, në mënyrë që të mund të rihapet për gjithë trafikun deri në verë/jo më vonë se në qershor 2016. Në përputhje me të njëjtin plan, është pajtuar gjithashtu që komuna e Mitrovicës Veriore të revitalizojë rrugën e tyre kryesore (Rruga Kral Petar) duke e shndërruar atë në një zonë për këmbësorë.

Është shënuar progres edhe në fusha të tjera të rëndësishme. Pas një marrëveshjeje në shkurt 2015, zhveshja e strukturave serbe të drejtësisë ka pasur sukses. Serbia ka lehtësua aplikimet e gjykatësve dhe prokurorëve serbë të Kosovës për në gjyqësorin e Kosovës. Trajtimi i duhur i rasteve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ku deklaratat e zyrtarëve serbë nganjëherë kanë ndërhyrë në procese, kërkon një mjedis pa paragjykim. Integrimi në polici i serbëve që kanë qenë pjesëtare të Mbrojtjes civile është afër përfundimit. Është duke u zbatuar një marrëveshje për **sigurimin e automjeteve**, e qershorit 2015, e cila kujdeset për njohjen e juridiksionit të sigurimit përkatës të automjeteve të njëra tjetrës. Për *doganat*, marrëveshje janë arritur për importimin e mallrave të kontrolluara në Kosovë, përfshirë edhe barnat. Në kontekst të **organizimeve të ndërlidhjes**, dhe pas marrëveshjes së arritur në nëntor 2014, të gjitha vizitat zyrtare janë organizuar drejtpërdrejt nga Zyrtarët Ndërlidhës. Është shënuar progres edhe në fushën e **kadastrit**: në Beograd është hapur një ndërtesë e re e arkivës, ku skanimit i dokumenteve që i takojnë Kosovës do të përfundojë deri në qershor 2016. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese Serbe që ka gjykuar formën në të cilën janë zhvendosur disa marrëveshje të dialogut, ishte jokushtetuese. Serbia ka përshtatur kornizën e saj rregullative lidhur me këto marrëveshje, me përjashtim të lirisë së lëvizjes, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për marrëveshjet për energji dhe telekom është ende duke u pritur. Serbia duhet të gjejë zgjidhje ligjore për implementimin e marrëveshjeve që janë të qëndrueshme dhe që mund të përballojnë sfidat ligjore.

Zbatimi marrëveshjeve të tjera ka vazhduar, edhe pse me një ritëm më të ngadalshëm. Në MIK, pas gjashtë objekteve të përkohshme, është arritur pajtim për dy **pika kalimtare** të përhershme shtesë, për të cilat Serbia ka nisur procesin e shpronësimit në territorin e saj. Megjithatë, vendkalimet ilegale/rrugët anësore, veçanërisht në veri të Kosovës, vazhdojnë të shfrytëzohen rregullisht për të kontrabanduar një sasi të madhe mallrash. Masa shtesë duhet të ndërmerren nga Serbia për të ndaluar kalimet ilegale. Zhvillimi i rasteve në kornizën e modaliteteve të përgjithshme të 2013 për **Asistencën e Përbashkët Ligjore** është pezulluar midis muajit tetor 2014 dhe gusht 2015 nga autoritetet serbe. Trajtimi i mbi 600 rasteve në pritje ka nisur në muajin shtator 2015. Lidhur me bashkëpunimin rajonal, Kosova është bërë pjesëmarrëse e përhershme në RACVIAC (Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë) dhe i është bashkuar MARRI-t (Iniciativa rajonale për migrim, azil, dhe refugjatë). Megjithatë, Serbia duhet të mbetet e zotuar për të vazhduar implementimin e marrëveshjes për përfaqësim dhe pjesëmarrje të Kosovës në **forume rajonale**.

Serbia dhe Kosova kanë marrë pjesë po ashtu në diskutime konstruktive për përmirësimin e bashkëpunimit në përpjekjet për zvogëlimin e rrjedhës së migrimit nga Kosova në fillim të këtij viti.

Në përgjithësi, Serbia dhe Kosova kanë mbetur të angazhuara në dialog dhe të zotuar për zbatimin e “Marrëveshjes së parë të primeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve” e prillit 2013 dhe të marrëveshjeve të tjera të arritura në këtë dialog. Hapat që janë ndërmarrë kanë dhënë një shtytje të re në normalizimin e marrëdhënieve dhe duhet të kenë ndikim pozitiv dhe konkret në jetën e përditshme të qytetarëve si të Kosovës ashtu edhe Serbisë. Progresi i mëtijshëm në këtë fushë mbetet qenësor për avancimin e të ardhmes evropiane të

dyjave, Serbisë dhe Kosovës.

4. KRITERET EKONOMIKE

Shifrat ekonomike kryesore	2013	2014
Bruto produkti vendor per kokë banori (% eBE28 në PPS)	N/A	N/A
Rritja e BPV-së (%)	3.4	0.9
Shkalla e papunësisë (femra; meshkuj) (%)	30 (38.8; 26.9)	35.3 (41.6; 33.1)
Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat e moshës 20–64 vjeç: raporti i popullsisë së moshës 20–64 vjeç që janë ekonomikisht aktivë (femra; meshkuj) (%)	46.4 (23.7; 69.5)	47.7 (24.2; 71.4)
Bilanci aktual i llogarisë (% e BPV)	-6.4	-8
Investimet e huaja direkte (IHD) (% e BPV)	4.5	2.3

Burimi: Eurostat

Në përputhshmëri me konkluzionet e Këshillit Evropian në Kopenhagë në qershor 1993, pranimi i BE-së kërkon një ekonomi tregu që funksionon dhe kapacitet për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregu brenda Bashkimit.

Monitorimi i këtyre kriterëve ekonomike dihet të shihet në kontekst të rritjes së rëndësisë së qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit. Për të përmirësuar qeverisjen e tyre ekonomike, në vitin 2015 është kërkuar nga vendet në zgjerim që të përgatisin Programet e Reformës Ekonomike (PRE), të cilat paraqesin një kornizë afatmesme të politikave makro-fiskale, bashkë me reformat strukturore kryesore që kanë për qëllim mbështetjen e kornizës dhe rritjen e konkurrencës. PRE-të ishin baza e rekomandimeve specifike të vendeve, të cilat u miratuan bashkërisht nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor e Turqia në takimin e Dialogut Financiar dhe Ekonomik më 12 maj 2015.

4.1. Ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregut

Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Vazhdimi i reformës ekonomike ka shënuar një shtysë të re pas bllokadës pas zgjedhjeve. **Pak përparim** është bërë veçanërisht në lehtësimin e krijimit të bizneseve, në përmirësimin e sistemit ligjor dhe në stabilitetin e sektorit financiar. Mungesa e tregtisë së qëndrueshme pasqyron një bazë të dobët prodhimi dhe mungesë të konkurrencës ndërkombëtare. Një sektor publik joefikas dhe një vendim ad hoc i politikës fiskale përbën rrezik të madh

Mbështetja në remitenca dhe në ekonominë joformale, e cila është e përhapur gjithandej, zvogëlon edhe më shumë mundësitë për punësim, duke rezultuar me pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore, veçanërisht në mesin e femrave, me shkallë të lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe punëtorëve të pakualifikuar. Kosova duhet të zvogëlojë mbështetjen në taksa doganore përmes zgjerimit të bazës tatimore vendore dhe modernizimit të mbledhjes së të hyrave.

Në përputhje me rekomandimet e PRE-së dhe në mënyrë që të mbështetet rritja afatgjatë, vitin e ardhshëm Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- sigurimit të qëndrueshmërisë fiskale;
- përshpejtimin të privatizimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike;
- përmirësimin të procedurave të falimentimit dhe pamundësisë së pagesës fiskal.


Elementet themelore të politikës ekonomike

Dokumentet strategjike të Qeverisë tregojnë një angazhim të shtuar për zbatimin e reformave ekonomike. Kjo duhet të përkthehet në zbatim të përcaktuar të politikave dhe në shmangie të vendimmarrjes ad hoc në politikën ekonomike. Bllokimi politik pas zgjedhjeve të vitit 2014 ka vonuar zbatimin e politikave të mira ekonomike, përfshirë edhe miratimin e Buxhetit për viti 2015.

Kosova ka dorëzuar Programin e saj të parë të Reformës Ekonomike (PRE) në Komisionin Evropian në janar 2015. Bashkë me programin e ri qeveritar, PRE pasqyron një zotim të qartë për aplikimin e një politike fiskale stabile dhe të reformave strukturore për rritjen e konkurrencës. Pas aprovimit të përbashkët të rekomandimeve të PRE-së, Qeveria e Kosovës ka nisur lansimin e reformave të bazuara në PRE. Një program i ri 22 mujor me vlerë 184 milionë euro me FMN është aprovuar në korrik 2015. Ky program ka për qëllim fuqizimin e besueshmërisë së financave publike, në përputhshmëri me rekomandimin 1 të PRE-së, duke zgjeruar më tej stabilitetin financiar dhe duke rritur konkurrencën dhe kapacitetet prodhuese.


Rekomandimi 1 i PRE-së: "Të mbahet premtimi për disiplinë fiskale dhe të përmirësohet transparenca e financave publike, duke marrë në konsiderim themelimin e një këshilli fiskal të pavarur ose të një agjencie fiskale, me mandat të qartë ruajtjen e qëndrueshmërisë së financave publike dhe zvogëlimin e shkallës së deficitit, si dhe koordinimin më të mirë të qeverisë dhe trupave përkatëse parlamentare për proceset buxhetore. Të përmirësohet menaxhimi buxhetor përmes fuqizimit të rolit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në mënyrë ligjore dhe mbajtjes së parimeve të analizës së kostove-përfitimeve, si bazë në procesin për planifikimin e politikave. Të ndërmerren hapa për rritjen e depozitave qeveritare deri në pragun që përcaktohet nga rregulli fiskal (4.5 % e BPV) për të siguruar tamponin financiar të detyrueshëm."

Stabiliteti makroekonomik



Situata makroekonomike ka mbetur stabile por sfiduese, duke qenë e goditur nga pasiguritë politike të vitit 2014. Të dhënat preliminare tregojnë se në vitin 2014 rritja ekonomike ka rënë në 0.9 %, nën mesataren e dhjetë vjetëve prej 3.5%, si pasojë e bllokadës politike, gjë që ka shkaktuar vonesa në investimet kapitale. Rritja ekonomike është karakterizuar kryesisht prej konsumit privat (1.2 pikë të përqindjes kontributi në rritje

ekonomike) që ka rezultuar prej remitencave më të larta dhe rritjes së pensioneve e pagave në sektorin publik. Eksportimi neto ka vazhduar të rëndojë rritjen e BPV-së (-1 pikë të përqindjes). Kapaciteti i prodhimit është zhvilluar dobët. Aktivitetet tregtare dhe të patundshmërive kanë vazhduar të ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike, derisa ndërtimi është kontraktuar. Rezultatet preliminare për Çerekun 1 (Ç1) të vitit 2015 kanë treguar se është ngadalësuar rritja ekonomike e mëtejshme, në të cilën me gjasë ka ndikuar rrjedha e migrimit në fillim të këtij viti.




Debalansi tregtar me jashtë është përkeqësuar pak në vitin 2014, përkundër rimëkëmbjes së vazhdueshme ekonomike të partnerëve tregtarë kryesorë të Kosovës dhe në vendet e diasporës. Në vitin 2014, deficitin e pagesave është rritur në 8 % të BPV-së, i cili kishte këtë rënë që nga viti 2011. Kjo rritje ka rezultuar nga transferet më të dobëta nga jashtë në qeveri, të cilat janë shkaktuar nga vonesat në projektet në vazhdimësi për shkak të bllokadës ekonomike. Remitencat në rritje (12.6 % e BPV në vitin 2014) kanë vazhduar të kundërbalancojnë deficitin tregtar tradicionalisht të lartë (31.6 % e BPV në vitin 2014). Rrjedha e investimeve të huaja direkte (IHD) kanë shënuar 2.6 % të BPV-së, që është shifra më e ulët në dhjetë vjetët e fundit, që ka arritur mesataren 6.7 % të BPV. Një shumë e madhe e të hyrave financiare ka qenë jorformale dhe nuk është regjistruar (5% e BPV-së). Borxhi i jashtëm i Kosovës ka mbetur relativisht i ulët, në 31.6% të BPV në vitin 2014 dhe aktualisht nuk ka arsye për shqetësim.

Punësimi është jashtëzakonisht i ulët dhe përpjekjet për të përmirësuar kushtet në tregun e punës kanë qenë të kufizuara. Rritja ekonomike mesatare gjatë viteve të fundit nuk është përkthyer në një performancë më të mirë nga ana e tregut të punës. Kosova ka shkallën më të ulët të papunësisë dhe të aktivitetit në Evropë (26.9 % dhe përkatësisht 41.6%). Kjo ka ndodhur për shkak të bazës së ulët të prodhimit dhe konkurrencës së dobët të kapitalit njerëzor dhe kostos së prodhimit. Mbështetja në remitencat dhe në ekonominë joformale të përhapur gjithandej ka zvogëluar edhe më shumë stimulimet për punësim.

Shkalla e papunësisë është rritur në 35.3% në vitin 2014, nga 30% në vitin 2013. Kushtet e tregut të punës janë të vështira veçanërisht për femra. Vetëm një në pesë femra të moshës për punë kanë qenë aktive në tregun e punës dhe vetëm një nga tetë femra kanë qenë të punësuar. Mundësitë e kufizuara për punë, veçanërisht për të rinjtë (61% papunësia e të rinjve), po rëndojnë kohezionin social dhe po inkurajojnë migrimin. Financimi i politikave aktive për tregun e punës mbetet i ndarë dhe i pamjaftueshëm. Statistikat e tregut të punës kanë mbetur jo të përshtatshme dhe nevojiten të dhëna më të harmonizuara në mënyrë që Kosova të jetë në gjendje të bëjë zgjedhje të informuara për politikën.

Inflacioni varet kryesisht në çmimet e importit, në mënyrë specifike nga çmimet e ushqimit dhe energjisë. Indeksi i çmimeve të shportës së konsumatorit në Kosovë ka pësuar një trend në rënie që nga viti 2011, duke arritur 0.4% mesatarisht në vitin 2014 dhe duke rënë më tej në -0.7 % deri në korrik 2015.

Realizimi i buxhetit 2014 është karakterizuar me të hyra më të ulëta se sa që është pritur dhe me rritje ad hoc të shpenzimeve para zgjedhjeve. Buxheti i vitit 2014 ishte buxheti i parë që i është nënshtruar rregullit të ri fiskal të deficitit 2% të BPV-së. Si pasojë e rritjes së pagave, pensione dhe përfitimeve në prill 2014 nga ana e qeverisë, shpenzimet aktuale llogariten të kenë një përqindje më të lartë të shpenzimeve të përgjithshme prej 71.3 % në vitin 2014 krahasuar me 63.5 % në vitin 2013. Përveç kësaj, qeveria zotoi rreth 32% të të hyrave të përgjithshme të katër viteve të ardhshme për ndërtimin e autostradës, duke kufizuar kështu edhe më shumë hapësirën fiskale në vitet e ardhshme. Shpenzimet e përgjithshme nuk janë përmbushur për 11% krahasuar me planin. Kjo rënie ka qenë pasojë e vonësve në investimet publike.



që kanë për synim zvogëlimin e shpenzimeve aktuale paqëndrueshmërisht të larta, derisa ruan rritjen përmes shtimit të shpenzimeve kapitale. Zhvillimi i një kornize ligjore për mbajtjen e një kambiali të qëndrueshëm për pagat publike dhe fuqizimi i synimit dhe mjeteve për testimin e transfereve. Sigurimi i rritjeve të planifikuara në subvencione bujqësore drejtohet në mënyrë ekskluzive në iniciativat për rritjen e produktivitetit. Avancimi i reformës administrative me vëmendje të veçantë në përmirësimin e produktivitetit dhe zvogëlimin e kostove. Ndërmarrja e hapave të mëtutjeshëm në fuqizimin e praktikave për menaxhimin e financave publike.

Borxhi i përgjithshëm publik ka vazhduar të rritet, duke arritur në 10.6% në vitin 2014. Një përqindje në rritje e kësaj shifre vjen nga bonot e thesarit të lëshuara brenda vendit. Kosova ka një nivel relativisht të ulët të borxhit publik. Megjithatë, duke ditur mbështetjen e saj në financim vendor afatshkurtër dhe kreditë e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe pamundësia e saj për të dhënë borxhe ndërkombëtare, në mungesë të një klasifikimi kreditor, një politikë fiskale e matur është qenësore për Kosovën. Të hyrat nga buxheti i qeverisë kanë pasur nënrealizim prej

Rekomandimi 3 i PRE-së: "Modernizimi i mbledhjes së të hyrave për të zvogëluar mbështetjen në hyrat doganore, përmes përmirësimit të mbledhjes së tatimit në pronë dhe fuqizimit të kornizës ligjore për mbledhjen e taksave dhe vonësve tatimore komunale. Rishikimi i skemës financiare vendore për grantet e qeverisë për të nxitur mbledhjen më të mirë të të hyrave komunale. Zgjerimi më i madh i bazës tatimore përmes prezantimit të kontributeve të planifikuara të obligueshme

12%; dhe kjo për shkak të rritjes më të ulët se sa që është pritur dhe për shkak të shtyrjes së disa transfereve që paguhën njëherësh. Kosova duhet të ndërmarrë masa të mëtutjeshme për të përmirësuar mbledhjen e të hyrave në pajtim me Rekomandimin 3 të PRE-së. Deficiti i përgjithshëm fiskal ka mbetur në 2.5 % të BPV-së, që është më i lartë se pragu i rregullit fiskal prej 2%. Megjithatë, duke marrë parasysh përjashtimet që lejohen nga ky rregull, buxheti i vitit 2014 mund të konsiderohet të jetë në përputhje me të. Shkelja e rregullit fiskal në çdo rast është shmangur vetëm për shkak të mos realizimit të shpenzimeve kapitale.

Depozitat e Qeverisë, që mbahen si burim emergjent i financimit, kanë rënë vazhdimisht në 1.8% të BPV-së në fund të vitit 2014, kryesisht nën pragu 4.5% që përcaktohet me rregullin fiskal.

Për shkak të bllokadës politike pas zgjedhjeve, buxheti i vitit 2015 është miratuar vetëm në dhjetor 2014 dhe është bazuar në parashikime tepër optimiste të të hyrave (18.3% rritje krahasuar me realizimin e buxhetit 2014). Në korrik janë bërë rishikime buxhetore afatmesme si të të hyrave ashtu edhe të shpenzimeve, të cilat pas përshtatjes qëndrojnë ende në 14.1 % dhe 11.5 % më të larta se realizimi i buxhetit 2014.

Deri në korrik 2015, të hyrat janë rritur për 9.3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014, duke mbetur kështu pas planit. Për të rritur të hyrat, nga 1 shtatori 2015, qeveria ka bërë ndryshime në taksat e akcizës dhe në sistemin e TVSH-së.

Reformat e suksesshme në administratën doganore kanë çuar në vlerësimin më të mirë të mallrave dhe në luftimin e kontrabandimit që ka treguar një rritje prej 7.4% në të hyrat kufitare, krahasuar me shtatë muajt e parë të vitit 2014. Shpenzimi gjithashtu ka mbetur nën planin buxhetor, sërish për shkak të mosrealizimit të shpenzimit kapital. Pa përmirësim të mëtejshëm në mbledhjen e të hyrave ose në uljen e shpenzimeve shtesë, do të jetë e vështirë të plotësohen të dyja, deficitin fiskal dhe planin e shpenzimeve kapitale.

Rregulli fiskal dhe ligji për financat publike përbëjnë thelbin e menaxhimit të financave publike në Kosovë. Megjithatë, duhet të përmirësohet zbatimi i tyre dhe mekanizmat monitorues. Vendimmarrja fiskale, ad hoc, e përsëritur, ka ndikim të madh në ecuritë fiskale dhe është kërcënimi kryesor i qëndrueshmërisë fiskale. Procedurat e planifikimit buxhetor nuk kanë qenë transparente dhe nuk kanë qenë të koordinuara deri më tash, dhe programet për shpenzimin e buxhetit nuk janë në përputhshmëri me prioritetet afatgjata të qeverisë. Lansimi i një sistemi qendror të prokurimit dhe kontrolli më i mirë i procedurave kontraktuese në nivel lokal janë hapa të mirëpritur, mirëpo duhet të bëhet më shumë në përmbushjen e Rekomandimit 2 të PRE-së.

Bashkëveprimi i forcave të tregut

Në përgjithësi, shumë pak progres është shënuar në privatizimin dhe në likuidimin e ndërmarrjeve publike. Nuk është bërë asnjë privatizim. Agjencia e privatizimit ka mbetur jofunksionale dhe besueshmëria e saj është zbehur më tej për shkak të ndikimeve politike dhe dyshimeve për korrupsion. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka ende bord të ri, të besueshëm, të pavarur dhe funksional; procedurat për përzgjedhjen e menaxhmentit të saj në bazë të meritës dhe mekanizmat kundër korrupsionit duhet të fuqizohen në pajtim me rekomandimin 4 të PRE-së. Statusi i pazgjidhur i të drejtave pronësore dhe procedurave të gjata ligjore në trajtimin e kërkesave financiare për pasuritë e privatizuara vështirësojnë procesin e privatizimit dhe vonojnë pagesën e të hyrave nga privatizimi të cilat mbahen nga banka qendrore.

Rekomandimi 4 i PRE-së: "Avancimi i ristrukturimit dhe rifillimi i privatizimit të ndërmarrjeve publike jo-thelbësore (NP). Ndërmarrja e hapave për përmirësimin e efikasitetit dhe qeverisjes së korporatave të NP-ve strategjike. Adresimi i mungesës së kuorumit të bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe përsheptimi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që ndodhen ende në portofolin e AKP-së.."

Në mesin e ndërmarrjeve të menaxhuara nga niveli qendror, vetëm dy, Korporata Energjetike e Kosovës dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, kanë vazhduar të gjenerojnë fitim në vitin 2014. Ndikimi i qeverisë në kontrollimin e çmimeve për shërbime të centraleve dhe të telekomunikimit ka vazhduar.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Pak përparim është bërë në thjeshtësimin e regjistrimit të bizneseve, mirëpo procedurat e paaftësisë së pagesës ende paraqesin një pengesë.

Krijimi i zyrave për shërbim të qytetarëve në vitin 2014 ka reduktuar kohën e nevojshme për regjistrimin e kompanive deri në 3 ditë. Megjithatë, regjistrimi online nuk është implementuar ende plotësisht. Pengesa të shumta për hyrje në treg mbeten: administrata e dobët dhe e papërgjegjshme, qasja e pamjaftueshme në financa; një infrastrukturë e pazhvilluar mirë (veçanërisht në furnizimin me energji elektrike); mungesa e sundimit të ligjit; praktikat e zhvatjes; ekonomia joformale e përhapur gjithandej;

Rekomandimi 5 i PRE-së: "Adresimi i shkaqeve themelore të kostos së lartë të financimit bankar, zvogëlimi i kohëzgjatjen dhe kostos së procedurave të paaftësisë për pagesë përmes miratimit të ligjit të ri për falimentim dhe përmirësimit të mëtejshëm të zbatimit të kontratave me synim për të rritur ndërmjetësimin e përgjithshëm financiar në ekonomi."

dhe arsim akademik dhe profesional i pamjaftueshëm. Procedurat e dobëta për paaftësinë e pagesës ende pengojnë pagesat e vonuara të kreditorët për hyrje dalje nga tregu. Një projektligj për falimentimin duhet të aprovohet në përputhshmëri me Rekomandimin 5 të PRE-së.

Sistemi ligjor

Përkundër përparimit të vogël që është bërë në rregullat ligjore që qeverisin afarizmin, implementimi i tyre ka mbetur i pamjaftueshëm. Kapaciteti shumë i dobët institucional për zbatimin ligjor, i kombinuar me korrupsionin e përhapur, ka vazhduar të vështirësojë mjedisin afarist. Sistemi gjyqësor vuan nga mundësia e dobët e qasjes, joefikasiteti, vonesat dhe një numër në rritje i rasteve të pazgjidhura (400 000 në korrik 2015). Emërimet e ndikuara politikisht të gjykatësve dhe prokurorëve kufizojnë pavarësinë e gjyqësorit. Kërkohej më shumë punë në rishikimin e Kodit Civil për proceset gjyqësore afariste dhe për praktikat afariste si dhe për zhvillimin e bazave të të dhënave të regjistrimit (kadastrit), në përputhshmëri me Rekomandimin 8 të PRE-së.

Zhvillimi i sektorit financiar

Është ruajtur stabiliteti i sektorit financiar dhe është rritur shkalla e rritjes kreditore. Rritja kreditore e qëndrueshme në sektorin bankar të Kosovës është rimëkëmbur në vitin 2014 (4.2% rritje) dhe ka vazhduar të rritet në vitin 2015. Sistemi financiar i Kosovës mbetet e dominuar nga sektori bankar (69.5% e pasurive të përgjithshme të sektorit financiar). Stabiliteti i sektorit bankar është fuqizuar, me një përqindje të kredive joperformuese, të mbuluara plotësisht prej provizioneve bankare, që kanë rënë në 7.1 % (korrik 2015). Përmbaruesit e kredive private, të cilët janë certifikuar në fund të vitit 2014, kanë kontribuar në rënien e NPL. Përmirësimi i fitimprurjes së bankave në vitin 2014 (131.1 % rritje në fitim) ka fuqizuar më tej tamponët e tyre kapitalë në 19 %, që është dukshëm mbi kërkesat e rregullatorit. Edhe pse është rritur huadhënia e përgjithshme, raporti ende relativisht i ulët mes kredive dhe depozitave (74.3 %) nënkupton që ka hapësirë të mjaftueshme për aktivitet bankar më të fuqishëm. Normat mesatare të inversit për kredi kanë rënë për herë të parë nën 10 %, mirëpo kanë mbetur mbi mesataren e rajonit.

Në sektorin e sigurimit mbizotërojnë kompanitë për sigurime jo-jetësore. Kostoja e sigurimit të automjetit është e lartë në mënyrë artificiale, për shkak se Kosova nuk është anëtare e sistemit të "Kartonit të gjelbër", mirëpo edhe në mungesë të çmimeve të sigurimit për detyrimin e palës së tretë, plotësisht të liberalizuara.

Banka Qendrore e Kosovës ka vazhduar të përmirësojë infrastrukturën SWIFT për pagesa ndërkombëtare, e cila ka mundësi qasjeje dhe mund të përdoret nga të gjitha bankat. Që nga muaji shkurt 2015, bankat në Kosovë kanë përdorur IBAN për pagesa ndërkombëtare.

4.2. Kapaciteti për t'u përballur me presion konkurrues dhe me fuqinë e tregut

brenda Bashkimit Evropian

Kosova është në një fazë të hershme të arritjes së kapaciteteve për t'u përballur me presionet konkurruese dhe fuqinë e tregut brenda Bashkimit Evropian. Nuk është shënuar progres në përmirësimin e cilësisë së arsimit, i cili paraqet faktorin kryesor në përmirësimin e rritjes dhe konkurrencës afatgjatë.

Në pajtim me rekomandimet e PRE-së dhe në mënyrë që të mbështetet rritja afatgjatë, vitin e ardhshëm Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje:

→ sigurimit të një furnizimi të qëndrueshëm me energji dhe zvogëlimin të humbjeve në distribucion;

→ mbylljes së boshllëkut të kualifikimeve në tregun e punës;

→ drejtimit të investimeve të huaja direkte dhe remitencave në sektorët të prodhimit.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Nuk është bërë përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit. Rritjet e shpenzimeve publike në arsim (deri në 4.4 % të BPV-së në vitin 2014

me 4.6 % të planifikuar për vitin 2015) deri më tash janë përdorur pothuaj plotësisht për të mbuluar rritjen e pagave. Financim më i madh duhet të drejtohet në aspektet e tjera të reformës arsimore, ashtu siç përcaktohet në Rekomandimin 7 të PRE-së. Themelimi i Agjencisë për Aftësim dhe Trajnim Profesional dhe Arsim të Të Rriturve (TAP) duhet të ndihmojë në adresimin e mospërshtatjes së kualifikimeve në tregun e punës.

Megjithatë, shkalla e papunësisë në mesin e profesionistëve të diplomuar është 71 %.

Financimi jo i mjaftueshëm, niveli i ulët i bashkëpunimit mes shkollave profesionale dhe bizneseve dhe vonesat në zbatimin e politikave mbështetëse të mëdha.

Kosova ka arritur progres në përmirësimin e kapitalit fizik, mirëpo investimet në rrugë dominojnë qartë mbi efikasitetin e energjisë dhe distribucionin e ujit. Në vitin 2014, investimi i përgjithshëm ka vazhduar të bjerë, duke arritur në 26.2% të BPV-së. Agjenda e qeverisë për shpenzime kapitale dominohet nga ndërtimi i rrugëve, respektivisht ndërtimi i autostradës për në Shkup - Rrugës 6. Rekomandimi 6 i PRE-së përcakton mënyrat për përmirësimin e vlerësimit të projekteve të mëdha të infrastrukturës.

Rekomandimi 7 i PRE-së: " Përmirësimi i cilësisë së arsimit përmes vazhdimin të ofrimit të trajnimit dhe licensimit të mësimdhënësve si dhe sigurimit të përmirësimit të cilësisë dhe fuqizimit të stimulimeve të ndërlidhura; përmirësimi i qasjes në arsimin parafillor dhe fillor; përshtetimi i modernizimit të arsimit profesional; të vazhdojë me përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe të fokusohet në drejtimin e sistemit arsimor në atë mënyrë që të jetë përgjegjës për tregun e punës. Sigurimi i operacionalizimit me kohë të Shërbimit të Punësimit Publik, të themeluar së fundi, dhe ndikimi në uljen e shkallës së lartë të papunësisë."

Mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike ende shihet si një prej pengesave më të mëdha për rritjen e investimeve. Investimet në rrjetin e energjisë elektrike e kanë përmirësuar stabilitetin e rrjetit dhe kanë zvogëluar humbjet teknike. Ka filluar ndërtimi i lidhjes së re të transmisionit 400kV me Shqipërinë dhe është realizuar projekti për ngrohjen e qytetit nga termocentrali Kosova B. Negociatat me të vetmin ofertues për ndërtimin e termocentralit të ri modern kanë ngjatur.

Rekomandimi 6 i PRE-së:

"Fuqizimi i mbikëqyrje se qeverisë dhe të konsiderohet themelimi i një organi këshillimor për të kontribuar në vlerësimin e projekteve të mëdha të infrastrukturës në të ardhmen, përfshirë këtu ndikimin e tyre në ecuritë fiskale dhe të sigurohet që ato të jenë në përputhje me agjendën rajonale për lidhje (rrjet thelbësor). Avancimi drejt sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji derisa sigurohet përputhshmëri me standardet e BE-së për mjedis në prodhimin e energjisë."

Pothuaj të gjitha investimet e huaja direkte kanë shkuar në sektorin jo-tregtar, në veçanti në patundshmëri dhe në ndërmjetësim financiar. Megjithatë, një kontratë në vlerë 409 milionë eurosh për investime në Qendrën e Skijimit në Brezovicë është nënshkruar në muajin prill. Punime është planifikuar të nisin në muajt e ardhshëm dhe pritet që ky projekt të krijojë rreth 3 000 vende të reja pune.

Struktura sektoriale dhe ndërmarrëso.

Rekomandimi 8 i PRE-së:

"Të vazhdohet me përmirësimin e mjedisit afarist dhe të gjenden zgjidhje për rastet ende të pazgjidhura nëpër gjykatë; të fuqizohen kapacitetet e sistemit gjyqësor dhe zhvillimi i bazave të të dhënave për kadastrën; të avancohen masat për trajtimin e joformalitetit në përputhje me strategjinë për parandalimin e luftës kundër ekonomisë joformale,

përfshirë këtu stimulimet për zvogëlimin e punës së padëkluar. Të zvogëlohet barra administrative për biznesin përmes implementimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë dhe Ligjit për Leje dhe Licenca. Të zhvillohen masat për të ofruar mbështetje për NMV-të dhe për të zgjeruar qasjen e tyre në financa. Luftimi i korrupsionit dhe përpjekjet për përmirësimin e prokurimit publik, përmes zgjerimit të kapaciteteve administrative, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Bordit për Rishikim Publik, dhe implementimit të prokurimit qendror "

Spektori privat i Kosovës vazhdon të jetë i ndarë dhe pa mundësi për të fituar nga përfitimet në efikasitet, meqë ndërmarrjet mikro, e vogla dhe të mesme numërojnë 99% të punësimit të përgjithshëm. Edhe pse ende mbi kolegjet rajonale, pjesëmarrja e bujqësisë në BPV-në e Kosovës ka rënë në 11.4 %, krahasuar me 14.1 % në vitin 2009, derisa pjesa e shërbimeve është ngritur nga 47 % në 49.2% të BPV-së. of GDP. Ndryshimet në strukturën e punësimit prej bujqësisë drejt shërbimeve janë të dallueshme. Kjo është në përputhje me zhvillimet e pritura, si pjesë e tranzicionit të Kosovës drejt një ekonomie moderne të drejtuar kah shërbimet.

Struktura e ndërmarrjeve operative mbizotërohet nga tregtia (29.9 % e ndërmarrjeve operative), pas së cilës vjen akomodimi dhe shërbimet e ushqimit (11%) dhe industria (10.4%, e rritur prej 5.2% në vitin 2013). Fitimet nga prodhimtaria janë të kufizuara për shkak të qasjes së dobët në tregje më të mëdha dhe për shkak të mungesës së investimeve në teknologji

të reja. Kosova duhet të përmirësojë mjedisin e saj afarist, në përputhshmëri me Rekomandimin 8 të PRE-së.

Ndikimi i shtetit në konkurrencë

Nuk ka pasur përparim në zhvillimin e kapacitetit institucional për të kontrolluar ndihmën e shtetit dhe subvencionet ende jepen pa një strategji dhe pa vlerësim të duhur. Ndërmarrjet publike në sektorin e energjisë, transportit dhe të mbeturinave/ujit vazhdojnë të përkrahen me subvencione. Janë dhënë subvencione të reja dhe pagesa direkte në bujqësi. Këto duhet të lidhen më shumë me rritjen e prodhimit. Lirimet nga tatimet dhe taksat doganore janë mundësuar për sektorë të caktuar (bujqësi, IT), mirëpo pa një vlerësim të qartë ndikimi.

Autoritetet kanë vazhduar të krijojnë zonat ekonomike dhe parqet industriale. Megjithatë, kjo është bërë pa një plan kombëtar (që ka qenë edhe kërkesë ligjore) dhe pa shpalosje transparente të stimulimeve tatimore dhe doganore për kompanitë.

Integrimi ekonomik me BE-në

BE-ja është partneri më i madh tregtar dhe i investimeve. Megjithatë, kapaciteti i Kosovës për eksportim mbetet i kufizuar. Ekonomia e Kosovës ende është relativisht e paintegruar në rrjedhat tregtare globale, me një çiltërsi tregtare prej 71.1% të BPV. Megjithatë, vlera e tregtisë së mallrave të Kosovës me BE-në është rritur vazhdimisht që nga viti 2008, duke qëndruar në 41.2% të tregtisë së përgjithshme në vitin 2014.

Përkundër kësaj rritjeje, vëllimi i këmbimit të përgjithshëm tregtar të Kosovës me BE-në mbetet i kufizuar (98.08 milionë euro në eksport dhe 1.08 miliard euro në import në vitin 2014), që pasqyron konkurrencën e ulët të produkteve të saj dhe pengesat e tjera strukturore që pengojnë këtë potencial. Vendet e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) mbeten partneri i dytë më i madh tregtar i Kosovës (29.6 % e tregtisë së përgjithshme).

Rekomandimi 9 i PRE-së: "Lehtësimi i tregtisë përmes ndryshimit të Kodit Doganor dhe aprovimit të legjislacionit të ri për fuqizimin doganor të të drejtave të pronës intelektuale."

Rekomandimi 10 i PRE-së: "Miratimi i një qasjeje holistike për Investimet e Huaja Direkte që ofrojnë politika mbështetëse në një kornizë strategjike dhe fokusimi në heqjen e pengesave ekzistuese. Rritja e mbrojtjes së investitorëve përmes zhvillimit të një programi investitorësh përcjellës të kujdesit dhe krijimit të një mekanizmi ankesash të investitorëve."

Vendet e BE-së janë investitorët më të mëdhenj të huaj në Kosovë (35% e investimit të përgjithshëm). Hyrja në fuqi, e planifikuar, e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të Kosovës me BE-së pritet të stimulojë më tej lidhjet ekonomike me vendet e BE-së. Megjithatë, Kosova do të duhet të vazhdojë reformat në mënyrë që të lehtësojë investimin tregtar dhe atë direkt të huaj, në përputhshmëri me Rekomandimin 9 dhe 10 të PRE-së.

5. STANDARDET EVROPIANE

5.1. Tregu i brendshëm

5.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Vitin e kaluar është shënuar progres. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

- përmirësojë bashkëpunimin ndër-institucional për të siguruar që zbatohet legjislacioni;
- përmirësojë më tej cilësinë e infrastrukturës, të fuqizojë kapacitetin e mbikëqyrjes së tregut dhe të rrisë vetedijësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka bërë përparim gradual në implementimin e strategjisë për lëvizjen e lirë të mallrave, e cila është miratuar në shkurt të vitit.

Në **masat horizontale**, sa i përket **standardizimit**, janë miratuar 1 064 standarde evropiane si një referencë standarde në periudhën raportuese. Marrëveshja për bashkëpunim e arritur me Organin Shqiptar të Standardeve është mënyra që Kosova të aprovojë standardet evropiane. Agjencia e Standardeve të Kosovës duhet të konsolidohet si institucion, dhe të zgjerojë shitjet online të standardeve (funksioni e-Tregtia).

Në vitin 2014, Kosova ka aprovuar disa rregullore dhe udhëzime administrative, në mënyrë që të ketë një sistem për vlerësimin e **përshtatjes**. MTI po ashtu ka autorizuar disa organe për vlerësimin e përshtatjes. Harmonizimi me rregullat e BE-së dhe përdorimi dhe zbatimi i vlerësimit të përshtatjes duhet të fuqizohen.

Lidhur me **akreditimin**, në nëntor 2014 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit i është nënshtruar një vlerësimi të plotë të grupit të Bashkëpunimit Evropian për Akreditim. Ky është një hap shumë i rëndësishëm drejt nënshkrimit të marrëveshjes multilaterale evropiane për akreditim të laboratorëve për testim. Këto rekomandime janë duke u implementuar.

Sa i përket **metrologjisë**, Agjencisë për Metrologji ende i mungon kapaciteti. Laboratorët për kohë, frekuencë, gjatësi dhe fuqi ende nuk janë funksionalë për shkak të mungesës së pajisjeve. Kosova është përafërsisht plotësisht me Direktivën për Instrumente Matëse Joautomatike. Që nga viti 2014, aktivitetet e laboratorit janë rritur në fushën e masës, rrjedhës dhe vëllimit, matjes elektrike, metaleve të çmueshme dhe termimetrisë. Sistemi i cilësisë i imponuar nga aplikimi i standardeve ISO duhet të implementohet dhe ngritja e vetëdijësimin të përmirësohet. Në përgjithësi, kapaciteti operativ i laboratorëve duhet të rritet në mënyrë që të përmbushë standardet e nevojshme të cilësisë.

Për **mbikëqyrjen e tregut**, inspektoratet e tregut kanë kryer 1622 inspektime që kanë rezultuar në 145 masa korrektuese (gjyba dhe konfiskime). Një Rregullore për themelimin dhe funksionimin e shkëmbimit të shpejtë të sistemit informativ në produktet e rrezikshme është në një fazë shumë të hershme të zbatimit. Mekanizmat për komunikim dhe bashkërendim në mes të përgjegjësve për mbikëqyrjen e tregut duhet të përmirësohen dhe zbatimi të fuqizohet.

Sa i përket **mbrojtjes së konsumatorit**, nevojiten përpjekje të mëtutjeshme. Derisa janë zhvilluar një numër aktivitetesh për ngritjen e vetëdijësimin, qytetarët nuk janë të vetëdijshëm

mjaftueshëm për të drejtat e tyre si konsumatorë. Midis shtatorit 2014 dhe shtatorit 2015, 307 ankesa të konsumatorëve janë dorëzuar në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve; 125 ankesa janë zgjidhur në favor të konsumatorit; 101 janë konsideruar të pabaza dhe 72 nuk janë shqyrtuar ende.

Janë aprovuar disa udhëzime administrative për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kemikaleve. Ende nuk ka dëshmi për përafrimin me Rregulloren për regjistrim, vlerësim, autorizim dhe kufizim (REACH).

5.1.2. Lëvizja e njerëzve, shërbimeve dhe e drejta për krijim

Kosova është në një **fazë të hershme** të përgatitjes në lëvizjen e lirë të personave, shërbimeve dhe të drejtës për krijim. **Pak përparim** është bërë veçanërisht në shërbimet financiare. Auditimi dhe llogari-mbajtja e plotë dhe transparente janë qenësore për zhvillimin e një tregu të mirë shërbimesh financiare dhe të ekonomisë në përgjithësi, në veçanti ndërmarrjet e vola dhe të mesme (NVM-të). Vitin e ardhshëm, Kosova duhet posaçërisht të:

→ përafrojë edhe më shumë ligjin me shërbimet e B-së dhe direktivat e saj për kualifikime profesionale;

→ harmonizojë më tej rregulloret dhe procedurat ekzistuese me praktikën e BE-së, posaçërisht në fushën e llogari-mbajtjes dhe auditimit të korporatave.

Lidhur me **lëvizjen e njerëzve**, nuk është arritur asnjë marrëveshje për lëvizjen e punëtorëve dhe bashkërendimin e sistemeve të sigurisë sociale.

Në **lirinë për të ofruar shërbime**, Kosova është në një fazë të hershme të përafrimit me direktivën e shërbimeve. Një bazë të dhënash për tregti në shërbime është krijuar në MTI, me qëllim të mbështetjes së negociatave për tregti në liberalizimin e shërbimeve, të cilat janë duke u zhvilluar në kuadër të Zonës së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë.

Lidhur me **shërbimet postare**, Kosova ka përfaruar në një masë të madhe legjislacionin e saj me *acquis*. Megjithatë, ofrimi i shërbimeve universal pengohet nga vështirësitë politike në komunat me shumicë serbe. Pavarësisht nga disa zvogëlime në kufizimin e peshës për shërbimet e rezervuara viteve të kaluara, ato ende nuk janë në përputhshmëri me *acquis*. Shërbimet postare ndërkombëtare ofrohen në të gjitha administratat postare përveç Serbisë, për shkak të mungesës së një marrëveshjeje.

Mbi **njohjen e dyanshme të kualifikimeve profesionale**, përafrimi me *acquis* është në një fazë të hershme. Një kornizë për profesionet e rregulluara në mbarë Kosovën duhet akoma të aprovohet. Kosova duhet të rrisë përpjekjet e saj për të përafuar legjislacionin me direktivën për shërbime dhe direktivën për kualifikime profesionale. Për ta bërë këtë, Kosova duhet të përgatisë një listë me kërkesat trajnuese minimale në mënyrë që profesionet e rregulluara ytë përfshihen në legjislacionin e saj dhe duhet të përgatisë një plan veprimi për harmonizimin e legjislacionit për kualifikime profesionale me *acquis*.

Banka Qendrore e Kosovës ka vazhduar të shqyrtojë legjislacionin ekzistues për **shërbime financiare**, përfshirë këtu ligjet për sigurimin, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jobankare. Duhet të sigurohet përafrimi i këtyre ligjeve me *acquis*. Kosova ende nuk është pjesë e sistemit të “Kartës së gjelbër”, prandaj edhe për shumicën e automjeteve të huaja që hyjnë në Kosovë kërkohet sigurim shtesë i automjeteve. Sipas Marrëveshjes së ardhshme për Stabilizim Asociim (MSA), Kosova duhet të sigurojë zhvillimin e sektorit të sigurimit bazuar në praktikatat e drejta të konkurrencës dhe një situatë të ndershme të barabartë. Amendamentimi i rregulloreve bankare aktuale për kreditë me hipotekë, për vlerësimin e patundshmërive dhe për mjaftueshmërinë kapitale është bërë në shkurt 2015, duke i përafuar ato, por jo edhe plotësisht, me *acquis*. Qasja e standardizuar për rrezikun kreditor dhe treguesi

kryesor dhe qasja e standardizuar për rrezikun operacional, sipas Shtyllës I të Kornizës Rregullative të Basel II janë në fuqi. Banka qendrore është duke punuar në aprovimin e standardeve Basel për kapital dhe aprovimin e rregullores me kërkesa për kapital. Tregu i shërbimeve financiare mbetet në një fazë të hershme të zhvillimit.

Lidhur me **ligjin për kompanitë**, disa masa administrative janë aprovuar në korrik 2015, duke siguruar kështu bazën për zvogëlimin e taksave për regjistrimin e bizneseve. Ligji që përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve ka mbetur të aprovohet.

Sa i përket **llogari-mbajtjes dhe auditimit të korporatave**, duhet miratuar amendamenti i projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Kapaciteti i strukturave për mbikëqyrjen e auditimit institucional duhet të fuqizohet në mënyrë të konsiderueshme; zbatimi mbetet i dobët dhe kërkohen përpjekje të mëdha për të siguruar zhvillimin e raportimit financiar të besueshëm dhe efikas, në përputhshmëri me praktikën e BE-së. Kosova ende duhet t'i përafrojë rregullat e saj me standardet ndërkombëtare për kontabilitet dhe raportim financiar.

5.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Ka **pak ngritje të nivelit të përgatitjes** në këtë fushë. **Pak progres** është shënuar në lëvizjen e lirë të kapitalit. Lëvizjet e kapitalit mbeten kryesisht të lira, pa kufizime për pronësinë e huaj ose investimin në sektorin financiar, dhe kapaciteti i bankës qendrore për të mbikëqyrur këtë sektor mbetet i mjaftueshëm

Lëvizja e kapitalit mbetet kryesisht e lirë në Kosovë. Projektligji për sigurimin e përgjithshëm, që mbulon çështjet si kërkesat minimale për kapital, kërkesat për aftësi pagimi, dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me kërkesat e duhura për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik për kompanitë e sigurimit ka mbetur të miratohet. Kërkohen përpjekje më të mëdha në arritjen e rezultateve konkrete në luftimin e krimit ekonomik dhe financiar.

Ka pasur përparim të kufizuar në çështjen e përvetësimit të patundshmërisë, përfshirë blerjen e tokës, nga qytetarët e huaj. Dispozitat në ligjet përkatëse, aktet implementuese dhe praktikatat administrative ende mbeten një pengesë për trajtim të barabartë. Vështirësitë e tjera, p.sh. në regjistrimin e pronës, duhet të adresohen.

Lidhur me **sistemin e pagesës**, rregulloret për çështjet që përfshijnë statistikën për instrumentet e pagesës, sistemin numërues të standardeve të llogarive bankare dhe pagesat ndërkombëtare janë aprovuar në vitin 2014. Banka Qendrore e Kosovës ka vazhduar të fuqizojë mbikëqyrjen e sistemeve të pagesës dhe të përmirësojë infrastrukturën e SWIFT për pagesat ndërkombëtare, pas lidhjes së saj me SWIFT në dhjetor të vitit 2013. Në muajin shkurt, Kosova ka nisur të përdorë sistemin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN) për pagesat ndërkombëtare. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të vazhduar përafrimin me *acquis* në shërbimet e pagesave.

5.1.4. Doganat dhe tatimi

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e doganave dhe është në **fazë të hershme** në fushën e tatimit, me **pak progres** të shënuar në këto dy fusha. Ajo ka ndërmarrë disa hapa fillestarë drejt shkrirjes së administratës doganore dhe asaj tatimore dhe përmirësimit të kontrolleve të brendshme. Legjislacioni për dogana është kryesisht në përputhshmëri me kodin doganor të BE-së. vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet të:

- implementojë legjislacionin e doganave në përputhshmëri me praktikën e BE-së;
- fuqizojë platformën e brendshme të TI-së së administratës tatimore, kontrollet e saj të brendshme për performancë dhe luftimin e korrupsionit;
- rrisë luftimin e ekonomisë joformale dhe evazionit tatimor dhe të parandalojë çdo ndikim të paligjshëm në punën e institucioneve të tyre.

Shërbimi **doganor** ka përmirësuar më tej kapacitetin e tij legjislativ, administrativ dhe organizativ. Janë bërë hapat e parë drejt shkrirjes së administratës doganore dhe asaj tatimore në një agjenci të vetme të të hyrave. Përkundër një rënieje të përgjithshme të importit, riorganizimi i administratës doganore në vitin 2014 ka rezultuar me një rritje prej 3.9% në mbledhjen e të hyrave krahasuar me vitin 2013 dhe sistemet e reja kanë zvogëluar hapësirën për korrupsion. Shkrirja e njësive hetimore ka sjellë gjithashtu rezultate pozitive. Doganat e Kosovës funksionojnë në mbarë Kosovën, edhe pse në veri deri në një shkallë të kufizuar. Në vitin 2015, Kosova ka aplikuar për t'iu bashkuar Konventës së Përbashkët për Transit dhe ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me Shqipërinë për lehtësimin e tregtisë, përfshirë transitin e përbashkët, dhe për bashkëpunim në çështjet doganore kriminale me Mbretërinë e Bashkuar. Shkëmbimi i informatave elektronike para arritjes, me administratat doganore rajonale, është duke funksionuar mirë. Megjithatë, mospërputhshmëritë në mes të kodi doganor dhe të akcizës dhe kodit penal vazhdojnë të pengojnë luftimin e krimit doganor. Ekonomia joformale dhe kontrabandimi në vija kufitare vazhdon të dëmtojë ekonominë. Pas një marrëveshjeje në dialogun Prishtinë-Beograd, është pajtuar mbi dy vendkalime të bashkë-vendosura.

Në **tatim**, Kosova ka nisur të implementojë strategjinë 2014-2018 dhe planin e veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Administrata tatimore ka vazhduar të përmirësojë kapacitetin e saj njerëzor dhe administrativ. Është bërë progres në paraqitjen e shërbimeve elektronike, përfshirë kthimet tatimore online, sistemin e verifikimit dhe të pagesës dhe qendrat për regjistrimin e bizneseve (zyrat për shërbimin e qytetarëve). Nuk ka pasur progres në modernizimin e platformës së brendshme të TI-së së administratës dhe procedurave të saj. Kapaciteti për të fuqizuar mbledhjen e tatimeve në Kosovën veriore mbetet jashtëzakonisht i kufizuar. Numri i madh i ankesave kundër administratës doganore dhe tatimore është trajtuar përfundimisht dhe si rezultat Bordi i Pavarur për Shqyrtim të Ankesave që merrej me rastet të tilla është larguar nga detyra në dhjetor 2014.

5.1.5. Konkurrenca

Kosova është në një **fazë të hershme** në fushën e konkurrencës. **Nuk ka pasur progres** në këtë fushë, meqë Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është ballafaquar me sfida të mëdha në kapacitetin e tij vendimmarrës dhe hetimor. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

→ sigurojë që në Komisionin Kosovar të Konkurrencës (KKK) të bëhen emërimet, që personeli, objekti dhe trajnimi për AKK të jetë i duhur dhe që zbatimi të nisë sa më shpejt që është e mundur;

→ aprovojë amendamentet për legjislacionin e ndihmës së shtetit dhe të nisë zbatimin e tij pa vonesë.

Lidhur me **politikën antitrust dhe të shkrirjeve**, ende mungon legjislacioni sekondar për të zbatuar ndryshimet në ligjin për mbrojtjen e konkurrencës të datës shkurt 2014.

AKK ende nuk është funksionale, ende i mungon një kuorum që nga nëntori 2013 për shkak të vonesave në zëvendësimin e pesë anëtarëve të KKK mandati i të cilëve kishte përfunduar. Prandaj, AKK nuk ka qenë në gjendje të kryejë detyrat e saj meqë hetimet e reja duhet të aprovohen nga bordi i KKK-se, dhe një zbatim shumë i vogël po zë vend tani. Në të kundërtën, ajo është koncentruar në avokim dhe ofrim të mendimeve për iniciativat e trupave të tjerë. Edhe pse buxheti është aprovuar, AKK-së ende i mungon personeli dhe objekti i duhur, kontrollet e brendshme dhe sistemet informative. Bashkëpunimi në mes të AKK-se dhe autoriteteve të tjera rregullative duhet të fuqizohet.

Ligji aktual për **ndihmën shtetërore** kërkon amendamentim të mëtejshëm për të qene në përputhshmëri me standardet evropiane, në veçanti për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e Komisionit për Ndhimë Shtetërore. Aktivitetet e Zyrës për ndihmë Shtetërore kanë qenë të kufizuara në shpërndarjen e formularëve të njoftimit për dhuruesit potencialë të ndihmës. Kjo zyrë, aktualisht e themeluar si departament i KKK-së, ka mungesë personeli dhe nuk ka kapacitet për të rishikuar skemat ekzistuese për ndihmë.

5.1.6. *Prokurimi publik*

Kosova është në një fazë të hershme në këtë fushë. Zbatimi efektiv mbetet një sfidë e madhe dhe prokurimi është veçanërisht i ndjeshëm ndaj korrupsionit. Është shënuar **pak progres**, veçanërisht në zbatimin e një sistemi të qendërzuar të prokurimit publik

Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme ende duhen për të përdorur prokurimin publik në mënyrë efikase. mbetet qenësore që të profesionalizohet dhe të depolitizohet ky sistem dhe të bëhet transparent dhe llogaridhënës, përfshirë këtu emërimin e menaxhmentit të lartë. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- fuqizimit të kapacitetit dhe sigurimit të funksionimit të duhur të organeve të prokurimit publik, në veçanti përmes emërimit me kohë të anëtarëve kompetentë të bordeve;
- përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit të prokurimit publik me *acquis*;
- përmirësimit të zbatimit të proceseve të prokurimit publik përmes përdorimit më të madh të procedurave konkurruese të tenderimit, blerjes së centralizuar dhe zhvillimit të e-prokurimit (sistemit elektronik).

Organizimi institucional dhe përafrimi ligjor

Korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhshmëri me *acquis* dhe me parimet e tjera të prokurimit publik, mirëpo ajo nuk i mbulon të gjitha fushat. Ligji për prokurimin publik është gjerësisht i përafruar me direktivat për prokurimin klasik dhe deri në një shkallë me centralet. Ligji për koncesionet dhe partneritetet publiko-private është kryesisht në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së. Megjithatë, mbeten të hartohen rregullat për prokurim të mbrojtjes dhe sigurisë së ndjeshme dhe ligji për prokurimin publik ende po jep preferenca ndaj ofertuesve vendorë.

Në vitin 2014, Kosova ka zhvilluar një **strategji** dhe një plan veprimi për vitet 2015-2020, për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik, i cili ende nuk është aprovuar nga qeveria.

Administrata e prokurimit publik në Kosovë është krijuar dhe përbëhet prej tre organeve kryesore: Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (PPRC), përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik; Organit për Shqyrtim të Prokurimit (PRB), një organ i pavarur për shqyrtime administrative, i cili shqyrton të gjitha supozimet për shkeljen e ligjit për prokurimin publik; dhe Agjencisë Qendrore të Prokurimit (CPA), që është përgjegjëse për blerjet qendrore dhe të koordinuara. Shqetësime mbeten për kufizimet e kapaciteteve, hetimet e korrupsionit dhe procesin e emërimeve në bordin e PRB. Vetëm tre prej pesë anëtarëve të bordit të PRB janë emëruar, gjë që kufizon rëndë aktivitetet e tij, përfshirë këtu edhe shqyrtimet e prokurimit të ndërlikuar dhe me vlera të mëdha. Kapaciteti i zbatimit duhet të fuqizohet në të gjitha nivelet për të siguruar zbatimin.

Kapaciteti i implementimit dhe zbatimit

Tregu i prokurimit publik ka qëndruar në 8.9% të bruto produktit vendor (BPV) në vitin 2014, një rënie e lehtë gjatë tri viteve të fundit. Në vitin 2014, janë dhënë 11 362 kontrata në një vlerë të përgjithshme afro 389 milionë euro. Prej tyre, pothuaj 73% janë dhënë me procedurë të hapur, një zvogëlim i dukshëm prej 17%. Kontratat me vlera të larta shënojnë 63% të të gjitha kontratave dhe numri mesatar i ofertave për tender është rritur në 6.1 në vitin 2014, krahasuar me 5.2.

Implementimi dhe zbatimi efektiv është një sfidë e madhe, kryesisht në sajë të planifikimit të dobët dhe korrupsionit. Pothuaj 30% e njoftimeve për kontrata janë anuluar, duke nënvizuar nevojën për të përmirësuar planifikimin e prokurimit. Rreziqet dhe mungesat janë të pranishme në të gjitha fazat e prokurimit publik. Dispozitat ligjore për vlerësimin e performancës së kontratave, efektivitetin dhe efikasitetin e procedurave të prokurimit publik dhe menaxhimi i kontratave janë përgatitur, mirëpo kapaciteti për zbatim duhet të fuqizohet. Duhet shikuar mënyrat dhe mjetet për rritjen e vlerës në para. Janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për të fuqizuar një sistem të centralizuar të prokurimit. Në shkurt 2015, një listë

me artikuj të zakonshëm, përfshirë gjashtë kategoritë që duhet të prokurohen në qendër, është aprovuar për herë të parë që nga themelimi i CPA-së.

Monitorimi i prokurimit publik është i pamjaftueshëm. Monitorimi *ex post* që është bërë nga PPRC është ende i kufizuar në kontrollime josistematike, të kohëpaskohshme të kontratave të realizuara të prokurimit. Vetëm një pjesë e vogël e kontratave të realizuara të prokurimit monitorohet. Vitin e kaluar, PPRC ka nisur monitorimin *ex ante* të njoftimeve për kontrata që dërgohen nga autoritetet kontraktuese për publikim, që është një kontribut pozitiv në parandalimin e parregullsive, i cili duhet të zgjerohet më tej.

Ekziston edhe një portal qendror i prokurimit publik. Për të rritur transparencën dhe për të promovuar efikasitetin në prokurimin publik, uebfaqet e të gjitha institucioneve të prokurimit publik duhet të përmirësohen dhe planet e prokurimit të organeve të prokurimit mund të publikoheshin. Me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, Kosova planifikon të paraqesë e-prokurimin dhe aktualisht është duke zhvilluar infrastrukturën e teknologjisë informative dhe të komunikimit dhe një sistem informativ për menaxhimin e kontratave. Përkimi i duhur i hapave, përfshirë amendamentet e nevojshme legjislative dhe ndërtimin e kapaciteteve duhet të përcaktohen dhe të implementohen.

Sa i përket **kapacitetit** të autoriteteve **pë r t e menaxhuar prokurimin publik**, ligji përcakton trajnime të detyrueshme për zyrtarët e prokurimit publik. Kurset trajnuese dhe provimet ofrohen nga Instituti Kosovar i Administratës Publike, me përfshirjen e PPRC. Megjithatë, sistemi i verifikimit dhe kapaciteti për të menaxhuar prokurimin publik ende kanë nevojë të përmirësohen.

Ka mungesë rregullash për **integritetin dhe konfliktet e interesit**, zbatim i pamjaftueshëm për të identifikuar dhe për të adresuar praktikën korruptive dhe mashtruese, dhe mungesë e sistemit të treguesve të rrezikut. Perceptimi i korrupsionit në prokurim publik mbetet dominues në Kosovë. Ekzistojnë procedura disiplinore të përcaktuara me statut, mirëpo shqetësimet për zbatimin e tyre mbesin. Integriteti dhe bashkëpunimi në mes të të gjitha organeve të prokurimit duhet të fuqizohet.

Sistemi efikas i rregullimit ligjor

E drejta për rregullim ligjor është e përcaktuar në ligjin për prokurimin publik dhe ligjin për kocensionet. Ligji i prokurimit publik është në përputhshmëri me dispozitat e *acquis* për anulimin e kontratës dhe ndëshkimet, edhe pse në praktikë kjo nuk përdoret shpesh, lidhur me rregullimet, në vitin 2014, PRB ka pranuar dhe ka shqyrtuar 537 ankesa. Prej tyre, 161 raste janë kthyer për rivlerësim, derisa për 104 rate paneli i ankesave ka vendosur që të anuloej prokurimin. Pjesa më e madhe e parregullsive vazhdon të jetë në vlerësimin e ofertave dhe parregullsitë në dosjet e tenderit.

Lidhur me **kapacitetin e implementimit**, PRB ka mungesë personeli dhe cilësia e transparencës e vendimeve të tij lë hapësirë për përmirësim. Mospërputhshmëritë në mes të vlerësimeve të shqyrtimit të ekspertëve dhe vendimet aktuale dëmtojnë besimin e palëve të interesit në këtë sistem. Bashkëpunimi në mes të institucioneve të ndryshme në këtë fushë, veçanërisht në mes të prokurimit publik, auditimit dhe organeve të tjera të sundimit të ligjit duhet të rritet.

5.1.7. Ligji për pronësinë intelektuale

Kosova ka **pak nivel përgatitjeje** në këtë fushë. Pak progres është shënuar në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

- zhvillojë një kornizë legjislative për të zbatuar obligimet sipas MSA-së së ardhshme;
- rrisë përpjekjet për të siguruar zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- emërojë drejtorin dhe të adresojë rastet e patrajtuara të aplikimeve në Agjencinë për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale;

Lidhur me **të drejtën autoriale dhe të drejtat e peraferta**, Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura është amendamentuar dhe është përafuar më tej me *acquis*. Ai tani kërkon zbatimin e dispozitave për skemat e kopjeve private dhe piraterinë digjitale, të cilat janë qenësore për zbatim. Task forca kundër piraterisë dhe falsifikimit, e themeluar nga qeveria, ka vazhduar me ngritjen e vetëdijes. Ajo ka kapur disa mijëra mallra të falsifikuara dhe i ka dërguar në gjykatë disa raste penale. Procesi i negocimit të taksave në me stë organizatave për menaxhimin e inkasimit dhe transmetuesve ka rinisur në vitin 2015, mirëpo deri më tash nuk është arritur asnjë marrëveshje.

Për **të drejtat e pronës industriale**, amendamentimet e ligjit për patenta dhe marka tregtare janë miratuar në gusht 2015, që i ka përafuar ato më shumë me *acquis*. Kapaciteti administrativ i Agjencisë së Pronës Industriale është fuqizuar me caktimin dhe trajnimin e një personeli të përhershëm dhe të përkohshëm. Megjithatë, drejtori i agjencisë mbetet të caktohet. Ende ka aplikacione të pazgjidhura të të drejtave të pronës industriale edhe pse është shënuar progres në trajtimin e tyre. Këshilli i pronës Intelektuale është takuar në mars 2015, mirëpo bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe zbatimit të ligjit ende duhet të përmirësohet. Kosova duhet po ashtu të rrisë vetëdijesimin në mesin e mbajtësve dhe shfrytëzuesve të të drejtave të pronës intelektuale.

Lidhur me **zbatimin**, Doganat e Kosovës kanë marrë veprime kundër mallrave që shkelin të drejtat e pronës intelektuale, shumë prej tyre si përgjigje ndaj kërkesave të mbajtësve të të drejtave. Në vitin 2014, numri i përgjithshëm i intervenimeve nga Doganat e Kosovës ka qenë 304, dhe vlera e mallrave të zëna në 4.7 milionë euro; 280 prej këtyre intervenimeve janë bazuar në përgjigjet ndaj kërkesave për veprim nga ana e mbajtësve të të drejtave. Megjithatë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të siguruar zbatimin, përfshirë masat ligjore me mundësi qasjeje dhe efektive që mund të ndërmerren nga mbajtësit e të drejtave dhe bashkëpunimi administrativ më i madh në mes të institucioneve të përfshira. Policia ende nuk ka një njësi të specializuar në të drejtat e pronës intelektuale. Projektligji për masat doganore ende ka mbetur të miratohet dhe të përafrohet me rregulloren përkatëse të BE-së.

5.1.8. Punësimi dhe politikat sociale, politika e shëndetit publik

Kosova është **në një fazë të hershme** të përgatitjes në këtë fushë. **Nuk ka pasur progres** në punësim, në politika sociale dhe shëndetësore. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

→ zbatojë strategjinë për sektorin e punësimit 2014-2020, të monitorojë rezultatet dhe të sigurojë që agjencia e re e punësimit të bëhet funksione;

→ fuqizojë ligjin e punës dhe legjislacionin për shëndet dhe siguri në punë, të implementojë legjislacionin për inspektim dhe të sigurojë për inspektoratin e punës burimet e duhura për të plotësuar mandatin e tij.

Në lidhje me **politikën e punësimit** është përgatitur strategjia e sektorit të punësimit 2014-2020, mirëpo implementimi është prapa, në pritje të aprovimit të planit të veprimit dhe caktimit të fondeve.

Të dhënat nga anketimi i fuqisë punëtore për vitin 2014 tregojnë se papunësia është rritur në 35.5% krahasuar me 30% në vitin 2013. Pjesëmarrja e tregut të punës ka pasur një rritje të lehtë, mirëpo prapëseprapë mbetet shumë e ulët, në 41.6 % (40.5 % në vitin 2013). Pjesëmarrja e fuqisë punëtore dhe shkalla e punësimit për femrat ka mbetur e pandryshuar në mes të vitit 2013 dhe 2014 në rreth 21% dhe 12.5%. papunësia joformale mbetet e lartë. Kjo ka qenë gjithashtu një rritje në numrin e të papunësuarve për një kohë të gjatë, nga 68.9% në vitin 2013 në 73.8% në vitin 2014. Papunësia e të rinjve është rritur nga 55.9% në 61.0%. Hisja e të rinjve (midis 15-24 vjeç), që janë të papunë, as në arsim e as në trajnim,

ka rënë nga 35.3% në vitin 2013 në 30.2% në vitin 2014.

Shërbimi i Punësimit Publik u ka ndihmuar 3% të punëkërkuarve të regjistruar që të gjejnë punë dhe ka organizuar trajnim për 2.5% të punëkërkuarve të regjistruar, prej të cilëve 38% kanë qenë femra. Buxheti i caktuar për tregun e punës aktiv në vitin 2015 është rritur për 224%. Megjithatë, financimi i shërbimeve të punësimit dhe trajnimit dhe ritrajnimit mbetet i pamjaftueshëm dhe i ndarë nëpër entitete të ndryshme. Mungesa e financimit parandalon implementimin e planit të shpallur për shkrirjen e shërbimeve në një agjenci të re punësimi.

Lidhur me **politikën sociale**, Kosova ende ka nevojë të amendamenteve **ligjin e punës** për ta përafëruar atë *acquis* (p.sh. kontratat e punës, orari i punës) dhe implementimi i tij mbetet i pakënaqshëm. Implementimi efektiv i ligjit për **shëndet dhe siguri në punë** është ende i nevojshëm lidhur me inspektorët e punës, për të parandaluar vdekjet dhe lëndimet. Në vitin 2014, janë raportuar 63 aksidente në vendin e punës, prej të cilave nëntë kanë qenë fatale (gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2015, 26 aksidente me pesë fatalitete), mirëpo incidentet nuk janë raportuar gjithmonë. Inspektorati i Punës duhet të synojë pjesën joformale të sektorit të ndërtimitarisë në mënyrë më efektive, numri i inspektorëve duhet të rritet, meqë vetëm 50 prej tyre mbulojnë zbatimin e ligjit të punës dhe atij për shëndet dhe siguri në punë.

Në **dialogun social**, zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësve dhe të punësuarve, është ende në pritje. Amendamentet e ligjit për Këshillin Ekonomik dhe Social, të cilat janë në hartim e sipër, duhet të sigurojnë kriteret dhe procedurat e qarta për përzgjedhjen e anëtarësisë. Këshilli duhet të fuqizojë kapacitetin e tij për të përmirësuar cilësinë e dialogut social. Dialogu social dy-palësh pothuajse nuk ekziston.

Lidhur me **përfshirjen në shërbime sociale**, Kosova duhet të sigurojë që komunat kanë burime të mjaftueshme për të ofruar shërbime sociale nën përgjegjësinë e tyre.

Sa i përket **mbrojtjes sociale**, raundi i parë i licencimit të ofruesve individualë të shërbimeve sociale dhe familjare ka përfunduar dhe faza e dytë e licencimit të entiteteve/organizatave ka filluar. Në vitin 2014, janë aprovuar katër standarde të reja minimale për shërbimet sociale dhe familjare, duke rritur numrin në 16. Megjithatë, decentralizimi i shërbimeve sociale ende nuk është implementuar nga komunat dhe financimi nga buxheti qendror është ende i nevojshëm për të siguruar decentralizimin efektiv. Shtrëngimet buxhetore kanë vonuar paraqitjen e skemës së re të pensioneve.

Për **mundësitë e barabarta**, ligji për barazi gjinore është miratuar, mirëpo implementimi dhe zbatimi i legjislacionit duhet të përmirësohet, në mënyrë që të adresojë papunësinë e lartë në mesin e femrave dhe nën-përfaqësimin e femrave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Dispozitat e pamjaftueshme të pushimit të lehonisë pengojnë përpjekjet për të trajtuar diskriminimin kundër femrave në vendin e punës, veçanërisht në sektorin privat. agjencia për Barazi Gjinore nuk e ka vlerësuar implementimin e programit për barazi gjinore (2008-2013).

Lidhur me **politikën e shëndetit publik**, faza e parë e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh) ka përfunduar dhe ka vazhduar së zbatuari. Megjithatë, shpenzimi i shëndetit publik mbetet në mesin e shpenzimeve më të ulëta në rajon. Kjo pengon zbatimin e reformave dhe politikave të sektorit. Për shembull, plani i veprimit 2014-2020 për implementimin e strategjisë së sektorit të shëndetësisë mbetet të aprovohet, ligji për sigurimin shëndetësor duhet të implementohet, implementimi i SISh duhet të përfundojë për të mundësuar mbledhjen e besueshme të të dhënave shëndetësore, fondi i sigurimit shëndetësor duhet të krijohet dhe plani i veprimit për sëmundjet e rralla 2013-2015 duhet të zbatohet. Pagesat për qëllime personale vazhdojnë të pengojnë qasjen në kujdes shëndetësor për të gjithë, përfshirë grupet e marginalizuara. Vdekshmëria e fëmijëve mbetet në mesin e më të lartave në Evropë. Ligji për shëndetësi duhet të ndryshohet pas miratimit të ligjit për fondin e sigurimit shëndetësor.

Ligji për **kontrollin e duhanit** duhet të fuqizohet. Infrastruktura dhe sistemi raportues për **sëmundjet që përhapen** duhet të zhvillohet më tej. Për **gjakun, indet, qelizat dhe organet**,

ligji për transplantimin e indeve dhe qelizave duhet të zbatohet. Lidhur me **të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, farmaceutik, shëndetin mendor, parandalim të keqpërdorimit me narkotikë, pabarazi shëndetësore dhe ekzaminim të kancerit**, nuk është bërë kurrfarë progresi.

Financimi i pamjaftueshëm për sektorin shëndetësor ende pengon mundësinë e tij për t'i përmbushur nevojat themelore për shëndet amënor dhe të fëmijës, shëndet publik dhe të ushqyer, me rrezik të vonësive tek fëmijët.

5.1.9. Arsimi dhe hulumtimi

Përgatitjet në fushën e arsimit dhe hulumtimit janë në një **fazë të hershme. Nuk është shënuar progres** në këtë fushë vitin e kaluar. Cilësia e arsimit duhet të përmirësohet dukshëm. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti:

→ të përmirësojë cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet dhe të përmirësojë qasjen në arsim cilësor për grupet e marginalizuara, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë, ashkali dhe egjiptas;

→ të sigurojë autonomi dhe funksionim të pavarur të institucioneve të arsimit të lartë dhe të miratojë një ligj të ri për arsimin e lartë bazuar në standardet ndërkombëtare;

→ të fuqizojë kapacitetin e hulumtimit dhe të inovacionit përmes reformës në institucionet e arsimit të lartë dhe të rrisë investimin në hulumtim, si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik.

Në **arsim**, korniza e kurrikules së Kosovës dhe kurrikula thelbësore duhet të zbatohen. Këshilli Kombëtar për Licencimin e Mësimdhënësve ka zhvilluar një sistem profesional për zhvillimin e mësimdhënësve me mekanizma për vlerësimin e performancës, mirëpo vendimi për të rritur pagat për të gjithë mësimdhënësit nuk është në përputhje me parimin e reformës, e aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe kjo dëmton qasjen e bazuar në performancë në politikën e mësimdhënësve. Në prill 2014, Kosova ka marrë pjesë në Programin për Vlerësim Ndërkombëtar të Studentëve (PISA) për herë të parë dhe rezultatet do të publikohen në dhjetor 2016. Sipas të dhënave nga qeveria, shpenzimi i përgjithshëm publik në arsim është 4.4% e BPV-së.

Shkalla e regjistrimit në shkollë është e krahasueshme me vendet e rajonit, me përjashtim të qasjes në arsim parashkollor ose në arsim të fëmijërisë së hershme. Vetëm 4.5% e fëmijëve ndjekin arsimin parashkollor (të moshës 0-5). 74% të fëmijëve të moshës 5-6 ndjekin arsimin parafillor.

Qeveria ka vazhduar veprimet që të parandalojë braktisjen e hershme të shkollës, ne veçanti për fëmijët nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptas. Megjithatë, implementimi i legjislacionit për kundërpërgjigje ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes së hershme të shkollës duhet të përmirësohet më tej. Kosova ka vazhduar të punojë në sigurimin e qasjes për arsim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, mirëpo shkalla e tanishme e trajnimit nuk është e mjaftueshme për të përmbushur objektivin e arritjes të të gjithë mësimdhënësit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Sistemi aktual i Arsimit dhe Trajnimit Profesional (VET) nuk është i akorduar me nevojat e tregut të punës. Disa programe të VET kanë standarde që kërkohen për të marrë akreditimin nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Rrjeti i shkollave VET duhet të racionalizohet dhe përgatitja e VET duhet të shikohet sërish.

Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë është prekur nga mungesa e një plani të qatë strategjik, i cili do të duhej për të shmangur dyfishimin dhe për të siguruar vlerën e shtuar të programeve studimore. Funksionimi i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë nuk është transparent, veçanërisht sa i përket procedurave të rekrutimit, të cilat janë të dobëta dhe shumë të

ndjeshme ndaj politizimit në të gjitha nivelet dhe sektorët e arsimit. Sektori i arsimit mbetet një fushë me rrezikshmëri të lartë për korrupsion.

Edhe pse Agjencia Kosovare për Akreditim është bërë anëtare e plotë e Rrjetit Evropian për Siguri të Cilësisë në Arsimin e Lartë, reputacioni i saj është zbehur dukshëm si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës pas arrestimit të anëtarëve kryesore të menaxhmentit të lartë për dyshime për korrupsion.

Vështirësitë në implementimin e marrëveshjes për diplomat e arsimit të lartë në dialogun Prishtinë-Beograd duhet të tejkalohen për implementim të plotë në vitin 2016.

Kosova vazhdon të merr pjesë në programin Erasmus+ për bashkëpunim në arsimin e lartë dhe në sektorët e të rinjve. Bashkëpunimi është i rëndësishëm për të ndihmuar rritjen e kompetencave dhe kualifikimeve të personeli dhe studentët, si dhe për punësimin e të rinjve.

Kosova ka ndërmarrë veprime të kufizuara për zhvillimin e kapacitetit të saj **hulumtues dhe inovativ**. Kapaciteti i universiteteve të Kosovës për të bërë punë kërkimore është jashtëzakonisht i kufizuar, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e programeve pas-diplomike dhe në inovacion. Buxheti për hulumtim mbetet i pamjaftueshëm, meqë niveli i investimeve në hulumtim është ende nën 0.2% të BPV-së. Ligji për aktivitete kërkimore shkencore nuk po zbatohet për shkak të mungesës së financimit. Lidhja në mes të hulumtimit dhe biznesit mbetet e dobët. Kosova merr pjesë në programin e BE-së për hulumtim dhe inovacion “Horizon 2020” mirëpo numri i projekteve është vlerësuar në mënyrë të suksesshme dhe financimi i pranuar është shumë i vogël.

5.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)

Përgatitjet e Kosovës mbeten në **një fazë të hershme** dhe në këtë fushë **nuk është shënuar progres**.

Kosova nuk është anëtare e OBT-së dhe nuk ka ndërmarrë as hapa zyrtarë për t’iu bashkuar.

5.2. Politikat sektoriale

5.2.1. Industria dhe NVM-të

Kosova ka **pak nivel përgatitjeje** në industri dhe në NVM. **Pak progres** është shënuar në këtë fushë. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

→ ndjekë rekomandimet e vlerësimit “Akti i Bizneseve të Vogla”;

→ paraqesë vlerësimet për ndikimin e rregullatorit për zvogëlimin e barrës administrative të NVM-të.

Sa i përket **politikës industriale dhe NVM-ve**, zbatimi i strategjisë së Kosovës për zhvillimin e sektorit privat 2013-2017 dhe “Akti i Bizneseve të Vogla” i BE-së po avancojnë ngadalë. Komunikimi në mes të ministrive dhe agjencive ekzekutive duhet të përmirësohet. Për të zvogëluar barrën administrative në NVM, qeveria duhet të paraqesë vlerësimet e ndikimit rregullativ. Strategjitë dhe planet e verimit në këtë fushë duhet të zbatohen me kohë dhe të monitorohen. Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve dhe Investimeve në Kosovë është funksionale, mirëpo ende nuk e ka personelin e plotë, prandaj edhe ndikimi i saj është ende i kufizuar. Edhe pse regjistrimi i plotë i kompanive online nuk është paraqitur ende, procesi për regjistrimin e bizneseve dhe kompanive individuale është i shpejtë (1-3 ditë). Megjithatë, pengesat kryesore në zhvillimin e NVM-ve dhe në rritjen e mëtejshme ekonomike janë qasja në financa, zbatimi i dobët ligjor i kontratave dhe rregulloreve afariste, barrierat administrative, konkurrenca jo e drejtë nga sektori joformal, gjyqësori joefikas dhe korrupsioni.

5.2.2. Bujqësia dhe peshkataria

Kosova ka **pak nivel të përgatitjes** në bujqësi dhe zhvillim rural dhe në siguri të ushqimit, veterinarit dhe politikë fitosanitare. Pak përparim është bërë përmes fuqizimit të mëtejshëm të institucioneve përgjegjëse dhe rritjes së buxhetit. Vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti të:

- përmirësojë konsolidimin e tokave;
- bartë përgjegjësitë e inspektimit te Agjencia për Veterinari dhe Ushqim e Kosovës;
- themelojë një njësi auditimi të brendshëm në Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë.

Lidhur me **politikën bujqësore dhe të zhvillimit rural**, qeveria ka vazhduar ë rrisë shpenzimin në bujqësi. Vëllimi i pagesave direkte është dyfishuar krahasuar me vitin 2014 dhe tani qëndron në 23 milionë euro. Ngjashëm, shuma e caktuar për grante të investimeve bujqësore qëndron në 20 milionë euro. Megjithatë, ka mungesë të personelit të mjaftueshëm për të siguruar monitorimin e duhur dhe pagesën e shpejtë. Nuk është themeluar njësi e Auditimit të Brendshëm të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë nuk është themeluar.

Duhet përpjekje të mëtejshme në trajtimin e ndryshimeve ilegale të shfrytëzimit të tokave bujqësore, e cila vazhdon të jetë një pengesë në zbatimin e ligjit për planifikimin hapësinor. Nuk është bërë mjaft në zbatimin e konsolidimit të tokave për të arsyetuar zotërimet e tokave, për të themeluar një treg transparent në vend dhe për të fuqizuar sanksionet.

Të dhënat e besueshme bujqësore janë një kërkesë themelore për vendime të mira politikash. Ende ka mospërputhshmëri në mes të statistikave të Eurostatit dhe atyre kombëtare. Regjistrimi i parë bujqësor ka përfunduar në vitin 2015.

Implementimi i ligjit për prodhimin organik është i dobët, dhe themelimi i një autoriteti mbikëqyrës funksional dhe i një komisioni për prodhimin organik është ende në pritje. Kosovës i mungojnë standardet minimale dhe masat e pajtimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë së ushqimit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe mjedisit. Vëllimi i prerjeve ilegale është shumë i madh për një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve.

Lidhur me sektorin e **sigurisë së ushqimit dhe veterinarisë**, është shënuar progres në sigurimin e bashkëfinancimit dhe një vendi për një fabrikë riprodhimi për përpunimin dhe sistemimin e nënprodukteve të kafshëve. Megjithatë, ende nuk është finalizuar një pako ligjesh (ligji për ushqim, ligji për veterinar, ligji për inspektim sanitar dhe ligji për bagëti). Plani vjetor i inspektimit është aprovuar, mirëpo plani shumëvjeçar i inspektimit për sëmundjet e kafshëve nuk është më i vlefshëm.

Përgjegjësia për inspektim, gjë që është dashur të ndodhë më 1 janar 2015 (tashmë tre vjet vonesë), ende nuk është bartur nga komunat te Agjencia për Veterinari dhe Ushqim e Kosovës. Ka pasur zhvillime në përmirësimin dhe sistematizimin e menaxhimit të të dhënave për identifikimin, lëvizjen dhe regjistrimin e kafshëve.

Tregtia ilegale, veçanërisht e lidhur me kafshët nga Serbia, vazhdon të jetë një problem. Procesi i përmirësimit të objekteve për përpunimin e ushqimit sipas standardeve të BE-së duhet të vazhdojë.

Në **sektorin fitosanitar**, edhe pse ligji për mbrojtjen e bimëve është amendamentuar, programi për mbikëqyrjen e sëmundjeve të bimëve ende nuk është krijuar. Nevojiten përditësime të mëtejshme të listës së bimëve dhe produkteve bimore.

5.2.3. Mjedi dhe ndryshimet klimatike

Kosova mbetet në **një fazë të hershme** të harmonizimit me *acquis*. **Nuk ka pasur progres** në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, prandaj vitin e ardhshëm Kosova duhet në veçanti të:

- krijojë një rrjet për monitorim mjedisor për ajrin dhe ujin;
- bëjë planifikimin strategjik sistematik për veprimin klimatik.

Legjislacioni që adreson sfidat mjedisore në rritje në Kosovë ende nuk është harmonizuar plotësisht me *acquis* ose nuk është zbatuar. Në lidhje me **legjislacionin horizontal**, vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe vlerësimet mjedisore strategjike duhet të zbatohen më mirë, veçanërisht në vend. Duhet të fuqizohet pjesëmarrja publike dhe konsultimi.

Sistemi për monitorimin e **cilësisë së ajrit** është i pajisur mirë, mirëpo prapëseprapë ai nuk është plotësisht funksional. Edhe pse ka laboratorë analitikë të avancuar, mungesa e mirëmbajtjes së rregullt dhe e kalibrimit të pajisjeve monitoruese rrezikon saktësinë e monitorimit. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave bëhet në mënyrë manuale, pa sistem automatik për të informuar publikun në kohë reale. Përveç kësaj, raportet e Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit për cilësinë e ajrit nuk përmbajnë inventar të ndotësve të ajrit dhe ndotja nga burimet kryesore nuk matet si duhet (në veçanti nga termocentrali Kosova A). Nevojiten plane për cilësinë e ajrit në aglomeratet më të mëdha urbane.

Sa i përket **menaxhimit të mbeturinave**, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të bëjë përpjekje për të finalizuar një plan për menaxhimin e mbeturinave dhe për të rritur mundësitë për investim në këtë sektor. Definicionet dhe konceptet bazike për menaxhimin e mbeturinave, si riciklimi dhe rimëkëmbja e rrjedhave të ndryshme të mbeturinave, nuk mbështeten mjaftueshëm nga legjislacioni aktual duke kufizuar kështu mundësitë për përfshirjen e sektorit privat. Si financimi i investimit ashtu edhe kapaciteti i komunave dhe operatorëve për të zbatuar ligjin për mbeturina 2012 mbeten shumë të ulëta. Numri i lartë i vendeve ilegale për hedhjen e mbeturinave është një çështje që duhet adresuar urgjentisht.

Për **menaxhimin e ujit**, është krijuar një këshill ndër-ministral për ujë, i kryesuar nga Kryeministri, më fillim të vitit 2015. Kosovës i mungon një strategji e politikave të ujit, një plan dhe strategji investimi dhe një strategji për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat. Nuk është shënuar progres në themelimin e autoriteteve për basenet e lumenjve ose një autoritet të pavarur për menaxhimin e ujit. Sistemi për regjistrimin dhe monitorimin e burimeve të ujit mbetet i papërfunduar për ujin nëntokësor, sipërfaqësor, të pijes dhe për larje. Mirëmbajtja ose vjedhja dhe vandalizmi i pajisjeve matëse është një çështje. Monitorimi i cilësisë së ujit të pijes është përmirësuar, mirëpo nevojiten masa të mëtejshme për kontrollin e cilësisë, në përputhshmëri me standardet e BE-së. Një sistem për kontrollimin e cilësisë së ujit në shishe nuk është krijuar ende. Në infrastrukturë, nevoja për investim, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit, është e madhe (rrjedhjet janë vlerësuar të jenë në 75% të ujit të gypave). Rekomandimet nga një studim i sigurisë së pendës nuk është zbatuar ende. Si rezultat i paraqitjes së kontrollimeve, mbledhja e të hyrave është përmirësuar edhe pse ende është e ulët. Thatësia së fundi ka nënvizuar nevojën urgjente për zvogëlimin e furnizimi të ujit falas dhe nevojën për të zhvilluar burime alternative të ujit. Ujësjiellësit rajonalë duhet të përmirësojnë menaxhimin e burimeve të ujit dhe të përgatisin planet për menaxhimin e thatësisë.

Në **mbrojtjen e natyrës**, ka pasur shumë pak përparim në zbatimin e *acquis*. Plani menaxhues për parkun "Sharri" është përgatitur, mirëpo masat për luftimin e aktiviteteve ndërtimore ilegale në këtë park kanë ngecur. Ka shumë pak përparim në themelimin e rrjetit të zonave të mbrojtura "Natura 2000". Institucionet në këtë fushë mbesin të dobëta çdo zhvillim i mëtejshëm i hidroenergjisë duhet të bëhet në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së.

Lidhur me **ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut**, janë lëshuar dy leje të integruara, derisa nga gjithsej 30 operatorë që janë në kuadër të Direktivës për emetimet industriale, tri aplikacione janë në shqyrtim e sipër.

Nuk ka pasur progres në **mbrojtjen civile** (vërshimet, zjarret në pyje dhe katastrofat e tjera mjedisore).

Një draft strategji kornizë për **ndryshimet klimatik**, e përbërë prej një strategjie zhvillimore për emetimin e ulët dhe një strategjie për adaptim, ka mbetur të aprovohet. Ajo duhet të jetë në përputhshmëri me kornizën e BE-së 2030. Po ashtu kërkohen përpjekje për të integruar veprimin klimatik në të gjitha politikat dhe strategjitë përkatëse të sektorit. Kosova është në një fazë të hershme të zhvendosjes dhe implementimit të *acquis* për klimë. Edhe pse ka pasur përparim në përgatiten e një raporti të inventarizimit të gazrave serë në mbarë vendin në 2013, kërkohen përpjekje të mëdha në përafrimin e Kosovës me rregulloren e mekanizmit monitorues të BE-së dhe në sigurimin që të rritet kapaciteti i Kosovës. Aktet nënligjore për substancat që shterojnë shtresën e ozonit, për gazrat serë të flourinuara dhe për informimin e konsumatorëve dhe emetimet e CO₂ nga automjetet e reja, është miratuar, mirëpo nuk është zbatuar asnjë masë praktike. Një vendim ad hoc i marrë nga qeveria për të mundësuar importimi e automjeteve të përdorura (mbi 10 vjet të vjetra) do të jetë ndikim negativ në emetimet e dioksidit të karbonit dhe cilësisë së ajrit. **Kapaciteti administrativ** në sektorin mjedisor dhe atë klimatik mbetet i dobët. Qeveria ka aprovuar një vendim për themelimin e Këshillit kombëtar për Ndryshimin Klimatik në gusht 2015. Nevojitet bashkëpunim ndërministror i mëtutjeshëm, efektiv, për të mundësuar miratimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore të karbonit të ulët. Duhet edhe përpjekje të konsiderueshme për rritjen e vetëdijesimit në çështjet mjedisore.

5.2.4. Politika e transportit

Kosova është **në fazë të hershme** të përgatitjes në politikën e transportit. **Pak progres** është shënuar me aprovimin e strategjisë multimodale për sektorin e transportit 2015-2025. Vitin e ardhshëm Kosova duhet në veçanti:

- të fuqizojë institucionet rregullatorë dhe të sigurojë pavarësinë e tyre;
- të vazhdojë reformat në sektorin hekurudhor;
- të rrisë përpjekjet për të përmirësuar sigurinë në rrugë

Kosova është pajtuar me një listë prioritetesh prej “masash të buta” në transport, e cila u prezantua në samitin e Vjenës së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ajo do të sigurojë që ato të gjitha do të implementohen para takimit të radhës të Samitit të ËB6 në qershor 2016. Në **rrjetet trans-evropiane të transportit**, Kosova ka vazhdua të marrë pjesë në Observatorin e Transportit të Evropës Jug-Lindore (SEETO). Kosova ka luajtur një rol aktiv në agjendën e lidhjes së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes nënshkrimit të marrëveshjes në rrjetin thelbësor rajonal të transportit, në muajin prill në Bruksel, pastaj marrëveshjes në Riga në muajin qershor për korridoret e rrjetit thelbësor dhe me listën e projekteve që do të zbatohen deri në vitin 2020, në samitin e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor në Vjenë dhe me themelimin e Këshillit Kombëtar për Investim.

Lidhur me **transportin rrugor**, strategjia dhe plani i veprimit për sigurinë e trafikut rrugor është aprovuar në shtator 2015. Megjithatë, ligji për sigurinë e trafikut rrugor mbetet të aprovohet. Kosova ende nuk ka përafruar legjislacionin e saj me *acquis* për qasjen në treg, profesionin e operatorëve të transportit rrugor dhe takografëve digjitalë. Buxheti për mirëmbajtjen e autostradave është është i pamjaftueshëm për të siguruar mirëmbajtje të rregullt.

Sa i përket **transportit hekurudhor**, Autoriteti Rregullativ Hekurudhor është funksional, mirëpo nuk është shënuar përparim në fuqizimin e kapaciteteve të tij.

Pavarësia e rregullatorit duhet të sigurohet lidhur me procesin e licencimit dhe rregullimin e tregut. Nuk ka hyrë asnjë operator i ri në tregun e transportit hekurudhor gjatë periudhës raportuese. Vendimi i rregullatorit për të tërhequr licencën që i ishte lëshuar më mars 2014 një operatori privat është konsideruar e paligjshme nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Organi për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve hekurudhore dhe aviacion ajror nuk është funksional. Përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore është në një fazë të hershme të zbatimit.

Sa i përket **transporti ajror**, inkorporimi i kërkesave të fazës së parë për marrëveshjen Evropiane të Zonës së Përbashkët të Aviacionit në legjislacionin vendor është afër përfundimit, dhe vetëm në pritje të përputhshmërisë së ligjit të punës me *acquis* sa i përket orarit të punës. Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ende nuk është pjesë e programit për Vlerësimin e Sigurisë së Aeroplanëve të Huaj, megjë që nga shtatori 2013 nuk është emëruar asnjë anëtar i bordit. Nuk ka pasur përparim në zbatimin e ligjit për agjencinë për shërbimet e navigacionit ajror. Zbatimi i legjislacionit duhet të adaptohet më tej për të siguruar shërbime profesionale të navigacionit ajror dhe të sigurisë. Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror nuk i plotëson kriteret financiare dhe të sigurisë që kërkohen për certifikim.

Lidhur me transportin **intermodal**, strategjia e sektorit të transportit multimodal 2015-2025 dhe plani i saj i veprimit 5 vjeçar janë aprovuar nga qeveria në tetor 2015.

5.2.5. Energjia

Kosova mbetet në një **fazë të hershme** të harmonizimit të legjislacionit me *acquis*, mirëpo ka pasur **pak progres** në fushën e energjisë. Gjatë vitit të ardhshëm, Kosova duhet që në veçanti:

- të fillojë me zbatimin e *acquis* për sigurimin e furnizimit dhe të marrë vendim përfundimtar për sa i përket kapacitetit të ri të gjenerimit dhe dekomisionimit të termocentralit Kosova A;
- të vazhdojë të fuqizojë kapacitetin institucional për tregun e energjisë, në veçanti duke ruajtur pavarësinë e rregullatorit, caktimin e plotë të bordit, duke siguruar stabilitetin e tij financiar dhe krijimin e mekanizmave transparente për rregullimin e çmimeve të energjisë.
- të fuqizojë kapacitetin e Agjencisë për Siguri Bërthamore dhe Mbrojtje nga Rrezatimi, dhe identifikimi i një objekti për mbajtjen e mbetjeve radioaktive.

Sektori i energjisë vazhdon të përballë me probleme, edhe pse është shënuar pak progres. Stabiliteti i energjisë elektrike është përmirësuar dhe ndërprerjet tani janë më të rralla, edhe pse situata u përkeqësua për shkak të eksplodimit të vitit të kaluar në laboratorin e hidrogjenit në termocentralin Kosova A. Këto blloqe që ishin dëmtuar rëndë nga eksplodimi tani janë në operim.

Sa i përket **sigurisë së furnizimit**, investimet dhe mirëmbajtja vazhdojnë të përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të transicionit të energjisë dhe të zvogëlojnë humbjet në transicion. Përdorimi i humbjet në shpërndarje janë ulur, humbjet komerciale dhe teknike të kombinuara janë të larta prej 28.46 %. Ende nuk janë miratuar dy ligje që rregullojnë sektorin e karburanteve, duke përfshirë edhe rezervat e detyrueshme të naftës. Rezervat aktuale të naftës vlerësohet të korrespondojnë me vetëm katër ditë të konsumit. Nuk ka përparim në procedurën

për zgjidhjen e kontestit të Komunitetit të Energjisë lidhur me taksat doganore për importet e produkteve të naftës.

Përderisa ka pasur përparim thelbësor me Serbinë për sa i përket marrëdhënieve në mes të kompanive të transmisionit, është bërë pak përparim, deri në marrëveshjen e gushtit 2015, për pjesët e marrëveshjes së vitit 2013 që mundësojnë themelimin e një kompanie serbe për furnizim me energji në veri. Menaxhmenti paralel që është instaluar nga Serbia në hidrocentralin e Ujmanit vazhdon që të ndërhyjë në operimin e saj, duke rrezikuar vërshime.

Sa i përket **tregut të brendshëm të energjisë**, ende nuk është bërë ri-aranzhimi i pakos së tretë energjetike. Negociatat me ofertuesin e vetëm për ndërtimin e një termocentrali të ri me thëngjill janë duke vazhduar dhe duhet të bëhet vlerësimi i ofertës. Asnjë përparim nuk është bërë rreth dekomisionimit të Kosovës A apo rinovimit të Kosovës B. Kosova ka shumë pak gjasa që të përmbushë obligimet e veta për cilësinë e ajrit që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe nuk ka përgatitur planin e nevojshëm të emetimit.

Nuk ka pasur përparim as sa i përket ndarjes së llogarive apo ndalimit të ndër-subvencioneve në mes të kategorive të ndryshme të konsumatorëve. Në muajin janar, kompania elektro-energjetike, Kompania Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji (KEDS) dhe furnizuesi publik, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji (KESCO) janë shthurur në aspektin ligjor. Nuk është bërë progres në hapjen e tregut dhe kalimin e konsumatorëve, obligim ligjor si anëtar i Komunitetit të Energjisë nga janari i vitit 2015. Operimi dhe pavarësia e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) që sa kohë është dobësuar për shkak të ndërhyrjeve politike, kapacitetit të ulët administrativ, mungesës së burimeve njerëzore dhe shkurtimit buxhetor prej 17%. Bordi i ZRRë-së i ka vetëm dy prej pesë anëtarëve, që nënkupton se ligjërisht nuk mund të marrë shumë prej përgjegjësi të veta. Qeveria ende nuk ka projektuar një mekanizëm për të mbështetur konsumatorët e cenueshëm.

Korniza ekzistuese e politikave për **energji të ripërtërishme**, procedurat e autorizimit dhe licencimit mbeten akoma të japin rezultate ose madje t'i ofrohen afër objektivit të Kosovës për energji të ripërtërishme prej 25% deri në vitin 2020. Kosova ende nuk është në përputhshmëri me direktivën e vitit 2009 për energjinë e ripërtërishme dhe nuk ka ndonjë mekanizëm për monitorimin e progresit në arritjen e objektivat e vitit 2020. Çdo zhvillim i mëtejshëm i hidrocentraleve duhet të respektojë legjislacionin e BE-së për mjedisin. Nuk ka pasur progres në përmbushjen e kërkesave për shfrytëzimin e bio-karburanteve për transport.

Ligji për **efiçencën e energjisë** nuk është harmonizuar me *acquis*. Direktiva për performancën e energjisë në ndërtesa nuk është duke u zbatuar. Kosova ende nuk e ka krijuar fondin e vet për efiçencë të energjisë. Projekti i kombinuar për ngrohje dhe energji elektrike në termocentralin Kosova B ka filluar të funksionojë në muajin nëntor, që ka rezultuar me kosto më të ulëta për familjarët, zvogëlim të ndotjes së mjedisit dhe furnizim më të sigurt për banorët e Prishtinës. Agjencia Kosovare për Efiçencë të Energjisë nuk ka personel të mjaftueshëm dhe nuk ka kapacitet që të monitorojë, vlerësojë dhe verifikojë progresin e bërë drejtë objektivave. Nuk ka pasur progres në planifikimin komunal të efiçencës së energjisë, mirëpo duhet të forcohet kapaciteti lokal.

Sa i përket **sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi**, ligji për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues ende nuk është miratuar. Personeli i agjencisë

rregullative është rritur por licencimi i saj dhe kapacitetet e inspektimit mbeten të ulëta. Financimi për agjencinë është i pamjaftueshëm që të zbatojë mandatin e vet, posaçërisht licencimi, shëndeti dhe aspektet e sigurisë. Nuk ka ndonjë monitorim të rrezatimit (për shembull të vendeve potenciale me uranium të varfëruar). Nuk ka kontroll të mbetjeve radioaktive dhe plan emergjent radiologjik. Kosova duhet të identifikojë një objekt të përkohshëm për mbajtjen e mbetjeve radioaktive derisa puna vazhdon në gjetjen e një vendi të përhershëm.

5.2.6. Shoqëria Informative dhe media

Kosova e ka **një nivel të përgatitjes** në këtë fushë. Është arritur **pak progres**, në veçanti sa i përket komunikimit elektronik dhe teknologjive informative dhe të komunikimit. Megjithatë, Kosova duhet t'i vazhdojë përpjekjet për përfundimin e kornizës ligjore. Gjatë vitit të ardhshëm Kosova në veçanti duhet të:

→ sigurojë kapacitete, burime dhe pavarësi të përshtatshme të telekomeve dhe rregullatorëve të medieve;

→ implementojë, si çështje me urgjencë, kalimin digjital dhe gjetjen e një zgjidhjeje për financim të qëndrueshëm të transmetuesit publik.

Sa i përket **komunikimeve elektronike dhe teknologjive informative dhe të komunikimit**, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) e ka përfunduar legjislacionin sekondar bazuar në ligjin 2012 për komunikimet elektronike në Kosovë. Kosova ka vazhduar përpjekjet për të shfrytëzuar kapacitetin e tepërt infrastrukturor të operatorëve të shërbimit publik (hekurudhat, energjia dhe infrastruktura rrugore) për komunikime elektronike. Tre operatorët e telefonisë mobile kanë lëshuar shërbimet 4G në dhjetor të vitit 2014. Shtrirja e telefonisë mobile ka arritur në 95 % të shfrytëzuesve aktivë. Shtrirja e përgjithshme e internetit është rritur nga 9.18 % në vitin 2013 në 10.51 % në vitin 2014.

ARKEP-i nuk ka shënuar ndonjë përmirësim sa i përket pavarësisë financiare dhe organizative. Këtë vit rregullatori ka qitur në ankand brezin e ri frekuencor për shfrytëzimin e operatorëve të telekomunikacionit. Është në fazën përfundimtare të shqyrtimit të ofertave. Ekipi kombëtar për reagim emergjent me kompjuter, i themeluar në vitin 2014, ende ka mungesë të personelit të trajnuar.

Në fund të gushtit të vitit 2015, Kosova dhe Serbia u pajtuan për Planin e Veprimit për zbatim të marrëveshjeve të Brukselit të vitit 2013 për telekomin, duke përfshirë aranzhimet për ndarjen e prefiksit 3 shifror për Kosovën nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU).

Sa i përket **shërbimeve të shoqërisë informative**, Kosova ka miratuar strategjinë e re të TI-së. Agjencia për Shoqëri Informative tani është plotësisht funksionale dhe shërben si subjekt qendror qeveritar për shërbime që kanë të bëjnë me e-qeverisjen dhe infrastrukturën.

Sa i përket **politikës audiovizuale**, Kosova ka dështuar që të arrijë afatin kohorë të dakorduar për qershor të vitit 2015 për kalim digjital, për të cilin ligji ishte miratuar tek në muajin korrik. Komisioni i pavarur për Media është vonuar në miratimin e strategjisë për digjitalizim gjë që i lë shumë çështje të rëndësishme të papërcaktuara. Rrjedhimisht, do të shtyhet edhe përgatitja e legjislacionit të nevojshëm të implementimit. Përgatitjet teknike ende janë në një fazë të hershme. Kosova duhet të sigurojë që procesi i kalimit në transmetim digjital të kryhet me transparencë të plotë.

Pasi që Kosova nuk është anëtare e ITU-së, frekuencat e saj janë nën autoritetin e Serbisë. Transmetuesi publik, RTK-ja, mbetet e varur nga financimi shtetëror nga buxheti i Kosovës, i cili dëmton pavarësinë redaktuese. Në vitin 2014, sindikata e transmetuesit publik organizoi një varg protestash duke akuzuar menaxhmentin për nepotizëm, korrupsion dhe anshmëri në dobi të një partie politike. Menaxhmenti i RTK-së ishte përgjigjur duke larguar nga puna dy udhëheqësit e sindikatës, të cilët ishin kthyer përmes një vendimi të Inspektoratit të Punës. Kosova ka dështuar që të përmbushë obligimin e saj ligjor për të siguruar pavarësinë financiare të RTK-së në kuadër të afatit të kërkuar kohor.

5.2.7. Kontrolli financiar

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në këtë fushë. Vitin e kaluar është shënuar **pak progres**, posaçërisht me miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit për kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP) dhe në lidhje me auditimin e jashtëm. Megjithatë, mungesa e implementimit sistematik për llogaridhënie menaxhuese dhe delegim të përgjegjësive brenda organizatave e pengon zhvillimin e mëtutjeshëm të KBFP-së. Nevojiten përpjekje të rëndësishme për implementimin e KBFP-së në të gjitha nivelet e administratës dhe në ndërmarrjet publike. Përveç adresimit të mangësive të cekura më poshtë, gjatë vitit të ardhshëm Kosova në veçanti duhet të:

→ fillojë implementimin e aktiviteteve të përcaktuara në strategjinë KBFP 2015-2017 dhe të miratojë legjislacionin e rishikuar të implementimit për KBFP-në;

→ sigurojë përcjellje sistematike të të gjeturave dhe rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Qeveria miratoi **strategjinë dhe planin e veprimit** të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitet 2015-2019 në prill të vitit 2015. Strategjia mundëson krijimin e Këshillit të KBFP-së që të monitorojë dhe raportojë çdo vit për implementimin strategjisë.

Njësia Qendrore e Harmonizimit (NjQH) është duke kryer detyrat e veta siç parashihen me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ajo duhet të përforcojë kapacitetin për trajnim dhe ndërtim të kapaciteteve për personelin ekzistues 13 anëtarësh. NjQH-ja i dorëzon qeverisë raportin vjetor rreth progresit të futjes së KBFP-së, duke u bazuar në përgjigjet e pyetësorëve për vetë-vlerësim, që gjithashtu shqyrtohet nga Komisioni parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike. Megjithatë, kjo nuk përcillet me konstatime apo rekomandime, as nga qeveria e as nga Kuvendi.

Korniza ligjore që e rregullon **menaxhimin dhe kontrollin financiar** në masë të madhe është në përputhshmëri me modelin e Kornizës së Kontrollit të Brendshëm të Komisionit për Sponsorizimin e Organizatave (COSO) dhe udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Parashihen ndryshime të mëtutjeshme në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive si dhe në legjislacionin për implementimin e saj. Përgjegjësia menaxhuese dhe delegimi i përgjegjësive brenda organizatave nuk është as i rregulluar si duhet e as nuk implementohet në mënyrë koherente. Menaxhimi i riskut është keqkuptuar si një ushtrim i përputhshmërisë se sa si një mjet menaxhues dhe aplikohet rrallë. As zotimet financiare e as burimet financiare nuk mbahen sistematikisht në kuadër të buxhetit. Funkzioni i **inspektimit të centralizuar të**

buxhetit ende ka nevojë që të rregullohet në përputhshmëri me kërkesat e KBFP-së.

Ligji për **auditimin e brendshëm** është pjesërisht në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm. 85 (prej 96) organizata të cilave u kërkohet me ligj që të përcaktojnë funksionin e auditimit të brendshëm e kanë bërë një gjë të tillë. Ekziston skema kombëtare për certifikimin e auditorëve të brendshëm. Të gjithë auditorët i janë nënshtruar trajnimit për certifikim ndërkombëtar dhe 67 (prej 149) prej tyre janë certifikuar përmes përkrahjes financiare të BE-së. Në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria, Kosova duhet të ndajë fonde të mjaftueshme për certifikim dhe trajnime profesionale të vazhdueshme. Të gjitha institucionet që kanë funksion të auditimit e kanë statutin e auditimit dhe kryejnë auditimet sipas planeve strategjike dhe vjetore të auditimit. Sidoqoftë, implementimi i të gjeturave dhe rekomandimeve të auditimit ndryshon varësisht nga shkathësitë e auditorëve dhe menaxhmentit të tyre.

Auditimi i jashtëm

Sa i përket **kornizës kushtetuese dhe ligjore**, roli i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) njihet me Kushtetutë. Ligji i ri për ZKA-në është duke u përpiluar i cili do të përcaktojë më qartë pavarësinë funksionale, operative dhe financiare të Auditorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me standardet e INTOSAI-t.

Sa i përket **kapacitetit institucional**, ZKA-ja udhëhiqet nga ushtruesi i detyrës së Auditorit të Përgjithshëm prej nëntorit të vitit 2014. Kandidati i përzgjedhur nga Presidentja nuk ishte miratuar në Kuvend, ndërsa Presidentja ende nuk e ka rifilluar procesin. Zyra e ZKA-së e ka personelin e plotë me 146 pozita, prej të cilave 120 janë pozita të auditimit. Trajnimi ofrohet në mënyrë sistematike, si në vend të punës ashtu edhe jashtë saj. Ekziston programi i certifikimit për auditim të rregullt dhe zbatohet sipas standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI).

Gjatë vitit të kaluar, ZKA-ja e ka përmirësuar **cilësinë e punës së auditimit** përmes përshtatjes së doracakut të auditimit financiar që është në përputhshmëri me standardet INTOSAI. Ekziston korniza për menaxhimin e cilësisë. Departamenti i posaçëm për përkrahje të auditimit me gjashtë anëtarë të personelit e bënë vlerësimin e cilësisë përveç kontrollit të cilësisë, që është pjesë e proceseve të auditimit.

Ndikimi i punës së auditimit duhet të përmirësohet tutje. Raporti vjetor i aktivitetit diskutohet në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike, porse nuk ka vazhdimësi parlamentare sistematike të raportit të auditimit. ZKA-ja i bënë publike online të gjitha raportet e saja dhe i informon mediet në mënyrë proaktive lidhur me raportet e rëndësishme.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Për sa i përket **harmonizimit me *acquis***, mbrojtja e interesave financiare të BE-së mbetet e dobët. Në bazë të Kodit penal të Kosovës, mashtrimi i ndërlidhur me financimin e BE-së paraqet një krim. Ministria e Financave është përgjegjëse për të mbështetur aktivitetet kundër mashtrimit dhe kundër korrupsionit në institucionet e administratës publike dhe ngritjen e ndërgjegjësimit për mashtrimin në përgjithësi. Ekziston rregullorja e posaçme e cila i përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e ministrive në këtë drejtim.

Kosova ende nuk ka **shërbim të koordinimit kundër mashtrimit** (AFCOS) apo rrjet të AFCOS-it. Nuk është zhvilluar sistem i raportimit apo vegla për vlerësimin e riskut. Dokumentet e politikave, siç janë strategjia apo plani i veprimtari për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së mbeten për tu zhvilluar.

Përkitazi me **bashkëpunimin me Komisionin Evropian**, Kosova ka ndërmarrë hapa fillestar që të bashkëpunojë me hetuesit e Komisionit gjatë misionëve të tyre në vend vitin e kaluar. Ende nuk ekzistojnë procedura themelore të përcaktuara qartë për raportimin e parregullsive dhe rastet e supozuara të mashtrimit dhe duhet të krijohet sistemi për menaxhimin e parregullsive.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Lidhur me **harmonizimin me *acquis***, legjislacioni i krijon autoritetet kompetente dhe procedurat për trajtimin e falsifikimit të parasë. Medaljet dhe simbolet e ngjashëm me monedhat e euros ende nuk janë rregulluar. **Analiza teknike** e falsifikimit të parasë, përfshirë kartëmonedhat dhe monedhat e euros, kryesisht kryhet nga agjencia mjekoligjore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Banka qendrore e Kosovës nuk ka një departament specifik të dedikuar për këtë analizë, por ofron udhëzime lidhur me atë se çka duhet të bëhet rreth falsifikimit të parasë në institucionet financiare të licencuara nga ajo. Nuk ka **marrëveshje** formale **bashkëpunimi** me Komisionin Evropian dhe me Bankën Qendrore Evropiane.

5.2.8. Statistikat

Kosova është **në një fazë të hershme** të harmonizimit të statistikave të saj me standardet evropiane në disa sektorë, derisa në sektorët tjerë është i dukshëm një nivel i përgatitjeve. Megjithatë, Kosova has në vështirësi në implementimin e legjislacionit të vet në këtë fushë. Është arritur **progres i mirë** në disa fusha, më i dukshmi është implementimi i regjistrimit në bujqësi. Përveç kësaj, Agjencia e Statistikave (AKS) përballet me mangësi thelbësore sa i përket kapacitetit administrativ që e pengon të prodhojë statistika me kohë dhe të sakta, e që janë të rëndësishme për bërjen e politikave që janë të bazuara në evidencë. Prodhimi i statistikave thelbësore makro-ekonomike dhe të biznesit mbetet i kufizuar. Me qëllim të adresimit të mangësive të paraqitura më poshtë, gjatë vitit të ardhshëm Kosova në veçanti duhet të:

→ sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare në buxhet që t'ia lejojë agjencisë së statistikave që të përmbushë mandatin e vet;

→ t'i vë në dispozicion statistikën më sektoriale: p.sh. statistika makroekonomike dhe të biznesit, statistikën për energjinë, të hyrat dhe kushtet e jetesës.

Sa i përket **infrastrukturës statistikore**, korniza ligjore në përgjithësi është në përputhshmëri me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Ligji për statistikën zyrtare duhet të ndryshohet ndërsa implementimi i dispozitave ekzistuese kërkon përmirësim. ASK-ja është prodhues dhe koordinator i statistikave dhe në vitin 2015 ka futur bazën e të dhënave për shpërndarje të bazuar në ueb-faqe, me këtë ka përmirësuar qasjen në të dhëna. Megjithatë, kapaciteti i saj administrativ dhe mungesa e burimeve financiare e pengojnë prodhimin me kohë të statistikave dhe e ndalon agjencinë që të marrë përparësinë e plotë të ofruar nga përkrahja ndërkombëtare. I gjithë personeli i agjencisë, posaçërisht personeli i rekrutuar së voni, ka nevojë për trajnim shtesë, si në çështjet e cilësisë ashtu edhe në metodat dhe veglat statistikore. Objektet aktuale të ASK-së nuk mundësojnë kryerjen optimale të punës dhe përdorimin e teknologjisë moderne. Duhet të përmirësohet bartja e të dhënave në **Eurostat**. Sa i përket klasifikimeve dhe regjistrave, nuk ekzistojnë të gjitha versionet e fundit të klasifikimeve të ndryshme. Derisa është kryer futja e klasifikimit evropian të aktiviteteve ekonomike (NACE Rev.2) në regjistrin e bizneseve, janë paraqitur probleme që kanë të bëjnë me konsistencën. Regjistri i statistikave të biznesit duhet të përditësohet dhe cilësia e të dhënave duhet të përmirësohet.

Sa i përket **statistikave makro-ekonomike**, implementimi i pjesshëm i Sistemit Evropian të Llogarive 2010 ka filluar në vitin 2014. Aktualisht ASK-ja përgatitë llogari kombëtare vjetore dhe ka filluar të publikojë llogari kombëtare tremujore në dhjetor të vitit 2014, mirëpo nevojitet zhvillimi i mëtutjeshëm i statistikave afatshkurta për të përmirësuar llogaritë tremujore. Tabelat e furnizimit-shfrytëzimit dhe tabelat hyrje-dalje nuk prodhohen, ashtu siç nuk prodhohen as llogaritë rajonale dhe sektoriale apo notifikimet fiskale. Statistikat për bilancin e pagesave përgatiten nga Banka Qendrore e Kosovës dhe në përgjithësi janë në përputhshmëri me *acquis*. Statistikat financiare qeveritare publikohen çdo vit. ASK-ja ka filluar të publikojë Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në janar të vitit 2015 dhe kërkohet punë e mëtutjeshme për rritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së.

*Statistikat **strukture të bizneseve** (SSB) dhe disa statistika afatshkurta janë pjesërisht në përputhshmëri me *acquis*, mirëpo disponueshmëria e statistikave afatshkurta është e kufizuar. Statistikat e industrisë dhe ndërtimtarisë në përgjithësi janë në përputhshmëri me Rregulloren SSB, derisa duhet të zhvillohen statistikat për sektorin e shërbimeve. Sa i përket aktiviteteve të sektorit të ndërtimtarisë nuk janë prodhuar të dhëna, pasi që ASK-ja nuk ka të dhëna për lejet e ndërtimeve dhe nevojitet më shumë personel në mënyrë që të ofrohen statistika cilësore afatshkurta shtesë. Statistikat PRODCOM (lista e prodhimeve të Bashkimit Evropian) akoma nuk janë futur. Statistikat për turizëm janë pjesërisht në përputhshmëri me *acquis*. Statistikat për hulumtim dhe zhvillim, teknologji të inovacionit, informative dhe të komunikimit nuk prodhohen rregullisht.*

*Shumica e **statistikave sociale**, ndryshe nga statistikat demografike, mbeten për tu prodhuar, në përputhshmëri me *acquis*. Është duke u kryer hulumtimi pilot për të ardhurat dhe kushtet e jetesës (HAKJ). Në mënyrë që HAKJ-ja të bëhet hulumtim i rregullt duhet të ofrohen burime. Disa statistika për mbrojtje sociale prodhohen, mirëpo duhet të shtohet skema e papunësisë dhe duhet të përmirësohet cilësia e të dhënave administrative. Hulumtimi vjetor i fuqisë punëtore kryhet, mirëpo statistikat për indeksin e kostos së punës, struktura e të dhënave të fitimit dhe konkurset për vende pune akoma nuk prodhohen. Statistikat për shëndetin publik dhe krimet ende nuk janë në përputhshmëri me *acquis*.*

*Sa i përket **statistikave bujqësore** në nëntor të vitit 2014 është bërë regjistrimi bujqësor, edhe pse pa pjesëmarrjen e katër komunave në veri. Rezultatet preliminare ishin publikuar në muajin shkurt, kurse rezultatet përfundimtare ende nuk janë në dispozicion. Treguesit e çmimeve bujqësore dhe llogaritë ekonomike për bujqësinë prodhohen rregullisht, derisa kjo nuk ndodhë me statistikat për qumështin, produktet e qumështit dhe therjet e kafshëve. Studimi për strukturën e fermave është kryer si pjesë e regjistrimit bujqësor të vitit 2014 si dhe studimit të vitit 2013 për familjarët që merren me bujqësi. Ende nuk prodhohen balance për furnizim dhe indeks të punës në bujqësi.*

***Statistikat e energjisë** mbulojnë pjesë të rregullores për statistikat e energjisë. Disa të dhëna vjetore për energjinë dhe çmimet e energjisë i dërgohen Eurostatit, por nevojiten përmirësime të mëtutjeshme. Mungesa e statistikave për eficiencën e energjisë vazhdon të jetë pengesë për raportim lidhur me kursimin e energjisë.*

*Sa i përket **statistikave për mjedisin**, statistikat për mbeturinat dhe ujin tashmë mblidhen, mirëpo statistikat për shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit, bilancet e qarkullimit të materialeve dhe llogaritë e emetimeve të ajrit ende nuk prodhohen.*

5.3. Drejtësia, liria dhe siguria

Kosova është **në një fazë të hershme** në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, mirëpo ka bërë **pak progres** gjatë vitit të kaluar. Autoritetet ia arritën që më sukses ta adresojnë dhe ta zvogëlojnë rritjen e ndjeshme të lëvizjeve migruese që janë parë në fillim të këtij viti. Megjithatë, nevojitet përkushtim i fuqishëm për të trajtuar faktorët themelor shtytës për migrim të parregullt.

Pavarësisht disa përmirësimeve operative, dënimet përfundimtare që rezultojnë me konfiskim të përhershëm të pasurisë së fituar përmes krimit janë akoma të rralla. Numri i arrestimeve, konfiskimeve dhe aktgjykimeve të gjykatave për trafikim me drogë mbetet i ulët. Kapaciteti hetues i policisë në përgjithësi është i mirë, por implementimi i koncepteve policore që udhëhiqen nga intelijenca duhet të përmirësohet më tutje. Kosova është përfshirë në mënyrë aktive në hetimet policore ndërkombëtare dhe rajonale; megjithatë bashkëpunimi formal i saj është i kufizuar për shkak të arsyeve të ndërlydhura me statusin e saj.

Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë:

- implementimit të plotë të qasjes së policisë që udhëhiqet nga intelijenca, duke përfshirë shfrytëzimin e plotë të potencialit të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufijve;
- aplikimit sistematik të veglave për hetim financiar dhe konfiskim të pasurisë, duke avancuar kapacitetin dhe ekspertizën e policisë, prokurorisë dhe gjykatësve;
- kryerjes së hetimeve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar me synim që të sigurohen dënime përfundimtare, posaçërisht në luftën kundër trafikimit me drogë dhe trafikimit me qenie njerëzore si dhe në shpërbërjen e grupeve që bëjnë kontrabandë me migrues.

5.3.1. Politika e vizave, kontrollet kufitare, azili dhe migrimi

Përkritazi me **politikën e vizave**, në përputhshmëri me Kodin e Vizave Schengen të Bashkimit Evropian dhe me zgjerimin e misionëve konsullorë, Kosova ia ka arritur që të zvogëlojë numrin e vizave të lëshuara në pika kufitare. Gjithsej 943 ishin lëshuar nga shtatori i vitit 2014 deri në korrik të vitit 2015, prej të cilave vetëm gjashtë ishin lëshuar në pika doganore. Aktualisht për të hyrë në Kosovë viza u nevojitet qytetarëve të 88 shteteve.

Versioni i përmirësuar i Sistemit të Regjistrimit të Statusit Civil (SRSC) është lëshuar në muajin korrik, në përputhshmëri me legjislacionin e rishikuar e të miratuar. Certifikatat e statusit civil lëshohen pas kontrollimit të të dhënave të SRSC-së duke i krahasuar me librat e regjistrimit civil. Në gusht të vitit 2015, Kosova filloi digjitalizimin e librave të regjistrimit civil të kthyer nga Serbia, me qëllim që të lidheshin në mënyrë elektronike dhe të përshtateshin me të dhënat e SRSC-së. Procesi duhet të përfundoj kah mesi i vitit 2016.

Ka pasur veprime të vogla për planin e zhvillimit për Qendrën Kombëtare për **Menaxhimin e Kufijve** (QKMK). Në bazë të ligjit të ri për bashkëpunimin ndërmjet agjencive, ishte themeluar njësi i përbashkët i inteligjencës për analizim të riskut dhe rrezikut në QKMK dhe ishte prodhuar vlerësimi strategjik i rrezikut për menaxhimin e integruar të kufijve (MIK). Në kuadër të strukturës së re, nevojitet komunikim më i qartë për kërkesat e inteligjencës prej niveleve qendrore e rajonale e deri te ato lokale.

Janë kryer patrullime të përbashkëta me Shqipërinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Qendra e përbashkët e bashkëpunimit është hapur në muajin janar me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Puna teknike për demarkacionin e vijës kufitare prej nëntë kilometrave me Malin e Zi është përfunduar dhe Ministri i kanë nënshkruar marrëveshjet në gusht të vitit 2015, të cilat tash duhet

të ratifikohen në kuvend përmes 2/3 të votës së shumicës. Të gjashtë pikat kufitare të përkohshme të MIK-ut me Serbinë janë funksionale dhe është arritur marrëveshje në parim edhe për dy tjera. Janë arritur marrëveshjet teknike për vendndodhjen e tyre të saktë dhe ndërtimin e pikave kufitare të përhershme të MIK-ut. Ka pasur përmirësim sa i përket kontrollit të dokumenteve. Shkalla e zbulimit të shkeljeve në kufij është rritur në të tri agjencitë e MIK-ut (Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinarisë) për shkak të përmirësimit të analizës së riskut dhe veprimeve operative përcjellëse. Policia e Kosovës ende nuk ka arritur të lidhë kontratë për mirëmbajtje të sistemit të TI-së për menaxhim të kufijve që financohet nga BE-ja; kjo pengon progresin për kontroll efektiv të kufijve.

Prej qershorit të vitit 2014, Kosova është bërë anëtare e plotë e Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë për të promovuar tutje sigurinë, stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal në këtë fushë.

Ndryshe nga disa fqinjë të saj, Kosova nuk është prekur seriozisht nga kriza me refugjatë. Edhe pse është rritur, numri i **kërkesave për azil** që janë parashtruar në Kosovë ende është i kufizuar. Kosova ka pranuar 98 kërkesa për azil në vitin 2014 dhe 53 prej janarit deri në gusht të vitit 2015. Shumica e azilkërkuesve ishin nga Siria. Azilkërkuesit i referohen qendrës së azilit gjatë tërë kohës së procedurës, ku i gëzojnë të drejtat e lëvizjes dhe kanë qasje në të gjitha shërbimet bazë. Shumica e azilkërkuesve zgjedhin që të vazhdojnë rrugëtimin e tyre para se të jetë vendosur për kërkesën e tyre. Deri më tash autoritetet kosovare i kanë ofruar mbrojtje shtesë të shkallës së dytë vetëm një personi në vitin 2015 (një në vitin 2014, tre në vitin 2013). Qendra e ndalimit për të huajt është funksionalizuar në qershor të vitit 2015, që mundëson politikë më efikase të kthimit. Qendra e akomodimit në aeroportin e Prishtinës gjithashtu është funksionale.

Kosova e ka harmonizuar shumicën e legjislacionit të vet me *acquis* dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Janë siguruar përkthyesit që do të jenë në dispozicion. Megjithatë, duhet të implementohen mekanizmat efikas për identifikimin e vendit të origjinës dhe profileve të njerëzve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Periudha prej dhjetorit të vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 u karakterizua me një rritje të ndjeshme të **migrimit** të parregullt nga Kosova përmes Serbisë në BE. Kjo ishte pasqyruar me rritje korresponduese të azilkërkuesve nga Kosova. Numri i kërkesave për azil të parashtruara nga qytetarët kosovarë u rritë në 37 905 në vitin 2014 (prej 20 215 në vitin 2013). Nga janari deri në qershor të vitit 2015, 62 860 qytetarë të Kosovës kanë kërkuar azil në BE. Ky numër ka pësuar rënie të konsiderueshme nga maji i vitit 2015. Sidoqoftë, Kosova duhet ta adresojë numrin e lartë të kërkesave për azil në BE të parashtruara nga qytetarët e saj e të cilat në mënyrë të qartë janë të pabazuara. Në fillim të vitit 2015 Kosova ka ndërmarrë disa masa efikase afatshkurta për të frenuar migrimin e parregullt. Kontrollat e përforuara të autobusëve në Kosovë, kontrollet e rrepta të lejeve të kompanive të autobusëve, ngritja e ndërgjegjësimit dhe masat e kontrollit në kufirin serb në kufi me Hungarinë rezultuan në një rënie të ndjeshme të migrimit të parregullt. Dialogu me Serbinë i sponsorizuar nga BE-ja për migrimin e parregullt solli bashkëpunimin më të afërt me Beogradin në këtë fushë. Kosova duhet të sigurojë politika efikase afatgjate për të parandaluar valë tjera të migrimit të parregullt. Gjithashtu nevojiten masa për trajtimin e shkaqeve kryesore të emigrimit, në veçanti papunësia e madhe, sidomos në mesin e të rinjve. Profili i migrimit i vitit 2013, që ofron analizë dhe të dhëna për politikën udhëzuese rreth migrimit, është miratuar në mars të vitit 2015, profili i vitit 2014 pritet të miratohet deri në fund të vitit 2015.

Shumica e migruarëve që kanë lëshuar Kosovën, tashmë janë kthyer. Ekziston procesi

funksional i **riatdhesimit** dhe shkalla e pranimet nga Kosova është e lartë (97 % në gjysmën e parë të vitit 2015). Kosova ka riatdhesuar 4 610 njerëz në vitin 2014, prej të cilëve 3 352 ishin kthyer me forcë, ndërsa 1 258 vullnetarisht. Në gjysmën e parë të vitit 2015 Kosova ka riatdhesuar 12 330 njerëz, prej të cilëve shumica (6 834) ishin kthyer vullnetarisht, ndërsa 5 496 me forcë. Kosova ka nënshkruar marrëveshje për riatdhesim me 22 shtete. Aktualisht janë duke u negociuar marrëveshje tjera për riatdhesim, përfshirë edhe me Turqinë, dhe Kosova duhet ta inkurajojë arritjen e shpejt të tyre.

Rregullorja që e udhëheqë fondin e **ri-integritimit** është ndryshuar dhe mundëson qasje më të gjerë për të kthyerit, të cilët janë në situatë të pafavorshme sidomos në aspektin ekonomik, në shërbimet e ri-integritimit. Procedimi qendror i personave të riatdhesuar kryesisht është efikas dhe asistenca emergjente u ofrohet atyre që kanë nevojë. Sistemi i Menaxhimit të Rasteve të Ri-integritimit është përmirësuar. Një numër i shtuar i të kthyerve kanë përfituar nga skemat e punësimit dhe fillimit të bizneseve. Janë arritur marrëveshje me kompanitë lokale në mënyrë që të rritet ky numër. Integrimi afatgjatë i të kthyerve, përmes qasjes në shkollim, punësim dhe kujdes shëndetësor, mbetet një sfidë. Kosova duhet të sigurohet që të shpenzojë buxhetin e fondit për ri-integrim, duke i shfrytëzuar në tërësi burimet që janë në dispozicion për të përkrahur ri-integrimin. Kapaciteti i komunave që me efikasitet ta menaxhojnë ri-integrimin në nivelin lokal duhet të rritet edhe më tutje.

5.3.2. *Shpëlarja e parave*

Plani i veprimit për vlerësimin e riskut kombëtar për shpërlarjen e parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në pjesën më të madhe është implementuar me kohë. Sa i përket veprave penale të shpërlarjes së parave, korniza ligjore e Kosovës në përgjithësi është në përputhshmëri me Konventat e Vjenës dhe të Palermos. Megjithatë, mbeten disa zbrazëtira, si për shembull lidhur me deklaratimet e pasurive nga zyrtarët e lartë publikë dhe me manipulimin e tregut.

Bashkëpunimi në mes të Njësisë për Inteligjencë Financiare pranë Ministrisë së Financave dhe organeve kyçe në zinxhirin kundër shpërlarjes së parave duhet të avancohet më tutje. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi më i mirë posaçërisht me policinë dhe prokurorinë është jetik. Departamenti kundër korrupsionit pranë Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës duhet të forcohet në mënyrë që të trajtojë më shumë raste kundër shpërlarjes së parave, në bashkëpunim me Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX. Ka pasur një rritje të numrit të rasteve kundër shpërlarjes së parave që i janë përcjelle prokurorisë. Megjithatë, deri më tash janë dhënë vetëm disa dënime. Duhet të forcohet bashkëpunimi në mes të prokurorisë dhe policisë. Kosova duhet të bëjë përpjekje që të harmonizojë legjislacionin dhe praktikën e saj me rekomandimet e FATF-së.

Droga

Gjatë implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër narkotikëve, Drejtoria e Policisë së Kosovës për hetim të trafikimit me narkotikë i ka kushtuar vëmendje parandalimit dhe zvogëlimit të furnizimit. Operacionet, duke përfshirë bastisjet në shtëpi, shpien drejt shpërbërjes së disa grupeve kriminale. Implementimi i mëtutjeshëm i punëve të policisë të udhëhequra nga intelijenca megjithatë është i nevojshëm.

Kosova bashkëpunon me Qendrën Evropiane Monitoruese për Droga dhe Varësi nga Droga, mirëpo duhet të caktojë një person kontaktues kombëtar apo një observator funksional për droga. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet ngritjes së ndërgjegjësimit publik për pasojat e abuzimit me drogë. Është zhvilluar programi i ri i

trajnimin për rreziqet nga abuzimi me drogë për zyrtarët e sigurisë së komunitetit të Policisë së Kosovës dhe mësimdhënësit e përzgjedhur. Shërbimet për trajtimin e varësisë dhe shërbimet e terapisë me metadon janë krijuar në pesë spitale dhe dy burgje, duke përfshirë parandalimin e abuzimit me droga dhe strategjitë për zvogëlimin e dëmit. Kosova vazhdon të shfrytëzohet kryesisht për transit dhe mbajtjen e heroinës dhe kanabisit (skunk), mirëpo konfiskimi i drogës mbetet i ulët.

5.3.3. Policia

Policia e Kosovës vazhdon të perceptohet si institucioni më i besuar për sundimin e ligjit në Kosovë. Bashkëpunimi në mes të Policisë së Kosovës dhe Europolit aktualisht po lehtësohet nga ana e një zyrtari të një shteti anëtar të BE-së që punon në EULEX. Policia e Kosovës tashmë ka kontribuar në hetime të përbashkëta të suksesshme të përkrahura nga Europoli, duke përfshirë shkatërrimin në shkallë të gjerë të një rrjeti të shtrirë në tërë Evropën për kontrabandë me migrues në muajin mars. Në muajin prill Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Interpol.

Bashkëpunimi ndërmjet inspektoratit të pavarur policor (IPK) dhe Drejtorisë për Standarde Profesionale të Policisë së Kosovës vazhdon të jetë i mirë. Në vitin 2014, IPK-ja ka pranuar 1304 ankesa dhe informata, në bazë të së cilave 132 raste ishin dërguar në shërbimin e prokurorisë. Aktakuza penale janë paraqitur kundër 28 të dyshuarve të cilat janë duke u proceduar në gjykatat kompetente.

Integrimi i ish zyrtarëve të Njësiteve Serbe të Ministrisë së Punëve të Brendshme në polici shpiu në trazira, pasi që të tjerët të cilët nuk ishin integruar në polici protestuan kundër mos përzgjedhjes së tyre. Personel shtesë ishte ndarë në kuadër të policisë për të hetuar krimet e luftës, mirëpo hetimet mbeten në masë të madhe jofunksionale. Përpjekjet e vazhdueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve mbeten të domosdoshme.

5.3.4. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit

Regjistri i shënimeve

Kosova duhet të krijojë një regjistër shënimesh të luftës ndaj krimit të organizuar, duke përfshirë konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë dhe dënimin përfundimtar të keqbërësve, mirëpo deri me tani dëshmitë konkrete janë të vogla në këtë drejtim. Në vitin 2014, vlera e parashikuar e pasurive të ngrira dhe të konfiskuara përkohësisht ishte më shumë se 30 milion euro, derisa vlera e pasurive të konfiskuara në mënyrë të përhershme, të menaxhuara nga Agjencia për Administrim të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ishte gjithsej 128 298 euro, që mbulon 29 asete.

Policia ka arrestuar një numër të konsiderueshëm të personave të cilët ose i ishin bashkuar grupeve terroriste në konflikte jashtë shtetit ose kishin tentuar ta bënin atë. Gjatë vitit 2014, drejtorati kundër terrorizmit ka hetuar dhe ngritur padi për disa raste të ndërlidhura me terrorizmin dhe ka ndërmarrë dy plane operative dhe 484 bastisje në rajone të ndryshme.

Gjatë vitit 2014 janë konfiskuar 9.3 kg heroinë, 21.1 kg kokainë dhe 722.8 kg marijuanë, ndërsa ishin identifikuar dhe shpartalluar 17 banda kriminale.

Kapaciteti institucional dhe operativ

Në mënyrë që të avancohet kapaciteti i policisë në luftën ndaj krimit të organizuar, oficerët policorë ishin trajnuar në teknikat e hetimit të avancuar lidhur me krimin e urrejtjes, pikat e kontrollit në sigurimin e aeroportit dhe vlerësimin strategjik, detyrat taktike dhe koordinim. Në krahasim me vitet paraprake, janë bërë më shumë hetime financiare dhe janë trajnuar e certifikuar nëntë ekspertë financiarë që ta ngritin më tej

kapacitetin për kryerjen e hetimeve financiare. Kosova duhet ta rrisë më tutje nivelin e ekspertizës për të trajtuar hetimet kriminale komplekse, siç janë krimi financiar dhe mashtrimi në prokurim, qenësore për ta trajtuar korrupsionin me efikasitet. Institucionet e Kosovës duhet të përkushtohen për qasjen e tolerancës zero në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në praktikë dhe në të gjitha proceset vendimmarrëse. Duhet të caktohet një koordinator i ri kombëtar kundër trafikimit me narkotikë.

Korniza ligjore

Progres i pakët është arritur dhe Kosova ka themeluar komponentët kyçe të kornizës ligjore që nevojiten për luftën kundër krimit të organizuar. Në bazë të ligjit për parandalimin dhe luftimin e **krimeve kibernetike**, departamenti i policisë për hetim të krimeve të organizuara themeloi sektorin për hetime të krimeve kibernetike, derisa personeli ka ndjekur trajnime të specializuara.

Në muajin janar është miratuar ligji që e shpallë vepër kriminale fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë në përputhshmëri me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 2178 (2014). Kodi penal nuk ofron bazë të mjaftueshme ligjore për trajtimin e financimit të terrorizmit dhe terminologjia e përdorur është kontradiktore. Korniza legjislative e Kosovës për sekuestrim dhe konfiskim ka mungesë të dispozitave specifike që tua mundësojnë autoriteteve që të ndërmarrin masat e nevojshme parandaluese dhe ndëshkimore për ngrirjen dhe, nëse është e mundshme, konfiskimin e fondeve që janë të ndërlidhura me terrorizmin ose asetet tjera pa ndonjë vonesë, në pajtueshmëri me Rezolutat relevante të OKB-së. Duhet të avancohen përpjekjet për identifikimin, parandalimin dhe ndërprerjen e qarkullimit të luftëtarëve të huaj terroristë që të udhëtojnë në zona të konfliktit siç janë Iraku dhe Siria.

Kuvendi ka miratuar ligjin për përgjimet e telekomunikimeve në maj të vitit 2015.

Korniza strategjike

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër **krimit të organizuar** (2012-17) është duke vazhduar. Në nëntor të vitit 2014, filloi rishikimi i tretë vjetor i strategjive dhe planeve të veprimit 2012-2017 kundër krimit të organizuar, narkotikëve dhe terrorizmit. Vlerësimi ka mbuluar zbatimin praktik të aktiviteteve të planeve të veprimit 2012-2017. Në maj të vitit 2015 është miratuar strategjia e re kundër **trafikimit me qenie njerëzore** (2014-2019).

Në shtator të vitit 2015, Kosova miratoi strategjinë dhe planin e veprimit 2015-2020 për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që mund të shpie drejt terrorizmit. Strategjia është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me komunitetet fetare, punonjësit social dhe të vijës së frontit, sistemin e arsimit dhe organizatat e të rinjve.

Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet esencial për kundërshtimin e infiltrimit kriminal të sistemeve politike, ligjore dhe ekonomike.

5.3.5. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale

Sa i përket Konventave të Hagës, në veçanti Konventës 1980 për rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve, Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, edhe pse në mënyrë profesionale, merret vetëm me aspektet civile të rasteve të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve. Kosova duhet ta avancojë kapacitetin e vet që të bëhet partner efektiv në kontekst të asistencës ligjore të përbashkët. Nuk janë arritur marrëveshje të reja dypalëshe për bashkëpunim gjyqësor.

Shtojca I – Marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës

Më 27 tetor 2015, Bashkimi Evropian nënshkroi një **Marrëveshje Stabilizim Asociimi** (MSA) me Kosovën. MSA-ja përbën marrëdhënien e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës. MSA-ja është një marrëveshje gjithëpërfshirëse që siguron një kornizë për dialog politik dhe mbulon bashkëpunimin në një numër të madh sektorësh, përfshirë gjyqësorin dhe marrëdhëniet e brendshme, tregtinë, arsimin, punësimin, energjinë, mjedisin dhe shumë fusha të tjera të politikave.

Kosova ka vazhduar të adresojë prioritetet e përcaktuara në Raportin e Progresit të vitit të kaluar dhe në studimin e fizibilitetit të Komisionit Evropian për një Marrëveshje Stabilizim Asociimi i publikuar në vitin 2012. Në veçanti, është shënuar progres në dialogun me Serbinë, i lehtësuar nga BNE, dhe kërkesat e dialogut për liberalizimin vizave. Megjithatë, bllokada politike pas zgjedhjeve të qershorit 2014 ka përfunduar në nëntor 2014 me formimin e një qeverie të re koalicioni. Kjo ka shkaktuar vonesa në një numër çështjesh.

Angazhimi i Kosovës në dialogun e saj me Serbinë, i lehtësuar nga BE-ja, dhe normalizimi i marrëdhënieve të tyre ka qenë e dobishme për përmbushjen e ambicieve të saj evropiane. Kosova duhet të vazhdojë të përqendrohet në implementimin e marrëveshjeve të arritura me Serbinë dhe të vazhdojë negociimin e marrëveshjeve të reja.

Kosova ka mbetur e angazhuar në Dialogun e **Procesit për Stabilizim dhe Asociim. Liberalizimi i vizave** mbetet një prej prioritetëve kryesorë të Kosovës. Komisioni Evropian ka publikuar raportet për progresin e Kosovës drejt liberalizimit të vizave (në shkurt 2013 dhe korrik 2014). Pas raportit të Kosovës në qershor, misionet e ekspertëve kanë zënë vend në muajin korrik 2015.

Sa i përket **asistencës financiare**, gjatë vitit 2014, Zyra e BE-së në Kosovë ka vazhduar të punojë ngushtë me Ministrinë e Integritetit Evropian në përgatitjen e programit 2014 në kuadër të kornizës financiare IPA II. Programi IPA 2014 është aprovuar nga Komisioni i IPA-s më 27 nëntor 2014, me një kontribut financiar të BE-së në vlerë 66.05 milion euro, që është shoqëruar me bashkëfinancim nga Kosova me një buxhet të përgjithshëm prej 75.38 milionë euro. Marrëveshja Kornizë në mes të Kosovës dhe Parlamentit Evropian për organizimin e implementimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Asistencës para Pranimit (IPA II) u nënshkrua në prill 2015. Marrëveshja financiare për IPA 2014 ka hyrë në fuqi më 14 shtator 2015. Në vitin 2014, Zyra e BE-së ka nënshkruar 212 kontrata për projekte në Kosovë në vlerë gjithsej 79.3 milionë euro. Ajo ka vazhduar të sigurojë bashkërendimin e donatorëve aktivë në Kosovë, duke organizuar – në bashkëpunim me Ministrinë e Integritetit Evropian në Kosovës) takime të rregullta për bashkërendimin e donatorëve.

Komisioni Evropian ka dorëzuar propozimin e tij për nënshkrimin dhe realizimin e marrëveshjes kornizë për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së në prill 2013. Ky propozim është endë pritje të aprovimit nga ana e Këshillit Evropian.

Pas zgjatjes së mandatit të Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit **EULEX** deri në qershor 2016, një udhëheqës i ri i Misionit ka marrë pozitën në tetor 2014. Duke iu përgjigjur supozimeve për korrupsion brenda këtij misioni, Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit për Punë të Jashtme në nëntor 2014 ka caktuar një ekspert të pavarur ligjor për të rishikuar trajtimin e këtyre supozimeve nga ana e EULEX-it. Ky ekspert ka përgatitur raportin e tij përfundimtar në prill 2015. Gjatë gjithë periudhës raportuese, institucionet e Kosovës kanë pasur bashkëpunim të mirë me EULEX-in.

Në gusht 2015, Kuvendi i Kosovës ka miratuar amendamentet kushtetuese dhe ligjin që përcakton themelimin e **Dhomave të Specializuara** dhe një **Zyreje të Prokurorit Special**

, të cilat do të përndjekin rastet e krimeve të rënda ndër-kufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë.

Deri më sot, Kosova është njohur nga 110 shtete anëtare të OKB-së, përfshirë 23 të shteteve anëtare të BE-së.

Gjatë periudhës raportuese, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka vazhduar të sigurojë përditësime të rregullta për implementimin e misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Ai ka inkurajuar Kuvendin e Kosovës për të miratuar legjislacionin lidhur me themelimin e Dhomave të Specializuara sa më shpejt. Sekretari ka bërë thirrje edhe për angazhimin e plotë nga ana e Beogradit dhe Prishtinës në themelimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe. Ai ka shprehur shqetësimin për ikjen e popullsisë nga Kosova në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015.

Forca në Kosovë e udhëhequr nga NATO (KFOR) ka vazhduar të ndihmoj në sigurimin e një mjedis të sigurt në Kosovë. Gjatë periudhës raportuese, ajo ka pasur 4 500 anëtare personeli.

Shtojca II – Shtojca e statistikave

TË DHËNAT STATISTIKORE (që nga data 7.09.2015)

Kosovë

Të dhënat themelore	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Popullsia (mijëra)	1)	:	2 208p	1 799b	1 816	1 821e	1 805e
Sipërfaqja e përgjithshme e vendit (km ²)		10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	10 887

Llogaritë kombëtare	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Bruto produkti vendor (BPV) (milion €)		:	4 402	4 814	5 059	5 327	:
BPV (euro për kokë banori)	2)	:	2 480	2 672	2 799	2 935	:
BPV (në Standarde të Fuqisë Blerëse (SFB) për kokë banori)		:	:	:	:	:	:
BPV (në Standarde të Fuqisë Blerëse (SFB) për kokë banori), në raport me mesataren e BE (EU-28 = 100)		:	:	:	:	:	:
Rritja reale e BPV-së: ndryshimi nga viti i kaluar i vëllimit të BPV-së (%)		:	3.3	4.4	2.8	3.4	:
Vlera e shtuar bruto nga sektorët kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)		:	16.2	15.6	14.8	14.4	:
Industria (%)		:	20.7	19.7	19.9	20.3	:
Ndërtimtaria (%)		:	7.7	9.2	8.2	7.9	:
Shërbimet (%)		:	55.4	55.6	57.1	57.4	:
Shpenzimet e konsumit final, si hise e BPV (%)		:	102.6	103.3	105.2	104.0	:
Formimi i kapitalit të fiksuar bruto, si hise e BPV (%)		:	29.6	30.7	26.0	24.8	:
Ndryshimet në inventar, si hise e BPV (%)		:	3.4	3.3	2.9	2.8	:
Eksporti mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV (%)		:	19.9	19.6	18.2	17.4	:
Importi mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV (%)		:	55.5	56.8	52.4	49.0	:

Biznesi	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2010 = 100)		:	:	:	:	:	:
Numri i ndërmarrjeve aktive (numri)		:	:	:	:	32 651	33 937
Norma e themelimit: numri i themelimit të ndërmarrjeve në periudhën referencë (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	16.1	13.6	16.8	12.4	13.7
Norma e shuarjes: numri i shuarjeve të ndërmarrjeve në periudhën referencë (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	13.8	12.9	12.3	8.6	:
Personat e punësuar në NVM, si hise e të gjithë personave të punësuar (në kuadër të ekonomisë afariste jofinanciare) (%)		:	73.7	72.1	74.2	74.5	74.1
Vlera e shtuar nga NVM-të (në ekonomi afariste jofinanciare) (milion euro)		:	:	:	:	:	:
Vlera e përgjithshme e shtuar (në ekonominë afariste jofinanciare) (milion euro)		:	:	:	:	:	:

Shkalla e inflacionit	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), ndryshimi në raport me vitin paraprak (%)		-1.0	3.5	7.3	2.5	1.8	0.4

Bilanci i pagesave	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Bilanci i pagesave: llogari rrjedhëse gjithsej (milion €)	3)	-104	-516	-658	-380	-339	-437
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci tregtar (milion €)	3)	-890	-1 742	-2 047	-2 050	-1 996	-2 059
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: shërbime neto (milion €)	3)	-23	176	256	324	312	336
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: të hyrat neto (milion €)	3)	154	67	111	154	122	114
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: transferet aktuale neto(milion €)	3)	655	982	1 021	1 193	1 222	1 172
Nga të cilat qeveria transferon (milion €)	3)	661	370	329	402	342	292
**mesatarja e lëvizjes 3 vjet prapa e bilancit të llogarisë rrjedhëse në raport me BPV (%)	3)	:	11.4	12.0	11.4	9.5	7.4
Investimet e huaja direkte (IHD) neto brenda vendit (milion euro)	3)	:	331.1	387.0	213.3	250.2	123.8
Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)	3)	:	37.4	5.0	15.8	30.0	27.3
nga të cilat IHD e ekonomisë raportuese në 28 vendet e BE-së (milion €)	3)	:	1.0	0.0	5.2	21.5	10.1
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë e raportuar (milion €)	3)	:	368.5	392	229.1	280.2	151.2
nga të cilat IHD e 28 vendeve të BE-së në ekonominë e raportuar (milion €)	3)	:	217.9	205.3	123.2	172.2	92.5
**Pozita e investimeve ndërkombëtare neto në raport me BPV (%)	3)	:	10.2	2.9	5.0	7.0	5.5
Norma e ndryshimit vit pas viti në rrjedhën bruto të remitencave (në valutën kombëtare) nga punëtorët migruar (%)	3)	:	-0.2	0.1	3.6	2.5	11.7

Financat publike	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
*** Deficiti/suficiti i përgjithshëm i qeverisë, në raport me BPV (%)		6.2p	:	:	:	:	:
***Borxhi i përgjithshëm qeveritar, bruto, në raport me BPV (%)	4)	0.0	6.1e	5.3e	8.3e	9.0e	:
Të hyrat e përgjithshme qeveritare, si hise e BPV (%)		:	26.8	27.1	30.4	26.8	:
Shpenzimet e përgjithshme qeveritare, si hise e BPV (%)		:	28.9	28.8	29.0	28.2	:

Treguesit financiarë	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Bruto borxhi i jashtëm i tërë ekonomisë, në raport me BPV (%)		:	31.2	29.7	30.0	30.2	32.3
Bruto borxhi i jashtëm i tërë ekonomisë, në raport me eksportet totale (%)		:	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat brenda nate, milion €)		998	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M2 (M1 plus depozitat me maturitet deri në dy vite, milion €)		1 126	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion €)		:	:	:	:	:	:
Kredidhënia totale nga institucionet monetare financiare për banorë (e konsoliduar) (milion euro)		86	1 459	1 698	1 763	1 806	1 882
Shkalla e interesit: shkalla e parasë ditë pas dite, për vit (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e interesit në kredi (një vit), për vit (%)	5)	:	14.63	14.14	13.42	12.36	10.70
Shkalla e interesit në depozita (një vit), për vit (%)	5)	:	3.70	3.49	3.57	3.39	1.07
Shkalla e këmbimit të euros: mesatarja e periudhës - 1 euro = ... monedhë kombëtare		1	1	1	1	1	1
Indeksi i shkallës efektive të këmbimit (2005=100)		:	:	:	:	:	:

Vlera e asetëve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		:	585	491	760	724	746
Tregtia e jashtme në mallra	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Vlera e importit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)		:	2 158	2 437	2 462	2 421	2 538
Vlera e eksportit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)		:	296	306	267	272	325
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)		:	-1 862	-2 131	-2 195	-2 148	-2 214
Mënyrat e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / çmimeve të importit * 100) (numri)		:	125	97	87	97	107
Hisja e eksporteve në 28 vendet e BE-së në vlerën e totalit të eksportit		:	45.5	45.5	41.1	43.5	30.2
Hisja e eksporteve në 28 vendet e BE-së në vlerën e totalit të importit (%)		:	41.0	41.5	42.6	44.7	42.6

Demografia	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Shkalla e rritjes së natyrshme të popullsisë (ndryshimi natyral): numri i lindjeve minus vdekjet (në 1 mijë banorë)		:	:	11.4p	11.3	11.9	13.3
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave: vdekjet e fëmijëve nën moshën një-vjeçare për 1000 lindje të		11.2	8.8	12.1e	11.4	5.5	6.6
Jetëgjatësia në lindje: meshkuj (vjet)		:	:	68.0e	74.1	74.2	74.2
Jetëgjatësia në lindje: femrat (vjet)		:	:	71.9e	79.4	79.4	79.5

Tregu i punës	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Shkalla e veprimtarisë ekonomike për personat 20–64 vjeç: hisja e popullsisë 20–64 vjeç që është ekonomikisht aktive (%)		:	:	:	42.5	46.4	47.7
*Shkalla e punësimit për personat 20–64 vjeç: hisja e popullsisë 20–64 vjeç të punësuar (%)		:	:	:	29.7	33.0	31.3
Shkalla e punësimit të meshkujve 20–64 vjeç (%)		:	:	:	46.6	51.5	48.4
Shkalla e punësimit të femrave 20–64 vjeç (%)		:	:	:	12.4	14.9	14.5
Shkalla e punësimit të punëtorëve të moshuar (55–64): hisja e popullsisë në moshë 55–64 në punësim (%)		18.4	:	:	25.8	30.8	29.8
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)		10.3	:	:	4.6	5.9	2.6
Industria (%)		17.2	:	:	19.0	16.8	17.7
Ndërtimtaria (%)		11.2	:	:	9.5	11.4	10.9
Shërbimet (%)		61.3	:	:	65.0	64.1	67.2
Të punësuarit në sektorin publik si hise e punësimit të përgjithshëm, personat e moshës 20–64 (%)		:	:	:	:	:	31.4s
Të punësuarit në sektorin privat si hise e punësimit të përgjithshëm, personat e moshës 20–64 (%)		:	:	:	:	:	68.6s
Shkalla e papunësisë: hisja e fuqisë punëtore të papunë (%)		55.0	:	:	30.9	30.0	35.3
Shkalla e papunësisë të meshkujt (%)		45.2	:	:	28.1	26.9	33.1
Shkalla e papunësisë të femrat (%)		74.5	:	:	40.0	38.8	41.6
Shkalla e papunësisë të rinia: hisja e fuqisë punëtore 15–24 vjeç të papunë (%)		77.7	:	:	55.3	55.9	61.0
Shkalla e papunësisë afatgjate: hisja e fuqisë punëtore që ka qenë e papunë për 12 muaj apo më tepër (%)		26.0	:	:	18.5	20.7	26.1
Shkalla e papunësisë për personat (e moshës 25–64 vjeç) që kanë përfunduar jo më shumë se arsimin e mesëm (ISCED 0–2) (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e papunësisë për personat (e moshës 25–64 vjeç)		:	:	:	:	:	:

që kanë përfunduar arsimin terciar (ISCED 5 & 6) (%)							
Kohezioni social	Note	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Mëditjet dhe pagat mesatare nominale (valutë kombëtare)		:	:	:	:	:	:
Indeksi i mëditjeve dhe pagave reale (indeksi mëditjeve dhe pagave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2000 = 100)		:	:	:	:	:	:
Koeficienti GINI — shih definicionet		:	:	:	:	:	:
Hendeku i varfërisë		:	:	:	:	:	:
*Braktisja e hershme e shkollës dhe trajnimeve: hisja popullsisë 18–24 vjeç me më së shumti shkollim të mesëm të ulët që nuk vijojnë më mësim apo trajnime (%)		:	:	:	:	:	:

Standardi jetesës	Shën.	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i automjeteve të udhëtarëve në raport me madhësinë e popullsisë (për një mijë persona)		:	90.6p	111.2e	111.3	125.0	158.0
Numri i parapaguesve të telefonisë mobile në raport me madhësinë e popullsisë (për një mijë persona)		:	442.3	543.7	532.5	:	487.8

Infrastruktura	Shën.	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat funksionale për 1000 km ²)		:	30.3	30.6	30.6	31.0	31.0
Gjatësia e autostradave (kilometra)		0	0	38	60	80	80

Inovacionet dhe hulumtimi	Shën.	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet publike në arsim në raport me BPV (%)		:	3.8	4.1	4.0	:	4.4
*Bruto shpenzimet vendore për R&D në raport me BPV (%)		:	:	:	:	:	:
Hisja e ekonomive familjare që kanë qasje në internet në shtëpi (%)		:	:	57	:	:	:

Mjedisi	Shën.	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg naftë ekuivalent për 1000 euro BPV me 2005 çmime konstante)		:	:	:	:	:	:
Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme në % të bruto-konsumit elektrik		:	:	:	:	:	:
Hisja rrugore e transportit të mallrave brenda vendit (% e ton-km) (%)		:	:	:	:	:	:

Energjia	Shën.	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Prodhimi primar i gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi primar i thëngjillit të fortë dhe linjtit (1,000 TOE)	6)	5 528	7 960	8 212	8 028	8 219	7 204
Prodhimi primar i gazit natyror(1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Net importi i të gjitha produkteve energjetike (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Bruto konsumi i energjisë brenda vendit (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Gjenerimi elektrik (mijëra GVVh)		3.2	5.5	5.7	5.9	6.2	5.3

Bujqësia	Shën.	2002	2010	2011	2012	2013	2014
Indeksi i mallrave dhe shërbimeve në vëllimin e prodhimit bujqësor (çmime të prodhuesit) (viti i kaluar = 100)		:	:	:	:	:	:
Sipërfaqja e punuar bujqësore (1,000 ha)		:	242e	243e	276	295	258p
Bagëtia: gjedhe të gjalla (1,000 krerë, fundi i periudhës)		319	357e	362e	314	321	235p
Bagëtia: derra të gjallë (1,000 krerë, fundi i periudhës)		110	51e	51e	56	49	:
Bagëtia: dele të gjalla dhe dhi të gjalla (1,000 krerë, fundi i periudhës)		116	229e	247e	123	160	199p
Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit në fermë (gjithsej qumësht i papërpunuar) (1,000 tonë)		:	:	:	:	:	:
Të korrat: drithërat (përfshirë orizin) (1,000 tonë)		396	431e	435e	442	540	:
Të korrat: panxharsheqeri (1,000 tonë)		:	:	:	:	:	:
Të korrat: perimet (1,000 tonë)		135	239e	247e	117	185	:

= nuk është në dispozicion

b = ndarje në seri

e = vlerë e përafërt

p = e përkohshme

s = vlerësim i përafërt i Eurostat

* = treguesi Europe 2020

** = Treguesi i Procedurës së Çekuilibrit Makroekonomik (MIP)

*** = të dhënat për deficitin qeveritar dhe borxhin e vendeve në zgjerim publikohen ashtu siç janë, pa u siguruar për cilësinë dhe përputhshmërinë e tyre me rregullat e ESA.

Foosnotat

:

- 1) 2011: të dhënat bazohen në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 dhe shifrat e përafërta të cilat Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) i ka për tri komunat veriore të cilat nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë si dhe rritjen natyrore për periudhën 15 prill - 31 dhjetor 2011.
- 2) Shifrat e popullsisë janë rishikuar pas publikimit të BPV-së. Këto ndryshime do të përfshihen në publikim vjetor të BPV-së (nëntor 2015)
- 3) 2010–14: bazuar në doracakun për bilancin e pagesave, edicioni 6 (BPM6).
- 4) 2010–13: vlera e BPV-së është marrë nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014–2016 (prill 2013).
- 5) Përfshinë tarifën për disbursim të ngarkuar nga bankat.
- 6) Mijëra tonë.